Korrik-Gusht-Shtator 2006 • Xhumadul Uhra-Rexhep-Shaban 1427 • Numri: 4 • 150 Lek - 1 Euro - 60 DEN

Revistë edukative-arsimore

ETIKA

Tremujore

Nata e Beraetit

Detyrimet që kemi ndaj Kur'anit

Shpallja Kur'anore dhe synimi i saj

Si te formojme familjen?

Të jesh fëmijë në xhami

Të gjesh jetë në Kur'an

Lexo! Por, çfrë?

Takim te Kur'ani

I dashur lexues!

Ditët kaluan shpejt, si pa u ndierë dhe ne të dy gjejmë edhe një herë rastin të takohemi nëpërmjet fletëve të revistës sonë tre mujore edukative-kulturore "Etika". Endrra që botës letrare shqiptare t'i shtonim një organ të ri, vlonte prej kohësh brenda nesh si një dëshirë e zjarrtë. Mbeti e tillë deri ditën kur ajo u bë realitet. Shpresa që në çdo ambient tonin të kishim nëpër duar një revistë ku të gjenim vetveten, një revistë shqip-folëse, u bë me krahë dhe fluturoi kudo. Dhe deri tani, falë jush, dyert i janë hapur duke i thënë: "Oho, mirë se erdhe!" E kështu, falë mbështetjes dhe familjarizimit që ka arritur kjo revistë në mesin tuaj, ne botojmë sot numrin e katërt të saj.

Ashtu sikur se do ta keni vënë re që në numrin e parë çdo numër i revistës ka një temë qendrore rreth së cilës botohen shkrime apo artikuj të përkthyer që përzgjidhen nga redaksia jonë. Këtë numër ia kemi kushtuar një teme sa jetike, po aq edhe qëndrore për botëkuptimin dhe jetën praktike të çdo besimtari, e cila është marrëdhënia jonë me Kur'anin.

Kur'ani! Libri i shenjtë i fesë sonë, miratuesi i informacionit të saktë, korrektuesi i deformimeve të librave të mëparshëm, mbi të gjitha, vepra që nuk do të ndryshohet asnjëherë deri në Ditën e Gjykimit. Të flasësh, të shkruash mbi një libër kaq fisnik është një ndërmarrje e rëndë dhe po aq e vështirë sa që ndjenja e përgjegjësisë nuk të lë ndoshta të rrokësh penën. Duart dridhen tek valëzojnë rreshtat të cilave penda u jep formë. Por një tjetër përgjegjësi e madhe që të shtyn, na rëndon supeve. Kur sheh se njerëzit janë larguar nga mësimet burimore të fesë e si të mos mjaftonte kjo, kur edhe më të paditurit nga mesi i pseudo-intelektualëve ngrihen e zënë të flasin pa pikë skrupuloziteti mbi Tekstin e Shenjtë të Fesë Islame, atëherë të fërgëllon zemra dhe digjesh nga dëshira të shkruash ca rradhë. Nga ana tjetër, çdo zemër që ka njohur besimin, orvatet të mund të marrë sadopak nga oqeani i mirësive hyjnore të mpleksura në këtë kryevepër.

Në vitet 90-të, sapo Shqipëria kishte dalë nga komunizmi, në revistën kulturore-letrare "Bota Letrare", organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë, u botua një artikull i titulluar "Kur'ani: Libër Paqeje apo Lufte?". Kjo këmbane vazhdon ende të bjerë skutave të tokës shqiptare. Vec ndoshta me një ndryshim, sepse sot pas 16 vjetësh në botën e mendimit letrar shqiptar janë shtuar edhe revistat fetaro-kulturore si kjo e jona. Tani edhe ne kemi një tribun të mendimit tonë ku mund të prezantojmë vetveten.

Në këtë numër do të gjeni:

Për një marrëdhënie sa më të dlirë me kur`anin

Në ajetin 79 të sures *Vakia* thuhet "**Atë mund ta prekin vetëm ata që janë të pastruar**". Bëhet fjalë për Kur'anin.

Ahmet Tashgetiren 04



Lexo! Por, çfarë?

Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar! Është Ai që ua mësoi pendën. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte...

Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz 07

Tetë gjëra që mësova nga Kur'ani

Tre gjëra e ndjekin të vdekurin deri në varr; dy kthehen ndërsa njëra mbetet. Të afërmit dhe malli kthehen ndërsa ai qëndron vetëm...

M. Selim Arik 12



Falja e të Dërguarit të Allahut

Kushtet e faljes janë: pendimi, t'u bindesh urdhrave të Allahut dhe t'u largohesh harameve. Shembulli më i mirë i faljes gjendet në jetën e...

Fatmir Sulaj 20



Kur'ani nxit për në shkencë — *Gëzim Dungaj* 10

Shpallja Kur'anore dhe synimi i saj — *Emin Ëshëk* 14

Ta meritojmë dhuratën e Tij — *Artur Tagani* 17

Për një fëmijë të virtytshëm fillimisht një edukim i përshtatshëm — *Ymit Shimshek* 18

Ta kemi Kur'anin ushqim të përditshmërisë sonë — *Mesut Kaja* 21

Flaja e Dëshmisë — *Poezi* 23

Një fëmijë që rritet — *Zehra Kapllan* 24

Të gjesh jetë në Kur'an — *Osman Ersan* 27

Të jesh fëmijë në xhami — *Shejma Sulltan* 30

Abonimet:

Abonimi vjetor për Shqipërinë, 600 Lekë; për Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi, 4 €.
Për Evropën, 10 € ose vlerën e saj. Ndërsa për shtetet e tjera, çmimi vjetor, 15 $.

Të interesuarit, pasi të njoftojnë qendrën e revistës, pagesën mund ta bëjnë tek numrat e llogarisë (IBAN):
në $:
TR910020800058007092040002
në € :
TR640020800058007092040003
në CHF :
TR370020800058007092040004

Viti: I Numri: 4
Korrik-Gusht-Shtator 2006
Xhumadul Uhra-Rexhep-Shaban 1427

Çmimi: 60 DEN / 1 Euro / 150 Lek

Botoj:
SH. E. A. VËSHTRIMI:
Sead MORINA

Marketing:
Sead MORINA

Këshilli redaktues:

Ermira Alija
Brikena Smajli
Irida Hoti
Gentijana Dizdari
Diana Bilali

Korrik-Gusht-Shtator 2006

Etika mjekësore në Islam
Prim. Dr. Med. Sc. Ali F. Iljazi 37

Të punojmë në rini
Gjulije Vehapi 41

Këshilla të dobishme gjatë mësimit përmendsh të Kur'anit Fisnik
Nafiz Jëllmaz 42

Zhurmë
Alban Kali 49

Familje / Shoqëria dhe paraja
Përgatiti: Arjan Ymeraj 52

Zejnep binti Muavije bashkëshortja e Abdullah ibni Mesudit
Mustafa Erish 54

Arti / Arti i Tezhibit
Përgatiti: Evans Drishti 56

Shëndeti / Gabime që njihen si të drejta
Përgatiti: Arjan Ymeraj 58

Aktualitet
Përgatiti: Arjan Ymeraj 60

Teknologji
Përgatiti: Alija Barlovic 63

Ndjenjat e dashurisë dhe shërbimit ndaj Kur'anit Fisnik.

Kur'ani Fisnik është shëronjësi i zemrave tona, ushqimi i shpirtrave tanë dhe burimi ynë i shërimit. Aq sa të jetë dashuria dhe besnikëria jonë ndaj këtij libri, aq do të jetë...

32 **Osman Nuri TOPBASH**

Detyrimet që kemi ndaj Kur'anit

Ai që dëshiron të jetë i dashur te Allahu dhe i Dërguari i Tij, le të shikojë nëse e do Kur'anin, atëherë e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kështu, edhe ai duhet...

44 **Naim Drijaj**



Nata e Beraetit

Allahu Teala në këtë natë hap dyert e faljes; besimtarët në këtë natë falen, dhe nëse pendohen...

46 **Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz**

Isra dhe Miraxhi

Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar...

50 **Lutfi Nexhipi**

Përkthyes:

Arjan Ymeraj
Fatmir Sulaj
Alija Barlovic
Adem Pizga
Tasim Darsi
Ilir Rruga
Zymer Ramadani
Luan Ahemti
Ermal Nurja
Artur Tagani
Alban Kali
Evans Drishti
Aida Sijani

Dizenjo - Grafik:
Rasim SHAKIROV
rasimizm81@hotmail.com

Ngjyra: IBS Grafik
Tel: +90 216 342 85 99

Shtyp: Shtëpia Botuese ERKAM
Tel: +90 212 671 07 00

Për artikuj:
web: www.revistaetika.com
e-mail: etika@revistaetika.com

Adresa:
Dardania Rr. banesore 4/7-d-6
kati përdhes banesa Nr. 1 Prishtinë
Tel: +381 385 423 85

Adresa e përfaqësisë në Shqipëri:
Shoqata Vëllazërore Humanitare
Kulturore Stamboll
Bulevardi Zogu I pall. 97
ap. 21 shk. 2 Tiranë / Albania
Tel: +355 424 81 12

PËR NJË MARRËDHËNIE SA MË TË DËLIRË ME KUR`ANIN

Ahmet Tashgetiren

Në ajetin 79 të sures *Vakia* thuhet "**Atë mund ta prekin vetëm ata që janë të pastruar**". Bëhet fjalë për Kur'anin.

Në komentin juridik të këtij ajeti thuhet se fraza "**prekje e të pastruarve**" do të thotë që personi i cili dëshiron ta prekë Kur'anin duhet të ketë marrë abdest më përpara. Kjo është arsyeja që besimtarët muslimanë mësohen që të marrin abdest në qoftë se dëshirojnë ta prekin Librin e Shenjtë. Sadoqë në thelb të marrjes abdest qëndron "pastrimi nga fëlliqësia shpirtërore", shumë mirë mund të mendohet se kur flasim për qasjen e dëlirë ndaj Kur'anit, akti në fjalë duhet të ngërthejë edhe një hapësirë shpirtërore, që do të thotë: t'i qasemi librit të Zotit duke qënë të pastruar, të dëlirë, me dashamirësi, pa paragjykime, me dëshirën që ai të zërë vendin e përudhësit në jetën tonë…Tek e shohim atë si një litar të fortë (habl-i metin), një shkrim i shenjtë…

Nëse nuk i afrohemi Kur'anit me këtë përkujdesje dhe zemërbutësi, duke qënë të mbrojtur me ushqimin shpirtëror, thua se nuk mund ta nxësh me dorë këtë libër.

Le ta shohim nga një këndvështrim tjetër tekstin e shenjtë të besimit tonë fetar.

Kur'ani, ashtu sikurse na e bën të qartë Autori i kësaj fjale të lartë, është "**mëshirë, shërim, udhëzues, këshillë…**"

Ndërsa i dërguari i Allahut ka thënë : "*Nëpërmjet këtij Kur'ani Allahu disa popuj i ngre në piedestal, ndërsa të tjerëve ua heq gradat që kishin*" (Muslim, Musafirin 269)

Ashtu sikur se e shpreh qartë edhe Kur'ani : "**Kur'ani ndërsa për besimtarët është burim mëshire dhe shërimi, për mosbesimtarët nuk vlen tjetër gjë përveç se t'u shtojë humbjet në besim"** (Isra, 82)

Madje në një hadith fisnik, pasi lajmërimi që transmentohet nëpërmjet tij ka lidhje të drejtpërdrejtë me besimtarët, vihet në pah një situatë më e ashpër. Ja se ç`thuhet në hadith :

"*Nga mesi juaj do të dal një grup i atillë që, ju do të mendoni se namazet, agjërimet dhe veprat tuaja të mira krahasuar me namazet, agjërimet dhe veprat e tyre të mira, janë më me pak vlerë. Ata vërtet e lexojnë Kur'anin, por ajo që lexojnë nuk kalon poshtë grykës së tyre, ata janë njerëz që dalin aq shpejt nga feja ashtu si shigjeta që lëshohet nga harku*" (Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 36)

Po sipas një ajeti tjetër Kur'anor, çdo ajet që shpallet teksa një pjesë e njerëzve ua shton imanin, pjesës tjetër "**ua shumëfishon fëlliqësinë e mosbesimit**".

Në ajetet 124 dhe 125 të sures Tevbe thuhet :

"**Kur u shpallet një sure ndonjëri prej tyre pyet : "Kjo sure besimin e kujt e ka rritur më shumë nga ç'e kishte?" Sa për besimtarët, ua rrit**

"T'ia vësh veshin Kur'anit tek lexohet dhe ta dëgjosh atë me kujdes" është një tjetër fryt i disiplinës shpirtërore. Thesaret që zbulojnë ata që "shpirtërat i kanë të gjallë" duhet të jenë tërësisht unike.
"Ai është këshillë për të devotshmit"
"Ai është plagë e brendshme për mosbesimtarët"
"Ai është e vërteta e paluhatur"

“Ata që luajnë gjuhët e tyre a thua se janë duke lexuar prej librit të Allahut paçka se e vërteta nuk është ashtu me qëllim që njerëzit të pandehin se është ashtu dhe që thonë gënjeshtra rreth Allahut…”

besimin dhe ata ndihen të gëzuar sikur të jenë të përgëzuar vetë ata”

“Sa për ata që zemrat i kanë të sëmura, ia shumëfishon fëlliqësinë e mosbesimit dhe ata japin shpirt si mosbesimtar”

Kjo do të thotë se të jepesh pas Kur’anit nuk është diçka e lehtë. Bëhet këtu fjalë për një marrëdhënie me ligje të përcaktuara, që të kushtëzon një ndjeshmëri të veçantë.

Eshtë shumë e qartë se brenda kuadrit të kësaj ndjeshmërie, sëmundja shpirtërore bëhet pengesë për një komunikim të saktë me Kur’anin. Madje fëlliqësia e mosbesimit të tyre, ashtu sikurse nuk mund të hasë në shtresat e mëshirës, shërimit dhe orientimit të Kur’anit, me të ndodh kryekëput e kundërta: ai hedh rrënjë më thellë.

Atëherë, që të mbërrijmë deri tek Kur’ani, që të komunikojmë me të, duhet të kemi një shpirt të pastër dhe zemrën tonë duhet ta pastrojmë nga sëmundjet shpirtërore që mund ta infektojnë.

Mbase, edhe në këtë, kuptim ndjejmë nevojën e një pastrimi të këtillë, ashtu sikurse ngjan me dimensionin e pastrimit ritual të abdestit që vijëzon drejt zemrës.

Kur’ani na rrëfen edhe simptomat e sëmundjes shpirtërore.

Për shembull, në ajetin e 7-të të sures Ali Imran, pasi thuhet se “**Ai është Allahu që ta shpalli ty Librin**”, theksohet se një pjesë të ajeteve të Kur’anit e përbëjnë ajetet që janë “muhkem”, pra “ajetet, kuptimi dhe rrezja e përfshirjes së të cilave janë të qarta”, këto ajete përbëjnë strukturën kryesore dhe bazat e Kur’anit, ndërsa një pjesë tjetër e ajeteve janë “muteshabih” që do të thotë se “kuptimi i tyre është jo shumë i qartë, i papërcaktuar” dhe prandaj thuhet:

“**Ata që zemrat i kanë të turbulluara (zejg), i pasojnë ato ajete kuptimet e të cilave janë të paqarta me qëllimin e vetm që të sjellin përçarje dhe të bëjnë komente si t’ua ketë qejfi”**

Menjëherë pasi flet për ata që “**zemrat e tyre janë të turbulluara**” Kur’ani e bën të qartë se kuptimin e vërtetë të këtyre ajeteve e di vetëm Allahu. Teksa flet për një grup tjetër nga mesi i njerëzve Kur`ani vazhdon me këto fjalë “**Ata që janë thelluar në dituri thonë: Ne u besojmë atyre ajeteve, të gjitha ato vinë nga Zoti ynë”** dhe pas gjithë kësaj vjen konstatimi se “**ata që mund ta rrokin të vërtetën, mendojnë rreth këtyre ajeteve dhe i kuptojnë**”. Do të thotë se, në audiencën e Zotit “**të thellohesh në dituri dhe të bëhesh një nga ata që e rrokin të vërtetën**”, cilësohet si një tregues i besnikërisë dhe dorëzimit përpara fjalës Hyjnore.

Nga këto ajete mësojmë se dy sjelljet, që ishin **të krijosh përçarje** dhe **tendenca për komente abuzive sipas dëshirës,** shënohen si tregues i atyre njerëzve, zemrat e të cilëve kanë devijuar ndërsa kërkojnë të hynë në kontakt me kuptimet e Kur’anit.

Përveç kësaj, kur i hedhim një vështrim tekstit Kur’anor, shohim se jepen shembuj të shumtë duke u nisur nga devijimet e “**ithtarëve të Librit**” në marrëdhënien e tyre me ajetet e Allahut. Një pjesë të këtyre shembujve negativë mund të rradhiten kështu, duke marrë për bazë cilësitë që u vë në pah Kur’ani :

“**Ata që përgënjeshtrojnë ajetet e Allahut…”**(Bekare, 39)

“Ata që i këmbejnë ajetet e Allahut për një fitim të vogël…” (Bekare, 41)

“Ata që e lexojnë Librin dhe i urdhërojnë njerëzit për të kryer vepra të mira, por e harrojnë vetehveten…” (Bekare, 44)

“Ata që pasi e dëgjojnë dhe e kuptojnë fjalën e Allahut e ndryshojnë atë duke qënë të ndërgjegjshëm se çfarë po bëjnë…” (Bekare, 75)

“Ata që e shkruajnë Librin me duart e tyre dhe pastaj për të mundur ta shesin atë për një vlerë të vogël thonë : Kjo është shpallja nga Allahu…” (Bekare, 79)

“Ata që i besojnë një pjese të librit dhe refuzojnë pjesën tjetër…” (Bekare, 85)

“Ata që fshehin një pjesë të asaj që ju shpall atyre dhe e ndryshojnë atë për një vlerë të vogël…” (Bekare, 174)

“Ata që nuk bien në pajtim mes njëri-tjetrit në lidhje me librin e Allahut vetëm për shkak të zilisë që ushqejnë ndër vehte…” (Bekare, 213)

“Ata që largohen kur ftohen të kenë si gjykatës librin e Allahut…” (Ali Imran, 23)

“Ata që luajnë gjuhët e tyre a thua se janë duke lexuar prej librit të Allahut paçka se e vërteta nuk është ashtu me qëllim që njerëzit të pandehin se është ashtu dhe që thonë gënjeshtra rreth Allahut…” (Ali Imran, 78)

Të gjithë këto janë format e kontakteve negative që mund të krijojmë ne me “**ajetet e Allahut**”. Në to nuk

ka zemërbardhësi, por vetëm llogari të vogla. Kjo është llogaria e filtrimit të interesave të kësaj bote prej librit të Allahut.

Për atë arsye edhe paralajmërimi i Allahut për ata që kërkojnë të krijojnë kontakte të tilla me ajetet e Allahut është rrënqethës. Për shembull, ashtu sikurse te ajeti 174 i sures Bekare rreth atyre që " **fshehin një pjesë të asaj që ju shpall atyre dhe e ndryshojnë atë për një vlerë të vogël**" thuhet se "**barqet e tyre nuk do të mbushen plot përveçse me zjarr. Ditën e gjykimit Allahu nuk do t'u flas atyre, dhe nuk do t'ua pranoj shfajsimet e tyre. Për ta është përgatitur një dënim i dhimbshëm**".

Pra, me librin e Allahut duhet krijuar një lidhje e pastër, e dëlirë dhe e sinqertë. Kur'ani e ravijëzon edhe kuadrin e tij.

Thuhet për shembull "**Ata që i besojnë Librit me gjithë qënien e tyre**" (Ali Imran, 119) Ata janë të ndryshëm. "**Ata më gjithë shpirt i zbatojnë urdhërat e Tij**" (Muhammed, 20) thuhet diku tjetër.Ata padyshim janë të pashëmbullt.

Edhe kqyrja, rrokja e atyre që e shohin atë si "**Ai libër është dritë që vjen prej Allahut, që e nxjerr njeriun në rrugën e shpëtimit, që ndriçon errësirat, nëpërmjet të cilit gjehet rruga e drejtë dhe që të mundëson të fitosh kënaqësinë e Allahut**" (Maide, 16-17) nuk ka dyshim se mbart mosngjashmëri me të tjerët.

"**T'ia vësh veshin Kur'anit tek lexohet dhe ta dëgjosh atë me kujdes**" (Araf, 204) është një tjetër fryt i disiplinës shpirtërore. Thesaret që zbulojnë ata që "**shpirtërat i kanë të gjallë**" (Jasin, 70) duhet të jenë tërësisht unike.

"**Ai është këshillë për të devotshmit"** (Hakka, 48)

"Ai është plagë e brendhsme për mosbesimtarët" (Hakka, 48)

"Ai është e vërteta e paluhatur" (Hakka, 48)

Po qe se tregojmë kujdes, shohim se në 3 ajetet që vinë njëra pas tjetrës shpaloset një tjetërsim i spikatur i marrëdhënieve Kur'an – Individ. A thua se u drejtohet atyre më fjalët "**zgjidh pozicionin tënd"**... Nëse bëhesh i devotshëm, Kur'ani është e vërteta, "**këshilltari**" që të ndriçon udhën, por në qoftë se nuk je i ndërgjegjësuar në të vërtetën, nëse për ty të mbulosh të vërtetën, i bie për shtat pozitës tënde, atëherë ajo do të shndërrohet në një "**plagë që kullon gjak**"… Pasi ti u përpoqe të quash të drejtë një padrejtësi që as zemra jote nuk do ta duronte.

Kur'ani është fjala e Zotit tënd.

Të mbërrish tek Kur'ani me zemra të pastra është të paktën po aq e rëndësishme sa është edhe kushti i pastrimit fizik. Fletët e Kur'anit u hapen zemrave të çliruara. Në qoftë se Fjala hyjnore nuk arrin deri te zemrat, vallë ku do ta ndalë hapin, nëse zemrat tona nuk janë të pastra si mund të gjendet rruga që të çon tek ato?

Për të mos mbetur në atë hall sa të mbartim zemra të pahijeshuara me Kur'an të cilat profeti i krahasoi me "**banesat e rrënuara**", për të mos lexuar Kur'anin, ndërsa mesazhi i tij nuk kalon poshtë grykës tonë drejt e në kraharor, duhet të dalim në udhëtimin tonë drejt Kur'anit me dashurinë që buron nga përmallimi, dëshira e zjarrtë. Për këtë arsye, le ti vëmë zemrat tona në dispozicion të Tij që të hijeshohen me këtë libër të bekuar.

Përktheu: **Ermal Nurja**

Të mbërrish tek Kur'ani me zemra të pastra është të paktën po aq e rëndësishme sa është edhe kushti i pastrimit fizik. Fletët e Kur'anit u hapen zemrave të çliruara. Në qoftë se Fjala hyjnore nuk arrin deri te zemrat, vallë ku do ta ndalë hapin, nëse zemrat tona nuk janë të pastra si mund të gjendet rruga që të çon tek ato ?

Prof. Dr. H. Kamil Yılmaz

Lexo! Por, çfarë?

اقْرَأْ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ

Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar! Është Ai që ua mësoi pendën. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte. Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufintë. Për shkak se e ndien veten të pavarur. Po kthimi është vetëm te Zoti yt.

Lexo! Është urdhëri i parë i Kur'anit. Një urdhër i prerë ky. Krijuesi i Lartmadhëruar kërkon prej pejgamberit fisnik dhe prej nesh që të lexojmë në emër të Tij.

Por çfarë është ajo që duhet te lexojmë? Në këtë pikë nuk ka ndonjë urdhër që të kufizon. Drita e shpalljes, që lindi në shpellën Hira në Xhebel-i Nur, ndriçoi errësirën e padijes. Ajo u hapi përpara njerëzve horizontin e leximit dhe studimit.

Për të kuptuar më mirë urdhërin "lexo", na vijnë në ndihmë ajetet e para të zbritura ku Allahu i madhëruar thotë: " Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një pikë gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte. Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur.(1) Por kthimi është vetëm tek Zoti yt ".

Për nga kuptimi dhe treguesit që na japin këto ajete, ato që duhet të studiojë njeriu janë:

1. Vetvetja

2. Universi dhe ndodhitë në të.

3. Të studiuarit e Kur' anit.

Fjalët "kiraat" dhe "tilavet" në gjuhën arabe, që të dyja kanë kuptimin "të lexosh". Por ndërsa "tilavet" ka vetëm kuptimin e të lexuarit të një shkrimi, "kiraat" përveç kësaj merr edhe kuptimin e të lexuarit të ngjarjeve, të njeriut, dhe të vërtetave të pashkruara. Nëse është kështu, atëherë prej nga duhet të fillojë të lexojë njeriu? Çfarë kuptojmë ne me urdhërin "Lexo".

Gjëja e parë, që duhet të lexojmë dhe të studiojmë, është vetvetja.

Ekzistencën tonë, krijimin tonë që nga barku i nënës e deri në aventurën e ardhjes në këtë botë. Madje edhe më heret, nga bota e amshuar, nga koha në të cilën i dhamë besën Allahut e deri në udhën për në këtë botë. Ashtu sikur e portretizon këtë me një shembull sufisti Xhelaleddin Rumi (Mevlana) në tregimin e tij të

Kur' ani është një udhëzues që shërben edhe për të deshifruar universin edhe për të kuptuar të fshehtat e së vërtetës njerëzore. Binjakëria në mes Universit dhe Kur' anit çon në përfundimin se Universi është panairi i ajeteve kozmologjike, ndërsa Kur' ani panairi i fjalës. Njeriu duke i lexuar të dy librat, shkruan librin e tij. E rëndësishme për njeriun është se çfarë, pse dhe si lexon. Sepse njeriu me atë që lexon, kupton dhe vepron ndërkohë shkruan librin e tij.

këtij udhëtimi:

"Dëgjo! Si meloditë e djegura të këngës së ndarjes që lëshon neji, i cili është këputur nga dega e kallamishtes, i janë prerë nyjet, i është shpuar trupi me hekur të nxehtë dhe së fundi i vendoset në krye pjesëza e cila e plotëson atë "

Pra, të lexosh mallëngjimin dhe tjetërsimin, që zemra e larguar prej Zotit për shkak të dëshirave dhe epsheve të kësaj bote, të kuptojë rëndësinë e lidhjes së botës tonë shpirtërore me botën reale.

Nga erdhëm dhe ku po shkojmë? Që të kuptojmë të ardhmen dhe fundin tonë, duhet të punojmë për të kërkuar dhe për të gjetur cilësitë tona trupore, mendore dhe shpirtërore me të cilat jemi nderuar nga Allahu dhe kemi arritur gradën "forma më e bukur "(ahseni takvim) . Të shikojmë vetveten me kujdes dhe ndjesi për të arritur të kuptojmë dobësitë dhe aftësitë tona. Të lexojmë përbërjen dhe zemren tonë. Të arrijmë të kuptojmë aftësitë, të cilat na ka falur Krijuesi i Madhëruar dhe të arrijmë të ndiejmë qëllimin e krijimit dhe mënyrën e përdorimit të këtyre aftësive. Të njohim aftësitë tona të lindura dhe të plotësojmë vetveten. Madje duke dalë mbi veten tonë, të kuptojmë që gjithçka që posedojmë, nuk na përket neve dhe se ne ekzistojmë, sepse ekziston Krijuesi i Madhëruar. Me një fjalë, të dalim mbi veten tonë dhe të arrijmë tek Krijuesi. Sikur thotë Junus Emre:

"Dituri do të thotë të dish.

Dituri do të thotë të njohësh vetveten.

Nëse nuk njeh veten

Atëherë përse lexon..."

Të njohësh vetveten do të thotë të kuptosh që zotëruesi i vërtetë i fuqisë, aftësisë dhe bukurisë tonë është Allahu (xh.sh.).

Pra për këtë shkak, ajo që njeriu duhet të studiojë së pari është vetvetja. Njeriu duhet të gjejë Allahun, duke njohur vetveten, sepse qëllimi i krijimit të njeriut është njohja e aftësive hyjnore dhe që ai të jet rob i Tij. Pra duke njohur Allahun dhe duke u bërë rob i Tij me plot kuptimin e fjalës.

Qëllimi është të studiosh për të kuptuar dimensionin e dijes, prapaskenën e ndodhive në univers dhe në qënien njerëzore, me të njëjtën ndjenjë. Duhet që, në vend që t'i kuptojmë dhe komentojmë këto ndodhi sipas mendjes tonë, t'i kuptojmë dhe komentojmë ato ashtu sikur janë dhe po më aq interes të nxjerrim mësim prej tyre.

Të studiosh universin dhe ndodhitë në të;

Nga gjërat më të rëndësishme që duhet të studiojë njeriu në këtë botë janë; dituria, fuqia, mëshira, arti i Krijuesit të madhërueshëm dhe panairi i diturisë pra universi. Gjithashtu ngjarjet në të t'i shikojë me syrin e atij që merr mësim prej tyre.

Universi, kjo vepër madhështore, nga grimca e atomit e deri tek planetet është krijuar brenda një përshtatshmërie dhe ekuilibri të mahnitshëm. Duke filluar, që nga sistemi diellor e duke shkuar drejt galaktikave, shprehja e vetme me të cilën mund të tregojmë këtë përsosmëri është thjeshtë "rregull mahnitës".

Të lexosh do të thotë të lodhësh kokën duke menduar të gjitha hollësitë e këtij sistemi të cilat vazhdojnë pa asnjë shtrembërim, mangësi apo gabim.

Bukurrinë dhe madhështinë e botës së yjeve, shumëllojshmërinë e krijesave në dete dhe numrin marramendës të krijesave në tokë. Të mendosh artin e mahnitshëm në secilën prej tyre, dhe të mendosh që të gjitha këto janë krijuar vetëm për njeriun. Mendim ky i cili tregon mahnitjen e njeriut dhe përsosmërinë e pronarit të universit.

Të lexosh librin e universit i ngjet thënies së poetit:

"I gjithë universi është Kitabullah (libër i Zotit),

Shiko pak! Kuptimi i çdo shkronje a nuk është vetëm Allah!?"

Qëllimi është të studiosh për të kuptuar dimensionin e dijes, prapaskenën e ndodhive në

univers dhe në qënien njerëzore, me të njëjtën ndjenjë. Duhet që, në vend që t'i kuptojmë dhe komentojmë këto ndodhi sipas mendjes tonë, t'i kuptojmë dhe komentojmë ato ashtu sikur janë dhe po më aq interes të nxjerrim mësim prej tyre.

Le të dimë që për çdo ndodhi, ka një fytyrë të dukshme dhe një fytyrë të padukshme. Prandaj të mendojmë ndikimin që ka fytyra e padukshme ndaj fytyrës së dukshme. Të kuptojmë që asgjë nuk është rastësi, por çdo gjë ndodhet brenda një rregullsie të paramenduar.

Çdo punë që njeriu kryen, është një pjesëz që i shtohet trupit të tij në ahiret. Pra çdo punë e jona është sikur një libër që arkivohet gati për t'u përballuar me ne në ahiret. Dhe në fund libri që do të lexojmë, është libri i shkruar me punët tona. Për të shkruajtur gjëra të mira në këtë libër, njeriut i duhet të lexojë vetveten, universin dhe Kur' anin.

Të studiosh Kur' anin

Kur' ani, një libër i shenjtë i zbritur prej Allahut si një udhëzues shpëtimi për njerëzimin, me fjalën, shpirtin dhe kuptimin e tij është një mrekulli. Me këto cilësi të tij që prej 14 shekujsh është duke sfiduar njeriun për të sjellë një të ngjashëm me të. Por kësaj sfide gjer më sot askush nuk ka mundur t'i përgjigjet me dinjitet. Për shkak se është gjendur nën mbrojtjen hyjnore, gjer më sot nuk është mundur t'i ndërrohet asnjë shkronjë apo rresht.

Si lidhës i së shkuarës dhe të ardhmes, në tunelin e kohës me mesazhin e tij është një shpëtues i patjetërsueshëm i njerëzimit, deri në Ditën e Kijametit. Lexoje këtë libër me shenjtërinë dhe madhështinë që i takon! Kuptoje atë duke depërtuar në thelbin e tij!

Njeriu, universi dhe kur' ani janë sikur një treshe trinjake, universi është një makro-kozmos, ndërsa njeriu si pjesë e këtij universi është i ngjashëm me të por në përmasa më të vogla, pra mikro-kozmos.

Kur' ani është një udhëzues që shërben edhe për të deshifruar universin edhe për të kuptuar të fshehtat e së vërtetës njerëzore. Ashtu sikur njeriu dhe Kur' ani janë binjakë edhe njeriu me universin janë binjakë. Binjakëria në mes Universit dhe Kur' anit çon në përfundimin se Universi është panairi i ajeteve kozmologjike, ndërsa Kur' ani panairi i fjalës. Njeriu duke i lexuar të dy librat, shkruan librin e tij. E rëndësishme për njeriun është se çfarë, pse dhe si lexon. Sepse njeriu me atë që lexon, kupton dhe vepron ndërkohë shkruan librin e tij.

Të shkruash pa lexuar dhe të përdorësh pendën pa kuptuar është e pamundur. Për këtë arsye edhe Kur' ani e fillon punën duke na urdhëruar për të lexuar. Sepse më së fundi, kur neve do të na jepet libri i punëve tona, me të njëjtën fjalë që u urdhërua Muhammedi (s.a.s.) do të urdhërohemi edhe ne. Allahu (xh.sh.) në ditën e llogarisë do të urdhërojë: "Lexoje librin tënd! Sot ty të mjafton nefsi (vetja) yt si kërkues llogarie!"

Për shkak të leximit dhe kuptimit të drejtë nga ana e robit në këtë botë , libri i punëve do të jetë i mbushur me shprehje që do tia ndrisin fytyrën. Ose e kundërta...

Ky shkrim dhe lexim duke filluar me dhënien e besës së njeriut Allahut, do të vazhdojë sa të jetë jeta. Në fund të fundit, ato që kemi bërë dhe shkruar me dorën tonë, na japin të drejtën e fjalës së fundit rreth vetvetës.

Çdo punë që njeriu kryen, është një pjesëz që i shtohet trupit të tij në ahiret. Pra çdo punë e jona është sikur një libër që arkivohet gati për t'u përballuar me ne në ahiret. Dhe në fund libri që do të lexojmë, është libri i shkruar me punët tona. Për të shkruajtur gjëra të mira në këtë libër, njeriut i duhet të lexojë vetveten, universin dhe Kur' anin.

Përktheu: **Ilir Rruga**

1) el-Alak, 76/ 1-7.
2) el-Isra,17/14.
3) Shih. Abdurezak, el-Musannef, III. 581-582;
4) Abese, 33-37

Kur'ani nxit për në shkencë

Gëzim I

Islami është fe e mendjes dhe e ndjenjave. Njeriu shpesh herë e sheh të vërtetën me mendje dhe me zemër. Ai, duke perdorur mendjen dhe zemrën mund te gjejë rrugën që të dërgon te fara që çdo besimtar e mbjell në shpirtin e tij. Kjo farë është besimi në ekzistencën e Allahut të madhëruar si Krijues i çdo gjëje që e shohim dhe nuk e shohim. Ai thotë: "I Lartë qoftë Ai që zbriti tek robi i Tij (Muhammedi) Kriterin e së vërtetës (Kur'anin) në mënyrë që të jetë këshillues për gjithë njerëzit dhe xhindet!"[1]

Ashtu siç kuptohet nga ky ajet, Ai na e bën të qartë se Kur'ani Famelartë i është zbritur Muhammedit (s.a.s.) dhe më pas tregon shkakun e zbritjes së këtij libri, duke e cilësuar atë si "këshillues", pra të tillë që të udhëzojë të gjithë ata të cilët këtë libër e konsiderojnë hartë që tregon rrugën e lumturisë, paqes dhe mëshirës.

Ky libër është aq madhështor saqë nuk ka ardhur si këshillues vetëm për njerëzit por edhe për xhindët, krijesat e padukshme. Në Kur'an flitet për historinë e shumë pejgambërve dhe popujve të tyre, por nuk është libër historie; në të gjithnjë flitet për gjeografinë, por nuk është libër gjeografie; flitet për astronominë por nuk është libër astronomie etj. Shkurtimisht, ky libër flet për shkencë, madje nxit për kërkime dhe studime në to. Me të vërtetënëse i hedhin me kujdes një vështrim citateve të Kur'anit Famëlartë, do të shohim se Ai na urdhëron që t'i shohim krijesat e tij që ndodhen në gjithësi dhe t'i studiojmë me qëllim që ta kuptojmë më mirë ekzistencën dhe forcën e Tij të mahnitshme. Në lidhje me këtë temë Ai thotë: "(Besimtarë të vërtetë janë) ata të cilët e përkujtojnë Allahun në këmbë, të ulur e të mbështetur dhe që mendojnë thellë për krijimin të qiejve dhe tokës (duke thënë) Zoti ynë Ti nuk e ke krijuar gjithë këtë kot (pa qëllim). Lavdi të qoftë Ty! Na ruaj prej zjarrit të xhehennemit.[2]

Sipas disa komentuesve të Kur'anit ky ajet flet mbi rëndësinë e studimit të Astronomisë. Aliu (r.a) ka këshilluar besimtarët që të merren me astronomi me qëllim që ta përforcojnë besimin e tyre duke kuptuar sa më mirë njësimin e Tij. Njeriu që merret me studimin e lëndëve shkencore siç janë: kimia, fizika dhe astronomia, ka mundësi të kuptojë më mirë ligjet që janë vendosur në gjithësi në mënyre të saktë nga ligjëvendosësi i cili është Allahu i Madheruar.[3] Në Kur'an i tërhiqet vëmendja njeriut duke i thënë: "A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi ndërtuar dhe zbukuruar atë, sa nuk ka asnjë të çarë në të."[4] "(Allahu është) Ai i cili ka krijuar shtatë qiej të rënditur një përmbi një: ju nuk mund të shihni asnjë gabim në Krijimin e të Gjithëmëshirshmit. Kthe pra përsëri shikimin: "A mund të shohësh ndonjë të çarë?"[5] "Njeriu le të shohë prej kujt është krijuar."[6] "A nuk shohin devetë se si janë krijuar, qiellin se si është ngritur, malet se si janë ngulur e lidhur fort, tokën se si është shtruar?"[7] Ashtu siç u kuptua, në këto ajete bëhet fjalë për therrjen që Allahu u bën besimtarëve që të bëjnë kërkime të ndryshme mbi krijesat e Tij siç janë: qielli, shiu, toka, bimët, yjet, kafshët dhe shumë gjëra te tjera për të kuptuar sa më mirë Fuqinë dhe Madhështinë e Krijuesit të tyre.

"Ne do t'u shfaqim atyre në gjithësi dhe në vetë veten e tyre Shenjat Tona, derisa t'u bëhet e qartë se ky (Kur'ani) është e vërteta. A nuk mjafton për Zotin tënd se Ai është Dëshmues përmbi gjithçka?."[8] Fjala "Afak", e cila kalon në këtë ajet është shumësi i fjalës "ufuk" që ka për kuptim "cep ose një pjesë e tokës."[9] Në lidhje me këtë ajet janë bërë shumë komentime të ndyshme, pëmendja e të cilëve do ta bënte më të qartë kuptimin e tij. Suddi mendon se: "Ne do t'u shfaqim atyre Shenjat Tona në gjithësi" shpreh nënkuptimin e fitores së Pejgamberit (s.a.s.) kundër politeistëve (mushrikëve), kurse, sipas Ibni Zejdit ky ajet e ka fjalën për diellin, yjet dhe planetet që gjenden në qiell. Për sa i përket "…Dhe në vetë veten e tyre" sipas Suddit e ka fjalën për gjendjen e politeistëve në kohën e çlirimit të Mekkes dhe, sipas disa të tjerëve, e ka fjalën për gjendjen e njeriut si jashtë, ashtu edhe brendësinë e tij.[10]

Fahruddin er-Razi, i cili është quajtur "Babai i komentuesve të Kur'anit", pasi përmend këto dy mendime në lidhje me ajetin që përmendem më lart thotë se mendimi i Ibni Zejdit është më i saktë, sepse

gaj

Në Kur'an flitet për historinë e shumë pejgambërve dhe popujve të tyre, por nuk është libër historie; në të gjithnjë flitet për gjeografinë, por nuk është libër gjeografie; flitet për astronominë por nuk është libër astronomie etj. Shkurtimisht, ky libër flet për shkencë, madje nxit për kërkime dhe studime në to.

Allahu e përforcon këtë mendim me shumë ajete të tjera. "...dhe në tokë ka argumente për ata që kanë besim të palëkundur, edhe në vetveten tuaj. A nuk shihni pra?"[11] Atëherë, me "…dhe në vetë veten e tyre", kuptojmë se si Allahu i madhëruar e krijon njeriun në errësirën e mitrës së nënës dhe se Ai i ka sistemuar gjymtyrët e tij me një rregull të mahnitshëm.[12] Si përfundim edhe nga komentimi i Raziut del se njeriu me kalimin e kohës do të kuptojë edhe më mirë argumentet e ekzistencës së Allahut, duke bërë zbulime ose kërkime si në qiell e në tokë ashtu edhe në krijimin e tij fiziologjik, etj. Ka disa prej atyre që kërkojnë ta fshehin këtë realitet duke thënë se muslimanët kanë qenë dhe janë përherë të prapambetur dhe, se Kur'ani i la mbrapa. Por historia i tregon njerezimit se ishin muslimanët arabë të parët që shkruajtën librat e parë në lidhje me shkenca të ndryshme atëherë, kur bota nuk dinte se ç'ishte shkenca. Këtë gjë e pohojnë vetë disa nga shkencëtaret Evropianë, si: Jacgues Reisler, E.F. Gautier, etj.[13] Myslymanët qenë ata që kanë ndihmuar që shkenca të përparojë më tepër. Një prej tyre ka qenë, Xhabir bin Hajani. Ky dijetar, duke u mbështetur në parimet e kuantitetit dhe kualitetit ka arritur të hedhë bazat në shkencën e kimisë, kurse Bota Perëndimore arriti në nivelin e Hajanit vetëm pas 900-1000 vjetësh. Hajani në të njëjtën kohë mendon se ndjenjat e njeriut mund të maten matematikisht, dhe këtë shkencë e quajti "Ilmu'l-Mizan" kuptimi i së cilës është: "Shkenca e Matjes".

Një dijetar tjetër musliman është El-Biruni, i cili në shekullin e XI-të ka arritur të llogarisë vetëm me disa gabime të vogla gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike midis gradës 6 dhe 40 minuta. Në Perëndim në shekullin e XVII' të Rëne Descartes, Frans Von Schoooten dhe Edmund Halley kanë arritur të shkruajnë një libër të ngjashëm me librin e Omer Kajamit në lidhje me sistemin e ekuacionit të gradës së tretë të cilën Omeri e ka shkruajtur atë në fund të shekullit të XI' të. Një historian evropian i matematikës me emrin Johannes Tropke duke vënë re këtë dallim të madh kohor midis dy veprave të ngjashme në një shkrim të tijin thotë: "Temat që mendohet se janë të zbuluar nga Descartesi janë të zbuluar më parë nga Hajani, dhe se përëndimorëve u ka shkuar mundimi bosh për një gjë të tillë". Historiani Gjerman i matematikës Anton Von Braunmühl zbuloi se, themeluesi i shkencës së trigonometrisë është Nasruddin et-Tusi, i cili ka jetuar në shekullin e XIII-të. Gjithashtu ky dijetar, në vitin 950, duke përdorur një konstruksion parabolik arriti të zgjidhë një ekuacion të gradës së tretë, kurse në gjysmën e parë të shekullit të XI-të, Ibnu'l-Hajtem ka arritur të zgjedhë një problem optik të gradës së katërt. Gjithashtu është zbuluar se në shekullin e IX-të, në kohën e Memunëve në Sham dhe Bagdat, duke u themeluar observatorët e parë, u zhvillua edhe më tej shkenca e kozmologjisë.[14] Nuk mund të jetë aspak rastësi si Allahu i Madhëruar na urdhëron që të meditojmë në shumë krijesa të tij. Kjo tregon se Kur'ani nxit për të bërë kërkime në shkencë me qëllim që ai ta kuptojë më mirë forcën e tij. Në kohën e Pejgamberit (s.a.s.) një grup njerëzish mendonin mbi ekzistencën e Allahut. I dërguari i Allahut duke i këshilluar u tha atyre: "Mos meditoni mbi ekzistencën e Tij, sepse nuk mund të bëni analizë të tillë, por meditoni mbi krijesat e Tij.[15]

---

1. Kur'an, El-Furkan, 25:1
2. Kur'an, Al-İmran, 3:191
3. Celal Yıldırım, İlmin Işığında Asrın Kur'an Tefsiri, Shtëpia Botuese Anadolu, Vëll. III, f. 1177-1178
4. Kur'an, Kaf, 50:6
5. Kur'an, El-Mulk, 67:3
6. Kur'an, At-Tarik, 86:5
7. Kur'an, Al-Gashijah, 88:17-20
8. Kur'an, Fusilet, 41:53
9. Süleyman Ateş, Kur'an Ansiklopedisi, Shtëpia Botuese Kuba, Vëll. XXI, f. 394
10. Ebu Cafer Muhammed b. Cerir et-Taberi, Taberi Tefsiri, Shtëpia Botuese Hisar, Vëll. VII, f. 263-264
11. Kur'an, Edh-Dharijat, 51:20-21
12. Fahruddin Er-Râzi, Tefsir-i Kebir Mefâtihu'l-Gayb, Shtëpia Botuese Akçağ , Vëll. XIX, f. 408.
13. İhsan Kurt, Bilim Tarihinde Keşiflerin İç Yüzü, Botimi i II, Konja 1997, f. 20.
14. Shih: Gëzim Dungaj, "A është Islami Kundër Shkencës?" Gazeta Drita Islame, Prill, 2005
15. Për më gjatë shih: Celal Yeniçeri, Uzay Ayetleri Tefsiri, Shtëpia Botuese Erkam, f. 41-46

Tetë gjëra
që mësova nga Kur'ani

M. Selim Arik

Tre gjëra e ndjekin të vdekurin deri në varr; dy kthehen ndërsa njëra mbetet. Të afërmit dhe malli kthehen ndërsa ai qëndron vetëm e vetëm me veprat e veta. Prandaj edhe unë punën e mirë e bëra të dashurën time që kur të shkoj në varr, të mos ndahet nga unë!

Kur'ani, sikurse shprehet edhe në të, i është zbritur njeriut për ta udhëzuar në rrugë të drejtë. Në këtë drejtim, muslimanët e kanë pranuar atë si drejtues shpirtëror dhe si drejtues për jetën e tyre. Një nga personalitetet që e ka kuptuar më së miri mesazhin e vërtetë të Kur'anit është sufisti i njohur Hatim el- Esam. Në shekullin e tretë hixhri, ky mbret shpirtëror, ishte nxënësi i Hakik el- Belhit. Mes Hatim el- Esamit dhe mësuesit të tij Hakik el Belhit njëherë u zhvillua një bisedë e tillë:

Hakik: - Sa vite tu bënë që mëson këtu tek unë?

Hatim: - Më shumë se 33 vite.

Hakik: - Çfarë mësove për gjithë këto vjet?

Hatim: - Kam arritur të mësoj vetëm 8 çështje:

Hakik: - Subhanallah! Domethënë 33 vjet qëndruam bashkë dhe vetëm tetë çështje paske arritur të mësosh! Më vjen keq për veten time. Nuk paskam mundur të të jap shumë gjëra! Atëherë cilat janë ato tetë gjëra që ke mësuar? Më pas Hatimel- Esam i radhit mësuesit të tij këto çështje:

E para: Pashë se çdo njeri kishte një të dashur me të cilën e kalonte jetën. Ai nuk e mendonte aspak vdekjen, por kur arrinte në varr ndahej nga ajo që donte. Kur pashë këtë gjendje mu kujtua ajeti Kur'anor: "Vdekja prej së cilës ju po largoheni do t'ju gjejë patjetër. Më pas ai që di atë që shihet, dhe atë që nuk shihet do të kthehet tek Allahu" (El-Xhuma, 62/8) dhe fjala e Profetit (s.a.s.) që thotë: "Tre gjëra e ndjekin të vdekurin deri në varr; dy kthehen ndërsa njëra mbetet. Të afërmit dhe malli kthehen ndërsa ai qëndron vetëm e vetëm me veprat e veta" (Buhari, Rikak, 42) Prandaj edhe unë punën e mirë e bëra të dashurën time që kur të shkoj në varr, të mos ndahet nga unë!

E dyta: Mendova ajetet 39 dhe 40 të sures Naziat. Allahu në këto ajete thotë: "E kush u frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, e ka vendin në xhennet" Sapo e mësova këtë ajet, luftova me epshin tim, i mora kapistallet e tij dhe e vura epshin tim nën kontroll.

E treta: Pashë njerëzit. Vura re që ata vazhdimisht lodhen duke punuar për këtë botë. Çfarë fitojnë e ruajnë. Kurse Allahu thotë: "Të mirat e kësaj bote që u janë dhënë juve

Vura re se disa njerëz i besojnë dhe i mbështeten mallit të tyre, dikush pasurisë, dikush tjetër rinisë… Në këtë mënyrë të gjithë njerëzit i mbështeten gjithësisë. Ndërsa unë kujtova ajetin: "Kush i beson dhe i mbështetet Allahut, Ai i mjafton" dhe vetëm Allahut i besova, Atij iu mbështeta.

konsumohen kurse thesari i mëshirës nga ana e Zotit është i pambarim" (Nahl; 16/96). Kujtova këtë ajet dhe gjërat që prej vitesh i kisha fituar dhe ruajtur i dhashë si sadaka (lëmoshë) për hir të Zotit dhe ia lashë amanet Zotit si ushqim për ahiretin.

E katërta: Pashë njerëzit që kujtonin se epërsia është në farefisni, mall, pasuri dhe post. Kurse unë i hodha një sy fjalës së Zotit: "Ta dini që më i miri ndër ju nga ana e Allahut është ai që ka dëvotshmërinë më të madhe" (ez- Zuhruf; el- Huxhurat; 49,13) dhe u lidha pas devotshmërisë deri sa u bëra i dashur tek Zoti.

E pesta: Pashë njerëzit që kacafyteshin me njëri – tjetrin për mall dhe famë. Atëherë përsëri iu mbështeta fjalës së Allahut, mendova ajetin: "Ne kemi përcaktuar ndër ta gjendjen e jetës në këtë botë" (Ez- Zuhruf; 32) dhe pranova përcaktimin që kishte bërë për mua. Me të gjithë ia kalova mirë. Askujt nuk i bëra keq.

E gjashta: Pashë njerëzit që thuajse po viheshin në garë për t'i bërë keq njëri – tjetrit. Kur shoh armikun tim, në fillim mendova se është shejtani. I hodha një sy fjalës së Zotit: "Shejtani është një armik i juaji. Prandaj edhe ju pranojeni atë si një armik për ju" (el- Fatir; 35/6), atëherë iu bëra armik atij dhe fillova të doja të gjithë njerëzit për hir të Allahut.

E shtata: Vura re se të gjithë njerëzit përpiqen për nevojat e kësaj bote. Nga kjo poshtërohen edhe nga epshet e tyre, gjithashtu futen edhe në gjërat që janë haram dhe të dyshimta. Pas kësaj pashë këtë ajet: "Rrisku i të gjitha gjallesave ç'ka në tokë i takon vetëm Allahut" (el- Hud; 11/6). Kështu që e llogarita veten si një nga këto gjallesa dhe vendosa ta kaloj jetën time nën urdhrat e Zotit tim.

E teta: Vura re se disa njerëz i besojnë dhe i mbështeten mallit të tyre, dikush pasurisë, dikush tjetër rinisë… Në këtë mënyrë të gjithë njerëzit i mbështeten gjithësisë. Ndërsa unë kujtova ajetin: "Kush i beson dhe i mbështetet Allahut, Ai i mjafton" (et- Talak; 65/3) dhe vetëm Allahut i besova, Atij iu mbështeta.

Mësuesi i tij Hakik el Belhi, pasi e dëgjoi me shumë vëmendje, iu drejtua nxënësit të vet:

- O Hatim! Ma ngrohe shpirtin. Paske fituar shumë gjëra të dobishme nga Kur'ani. Nëse punon sipas këtyre gjërave që ke mësuar, lumturia në të dy botrat është e jotja. Gjithashtu, edhe nëse unë veproj sipas këtyre, vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtoj. Të përgëzoj sepse më udhëzove edhe mua. I lutem Zotit tim që të gjithë nxënësit e mi të edukohen kështu. Zoti të dhashtë një jetë të gjatë dhe të frytshme, jetofsh përherë në qetësi.

Përktheu nga Turqishtja: **Evans Drishti**

---

1) Ky artikull është përgatitur në mbështetje të veprës së Muhammed Haxhar "Semir-l Mu'minin"(fq. 296-298);

2) Hatim el Esam el Belhi (v 237) ka lindur në Belh qytet të veri të Afganistanit, është nxënësi i sufistit (mutasavufit) të famshëm Hakik el Belhit nga Horosani. Shih: Ibn Hallikan kakuptimin "Vendi ku lind dielli, zona e lindjes". Horosani zë një vend të rëndësishëm përsa i përket tasavvufit. Psh: Hakik el Belhi mori emrin "Zuhhad" që nga shek II H në atë kohëkanë jetuar sufistë të njohur si: Ibrahim b Ethem, (v 161) Fudayl b Ijaz, (v 227) Hatim el Esam, (v 237) dhe Ahmed bin Harb.

Shpallja Kur'anore dhe synimi i saj

Emin Ëshëk

Shkrimi i Kuranit është urdhëruar nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s), gjatë periudhës 23 vjeçare në të cilën zbriste në formën e ajeteve ose sureve. Profeti (s.a.s.) ua mësonte vargjet Kur'anore sahabeve dhe nëse shikonte të nevojshme i korrigjonte ata. Vargjet që zbrisnin mësoheshin menjëherë nga një numër i madh sahabësh. Kryesisht, çdo muslimani që të kryejë faljen e namazit, i duhet të këndojë përmendësh një pjesë nga Kur'ani. Gjatë kohës që Profeti (s.a.s.) ishte gjallë kishte me qindra hafiza që e kishin mësuar Kur'anin të tërin përmendësh. Menjëherë pas ndërrimit jetë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s) në kohën e Ebu Bekrit (r.a.), vargjet kuranore të shkruara u mblodhen dhe iu dha forma e Kur'anit që gjendet sot. Kështu që nuk u la asnjë mundësi që Kur'ani të harrohej apo të humbiste.

Kur'ani është libri i dërguar nëpërmjet profetit të fundit Muhammedit (s.a.s.) për të gjithë njerëzimin si shpallje hyjnore.

Kuptimi gjuhësor i fjalës Kur'an është lexoj, pra lexoj vazhdimisht, mësoj përmendësh.

Nëse do t'i bashkojmë kuptimin gjuhësor, si dhe atë fetar, mund të themi se Kur'ani është libri i shenjtë i muslimanëve, të cilin duhet ta lexojnë vazhdimisht.

Allahu Teala është zoteruesi i dijes, dëshirës (irades) dhe fuqisë. Me fuqinë e Tij, (xh.sh.) të pafundme bën çfarë dëshiron. Kur dëshiron të lajmërojë robërit e Tij (xh.sh.) me ndonjë urdhër, këshillë apo udhëzim, me anë të një lajmëtari qiellor (engjëlli) ia shpjegon të gjitha ato një të dërguari ne formë njeriu (profeti). Kjo nuk është as e vështirë, as e pamundur për Krijuesin e gjithësisë. Padyshim Allahu Teala është përtej kufijëve gjuhësorë, sepse gjuhet i përkasin njerëzve. Ne një mënyrë komplet metaforike gjuhën e vahjit (shpalljes) mund ta shpjegojmë me një shembull të tillë: Pejgamberët janë si llamba, kurse vahji si rryma elektrike. Kur rryma elektrike arrin tek llamba ajo jep dritë sipas ngjyrës së saj. (M. Hamidullah, İslam'a Giriş f. 27.).

Në lidhje me kumtimin e vahjit, në Kur'anin e shenjtë thuhet kështu: "**Në asnjë të dërguar nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet**..." (Suretu İbrahim, ajeti 4.).

Sikurse vërehet në ajet, gjuha është ndërthurur me popullin. Kështu që gjuha është diçka sociale dhe i përket vetëm racës njerëzore, kurse në lidhje me shpalljen hyjnore dërguar profetëve ndeshemi me shprehje të tilla si: **"ruhan min emrina"** (Suretu Shura, ajeti 52.), (shpirt nga ana Jonë)" dhe **"nur"** (Suretu et-Tegabun, ajeti 8.) Suretu et-Tegabun, ajeti 8. (dritë)" nga të cilat kuptohet se vahji është shpirt dhe dritë nga Allahu (xh.sh.). Duhet të dimë se shprehje të tilla si **"kelamullah, vahju'l-matluvv"** dhe **"kelam el-kadim"** nuk janë në kuptimin e gjuhës apo e të folurës njerëzore, por në një kuptim me veçori shumë më të lartë se ato. Ndryshimi në mes gjuhës se Allahut te Lartesuar dhe gjuhëve të tjera është si ndryshimi në mes Allahut dhe krijesave te Tij. Vahji, larg nga "harf, lafdh, saut" dmth, larg nga shkronjat, fjalët apo zërat është forma e fjalive që del nga goja e Profetëve të Allahut (xh.sh.).

Shkrimi i Kuranit është urdhëruar nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s), gjatë periudhës 23 vjeçare në të cilën zbriste në formën e ajeteve ose sureve.

Synimi kryesor i shpalljes hyjnore e cila u ka ardhur të gjithë pejgamberëve dhe në veçanti vahji kuranor që i ka zbritur Pejgamberit të fundit Muhammedit (s.a.s.), është ndriçimi i mendjes së njeriut me anë të dritës së shpalljes dhe t'i japë kësaj krijese formën njerëzore ashtu siç e meriton.

Profeti (s.a.s.) ua mësonte vargjet kuranore sahabeve dhe nëse shikonte të nevojshme i korrigjonte ata. Vargjet që zbrisnin mësoheshin menjëherë nga një numër i madh sahabësh. Kryesisht, çdo muslimani që të kryejë faljen e namazit, i duhet të këndojë përmendësh një pjesë nga Kur'ani. Gjatë kohës që Profeti (s.a.s.) ishte gjallë kishte me qindra hafiza që e kishin mësuar Kur'anin të tërin përmendësh. Menjëherë pas ndërrimit jetë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s) në kohën e Ebu Bekrit (r.a), vargjet kuranore të shkruara u mblodhen dhe iu dha forma e Kur'anit që gjendet sot. Kështu që nuk u la asnjë mundësi që Kur'ani të harrohej apo të humbiste.

Kurani është i vetmi libër hyjnor i trashëguar si amanet i shenjtë brez pas brezi deri në ditet e sotme i cili posedon një garanci të dyfishte, shkrimi dhe mësimi përmendësh. Një veçori të tillë në mes librave të tjerë të shenjtë e ka vetëm Kur'ani. Pra, Kur'ani që kemi sot në dorë është vazhdimi pashkëputur i kopjes origjinale e cila u urdhërua të shkruhej nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), kurse Tevrati dhe Ungjillët e sotëm nuk kanë arritur ta ruajnë origjinalitetin e kopjeve të tyre të para. Kjo është një e vërtetë e pranuar edhe nga vetë çifutët dhe krishterët sot.

Përsa i përket "**kiraat**-it" dhe "**ta'lim**-it", dy metoda të veçanta këto për leximin e Kur'anit, mund të thuhet padyshim se që nga koha e Profetit (s.a.s.) e deri sot janë ruajtur dhe zbatuar me kujdes, pa asnjë ndryshim. Çdo mësues (mual'lim), kur e gradon nxënësin e tij në lidhje me këndimin e Kur'anit, në fillim i tregon nxënësit se çdo gjë ia ka mësuar të njëjtë, pa asnjë ndryshim, sikurse e ka marrë nga mësuesi i tij. Më pas i tregon atij zinxhirin nga nxënësi tek mësuesi brez pas brezi duke shkuar mbrapa deri tek Pejgamberi (s.a.s.).

Doktori dhe shkencëtari i njohur francez Prof. Dr. Maurice Bucaille i njohur me veprën "Studime mbi librat e shenjtë hyjnore, nën dritën e përvojës shkencore moderne", në librin tjetër të tij botuar me titullin "Tevrati, Kurani dhe Shkenca" se ruajtja e Kuranit në formën origjinale ka rëndësi të madhe nga ana fetare dhe se nuk duhet të nënvlerësohet.

Duhet të sqarojmë se gjatë punimeve të tij shkrimtari ka parë epërsinë që gëzon Kur'ani kundrejt librave të tjerë të shenjtë, më pas duke pranuar Islamin është bërë musliman. **Kurani nuk mjaftohet vetëm me dhënien e njohurive dhe urdhëresave, duke i përsëritur herë pas here temat e rëndësishme, mundohet ta bindë lexuesin dhe ta bëjë atë, zotërues të imanit (besimit)**.

Kur'ani i shenjtë përbëhet nga 114 sure nga të cilat më e gjata është 286 ajete, kurse më e shkurtra 3 ajete. Në lidhje me numrin e ajeteve të Kur'anit, për shkak të mynyrave të ndryshme që janë përdorur në numërimin e tyre ka mendime të ndryshme, por mendimi i pergjithshem është se Kurani përbehet nga 6666 ajete.

Dijetarët kanë rënë në një mendim se vargjet e para që kanë filluar të zbresin nga Kur'ani i

Kurani është i vetmi libër hyjnor i trashëguar si amanet i shenjtë brez pas brezi deri në ditet e sotme i cili posedon një garanci të dyfishte, shkrimi dhe mësimi përmendësh. Një veçori të tillë në mes librave të tjerë të shenjtë e ka vetëm Kur'ani. Pra, Kur'ani që kemi sot në dorë është vazhdimi pashkëputur i kopjes origjinale e cila u urdherua të shkruhej nga vetë i Dërguari i Allahut (s.a.s.), kurse Tevrati dhe Inxhilet e sotem nuk kanë arritur ta ruajnë origjinalitetin e kopjeve të tyre të para. Kjo është një e vërtetë e pranuar edhe nga vetë çifutët dhe kristianët sot.

Shenjtë janë 5 vargjet e para të sures Alak. Në ajetet Kur'anore dhe në hadithet e transmetuara gjejmë argumente se këto vargje filluan të zbrisnin në pjesën e fundit të natës, pak para kohës së fexhrit (sabahut) pra në kohën e syfyrit, të muajit të Ramazanit, pikërisht në natën e Kadrit. Argument për këtë mund të përmendim këto dy ajete: "**Ue-lejli idha asase, ues-subhi idha teneffese**"-Pasha natën, kur ajo ia beh me errësire, pasha agimin, kur ai shkrep-.

Këto janë 5 ajetet e para që atë natë filluan t'i zbresin të Dërguarit të Allahut (s.a.s), në shpellën Hira:

"Lexo, me emrin e Zotit tënd i cili krijoi (çdo gjë).

Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës).

Lexo se Zoti yt është më bujari.

Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë.

I mësoi njeriut atë që nuk e dinte".

Pra, shpallja e parë urdhëron që të lexohet dhe mësohet, urdhëron që njeriu të pajiset me dituri. Pajisja me dituri numërohet pothuajse e barabartë dhe po aq e rëndësishme, sa vetë krijimi i njeriut. Këtë Kur'ani e paraqet si një domosdoshmëri e krijimit njerëzor dhe si një kusht bazë e të qenit njeri.

Në të vërtetë Kur'ani herë pas here përdor edhe termin "**besher**", por në mes të termit "**besher**" dhe atij "**insan**" ka shumë ndryshime pasi që të dy janë përdorur për të shprehur qëllime të ndryshme. Perfundimi që del nga ajetet të cilët flasin për këtë temë, është se besher do të thotë një lloj e veçantë që mbart mbi vete cilësi të veçanta në mes gjallesave të tjera, kurse insan është gjendja e përparuar e krijesës që lind në formën njerëzore dhe duke mësuar ajo pajiset me dituri dhe fiton një përbërje kulturore. Kjo çeshtje sqarohet gjithashtu në ajetet 30-32 te sures Bakara si dhe në ajetet e para të sures Rrahman.

Sëfundi mund të thuhet se **synimi kryesor i shpalljes hyjnore e cila u ka ardhur të gjithë pejgamberëve dhe në veçanti vahji Kur'anor që i ka zbritur Pejgamberit të fundit Muhammedit (s.a.s.), është ndriçimi i mendjes së njeriut me anë të dritës së shpalljes dhe t'i japë kësaj krijese, formën njerëzore, ashtu siç e meriton.**

Përktheu: **Luan AHMETI**

Artur Tagani

Ta meritojmë dhuratën e Tij

Tek po dilja nga xhamia, një grua rreth të dyzetave më shtriu dorën dhe me lot që s'reshtnin më tha: "Ju lutem më ndihmoni, kam djalin 7 vjeç me tumor në kokë, i kanë humbur shumë funksione, ju lutem më ndihmoni..."

Jeta është dhurata më e shtrenjtë që na është dhënë. Nëse nuk ia kuptojmë vlerën, të mundohemi ta meritojmë atë. Që ta marrim vesh se sa madhështore është kjo dhuratë, nuk duhet patjetër të përjetojmë një ngjarje të tillë. Le të shohim rreth e rrotull, do vërejmë se si njerëzit e shkatërrojnë këtë dhuratë të mahnitshme.

Le ta jetojmë çastin se vetëm atëherë ekzistojmë. E djeshmja ngelet në të kaluarën dhe e nersërmja është e panjohur. Do të jemi ne ata që nesër do të buzëqeshim me ato gjëra që sot i bëjmë problem. Jemi ne ata që i japim vlerë gjërave. Nga një gjë e vogël mërzitemi dhe po nga ajo gjë gëzohemi. Poeti Xhelaleddin er-Rumi thotë:

"Nga mendimi përbëhesh mor vëlla

Të tjerat i ke mish dhe kocka

Mendon trëndafil, gjendesh në kopësht trëndafilash

Mendon gjemb, gjendesh në mes gjembash"

Ankohesha se s'kisha këpucë - thoshte një i vjetër, derisa pashë njërin pa këmbë...

Pa të mendojmë; e imagjinojmë dot një jetë që nuk mund të shohë, të verbër, çdo gjë njëngjyrëshe?!

Po sikur të mos kishim mundësi të dëgjonim asgjë, të ishim të shurdhër, një heshtje absolute?!

Që ta kuptojmë se çfarë mrekullie është frymëmarrja është e nevojshme patjetër të shikojmë një që heq keq tek merr frymë?! Ja pra, në çfarë pasurish lundrojmë!

Kur gjithë natën jemi gjysëm të vdekur; hapja e syve në mëngjes edhe një herë, marrja frymë, është një dhuratë tjetër, një mundësi tjetër, të rilindim!

Pastaj, të shikojmë që edhe pjestarët e familjes e morën këtë dhuratë, ashtu të pavetëdishëm sikur ne, s'është mrekulli po ç'farë?

Apo duhet ta humbasim ndonjërin, që pastaj të kujtohemi për vlerën e tij duke thënë: "Ah sikur të ishte, do ta shikoja, do të bisedoja, do ta përqafoja dhe do ta puthja pa u ngopur..."

Çasti është jeta, vëtëm çasti. Çastin ta vlerësojmë si duhet dhe ta falënderojmë Atë për gjithë këto dhunti të pafund që na ka dhuruar dhe që vazhdon të na dhurojë pa ndërprerë, në çdo sekondë.

Omeri(r.a.) ngaqë kishte frikë se nuk mund ta falënderonte Zotin për kënaqësinë dhe freskinë që i jepte uji i ftohtë, në nxehtësinë përvëluese të Gadishullit Arabik, ai përherë pinte ujë të vakët...

Çfarë ndjenje është kjo?

Pse nuk e kuptojmë?

Sado që të mundohemi, falënderimi ynë nuk mund të jetë kurrë reciprok para gjithë kësaj bujarie të papërceptueshme. Madje, Ai vetë na thotë që na ka mësuar se si ta falënderojmë. Sa turp! Sa të paaftë që jemi! Çdo gjë e kemi fallso, edhe të qeshurat dhe të qarat i kemi artificiale. Dhe më e çuditshmja është se ne nuk dimë as të gabojmë. Po, po! Duke pasur plot gjëra të ndryshme, bëjmë të njëjtin gabim. Dhe kështu as të pendohemi nuk dimë, vetëm veten mashtrojmë. Sa turp! Sa të paaftë që jemi! Duke qenë të tillë,

-Pse s'më ka pyetur mua Zoti para se të më krijonte? -m'u drejtua njëri,

-Po ti para se të dashurosh dikë e pyet atë?- i thashë

-Zoti ngaqë të do të ka krijuar, ç'të duhet më tej?!..

Njerëz, ta meritojmë jetën. Ta ndiejmë Atë kudo. Ta ndiejmë kënaqësinë qoftë edhe në një pikë ujë, në një rriskë patateje. Sonte, kur të shkoni në shtëpi, merrni ndonjë dhuratë sa do e vogël që të jetë për prindërit. Mos e hapni televizorin, uluni sonte dhe bisedoni me vëllanë e motrën sikur nuk keni biseduar asnjëherë më parë.

Unë sonte do të lutem për atë djalin që as emrin nuk ia di.

Ju lutem, lutuni edhe ju...!

Ymit Shimshek

Për një fëmijë të virtytshëm fillimisht një edukim i përshtatshëm

Nëse nuk do të kemi lidhje me botën në të cilën jetojmë ose nëse ajo nuk krijohet ashtu siç e shpjegon Kur'ani, nëse ky themel nuk hidhet në rregull, më pas, është e vështirë të vendosësh gurët në vend te ato pjesë të mbetura të jetës. Nëse ju nuk u jepni rëndësi këtyre gjërave dhe detyrën tuaj për t'ia prezantuar fëmijës botën në të cilën jeton ia lini mësimeve evolucioniste dhe natyraliste të kohës sonë ose të ndikimeve të mediave apo vendeve të tjera, më pas, kur të merreni me rregullimin e gabimeve të tij, do ta shikoni veten sikur jeni duke hapur një pus me gjilpërë; edhe më e keqja, nuk arrini të vini re një mangësi të tillë.

Kushti më i rëndësishëm për të edukuar një fëmijë të virtytshëm pikësëpari është ekzistenca e një edukimi bazë. Ashtu sikurse çdo bimë nuk mund të rritet gjithkund edhe njerëzit atëherë kur gjejnë një tokë dhe atmosferë të përshtatshme arrijnë të gjejnë mundësinë për të zhvilluar karakteret e tyre. Kjo ishte edhe veçoria më e rëndësishme e sahabëve. Ata u rritën dhe u edukuan në një vend dhe në një periudhë në të cilën kërkohej pëlqimi i Zotit në çdo çast të jetës së tyre, për çdo vend dhe për çdo punë. Një njeri, i cili e kalon një javë në një mjedis të tillë ndjen qartë ndryshimin e botës së tij; ne mund të rrokim tani se sa kanë ndryshuar aftësitë e këtyre njerëzve që gjithë jetën e tyre e kanë kaluar në këtë mënyrë.

Një fëmijë, edhe pa filluar mirë të gjykojë, duhet të qëndrojë në një mjedis frytdhënës në aspektin shpirtëror. Ndërsa pasi të ketë filluar të gjykojë, duke njohur rrethin e tij, duke kuptuar botën në të cilën jeton, duhet ta kuptojë atë ashtu siç e ka shpjeguar Allahu dhe i Dërguari i Tij. Kur të shohë diellin ai duhet të shohë llambën që Allahu ka varur atje, kur të shohë tokën duhet të gjejë një fole të përgatitur nga Zoti për të, duhet të dijë se kush i bën të fluturojë zogjtë mbi kokën e tij, kush i ka rreshtuar yjet në qiell si margaritarë dhe se kush e ka zbukuruar botën e tij me lule shumëngjyrëshe. Sipas meje, kjo është edhe ajo pjesë e lënë mangët në ditët e sotme. Nëse nuk do të kemi lidhje me botën në të cilën jetojmë ose nëse ajo nuk krijohet ashtu sikurse e shpjegon Kur'ani, nëse ky themel nuk hidhet në rregull, më pas, është e vështirë të vendosësh gurët në vend te ato pjesë të mbetura të jetës. Nëse ju nuk u jepni rëndësi këtyre gjërave dhe detyrën tuaj për t'ia prezantuar fëmijës botën në të cilën jeton ia lini mësimeve evolucioniste dhe natyraliste të kohës sonë ose të ndikimeve të medjave apo vendeve të tjera,

më pas kur të merreni me rregullimin e gabimeve të tij do ta shikoni veten sikur jeni duke hapur një pus me gjilpërë; edhe më e keqja, nuk arrini të vini re një mangësi të tillë, madje mund të mos t'i jepni rëndësi fare faktit që fëmija juaj të dijë se tërmeti vjen nga çarja e tokës dhe sjell një dëm të madh, të mësojë jetën nga dielli, uji dhe ajri, të mësojë individualitetin dhe fatin e tij nga yjet! Ose nëse mundoheni t'i ndreqni gabimet e tij në këto aspekte, madje edhe nëse jeni të suksesshëm, rezultati më i kënaqshëm që do të merrni do të ishte që atë ta ktheni në rrugë të drejtë pra t'i tregonit rrugën e drejtë pas brymosjes të tij në një atmosferë të pafe. Ndërsa një besim i tillë, është e qartë që nuk do të mund të arrijë të depërtojë në të gjithë karakterin e brëndëshëm të njeriut aq sa besimi i njerëzve të edukuar në frymën e besimit Islam. Prandaj përgjegjësia më e rëndësishme e një nëne dhe babai ndaj fëmijëve të tyre, mendoj se është t'u shpjegojnë atyre përpara çdokujt botën në të cilën jetojnë dhe padyshim t'ua shpjegojnë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në këtë pikë, nuk mund të them se jemi të pasur me literaturës. Por ne kemi në dorë Kur'anin dhe hadithin. Nëse një prind kërkon të mësojë se në ç'mënyrë na e kanë shpjeguar gjithësinë Allahu dhe i dërguari i Tij, mund të gjejë materiale të mjaftueshme duke lodhur pak edhe kokën. Mbetet që, nënat dhe baballarët, mjafton që të kërkojnë dhe literatura që do t'u japë atyre përgjigje fillon të zhvillohet vetvetiu. Një nënë dhe baba që e sheh birin e tij në rrezik, për ta shpëtuar atë nuk shikon nëse mjaftojnë apo jo mundësitë; ndërsa unë mendoj se në aspektin e besimit kjo sjellje instinktive duhet të tregohet në një mënyrë më më të prerë.

Përgjegjësia më e rëndësishme e prindërve ndaj fëmijëve të tyre, mendoj se është t'u shpjegojnë atyre, përpara çdokujt, botën në të cilën jetojnë dhe padyshim t'ua shpjegojnë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Fëmijët tanë, shumë më parë se të fillojnë shkollën, duhet të njihen me termat e Kur'nit dhe ta kuptojnë botën në të cilën jetojnë në atë mënyrë si e ka shpjeguar Krijuesi.

Nuk duhet menduar se këto që thashë unë janë një punë që kryhet duke dhënë disa njohuri elementare, duke mësuar *amentu* dhe duke mësuar përmendësh cilësitë e Zotit. Unë flas për një besim që përfshin gjithë jetën. Kushti më i rëndësishëm për të fituar këtë është familjarizimi i fëmijës me Kur'anin deri në pikat më kyçe të karakterit të tij përpara se sa të hyjë në mjedise që mbartin rrezikun e humbjes së tij. Përmbledhtazi mund të themi:

Fëmijët tanë shumë më parë se të fillojnë shkollën duhet të njihen me termat e Kur'nit dhe ta kuptojnë botën në të cilën jetojnë në atë mënyrë si e ka shpjeguar Krijuesi.

Një njeri që e ka arritur këtë besim dhe që ka mësuar të jetë i vlefshëm dhe i dobishëm për Zotin e Tij, për të qenë i tillë së pari ndaj prindërve të vet dhe më pas edhe ndaj të tjerëve, nuk ka nevojë të mundohet shumë; gjërat që ka mësuar do t'ia tregojnë rrugën edhe në këtë aspekt.

Përktheu nga Turqishtja: **Evans Drishti**

Falja
e të Dërguarit të Allahut

Allahu e do faljen. Nëse njeriu pendohet për gabimet duke ndier vuajtje në zemër, Allahu e pranon pendimin e tij. Ngaqë Ai është shumë falës, do që edhe robërit e tij të jenë falës.

Kushtet e faljes janë: pendimi, t'u bindesh urdhrave të Allahut dhe t'u largohesh harameve. Shembulli më i mirë i faljes gjendet në jetën e Pejgamberit (s.a.s.). Ai e fali Hindin, që nga tërbimi kishte kafshuar mushkëritë e xhaxhait të Tij Hz. Hamza në luftën e Uhudit, e fali atë për nder të madhështisë së fjalës së njësimit e çlirimit të Mekkes.

Edhe Hebbar bin Esvedi ishte një nga liderët e armiqve të Islamit. Ai e hodhi nga deveja, duke e goditur qëllimisht me topuz Zejnepin (r. anha), vajzën e Pejgamberit (s.a.s.), ndërsa po shpërngulej mbi deve nga Mekka për në Medine. Hazreti Zejnep u plagos rëndë dhe mbeti e mbuluar në gjak duke humbur edhe fëmijën e saj. Plaga që mori u bë shkak për vdekjen e saj. Hebbari bëri edhe shumë krime të tjera si ky. Pas çlirimit të Mekkes, u arratis dhe nuk u kap. Një herë, kur Pejgamberi (s.a.s.) ishte i ulur me shokët e tij në Medine, Hebbari erdhi dhe në praninë e tij njoftoi se ishte bërë musliman. Profeti (s.a.s.) e fali atë bile ndaloi që ta shanin dhe ta ngacmonin. (Vakidi, 2, 857-858)

Ikrime, i biri i Ebu Xhehlit, ishte nga armiqtë e numëruar të Islamit. Pas çlirimit të Mekkes, u arratis në Jemen. Gruaja e tij e solli atë si musliman pranë Profetit sallallahu alejhi ue sellem. I Dërguari i Allahut sallallahu alejhi ue sellem, duke e pritur Ikrimen me kënaqësi, i tha: " Mirë se erdhe o kalorës i mërguar!" dhe e fali duke mos ia përplasur fytyrës dhunën që u kishte bërë muslimanëve. (Tirmidhi, Isti'zan, 34/2735)

Pejgamber (s.a.s.) shpesh lutej kështu: " O Zoti im fale popullin tim sepse ata nuk dinë!" (Ibn Maxhe, Menasik, 56; Ahmet, 4, 14)

Lideri i Jemames, Sumame bin Usal, kur u bë musliman, i ndërpreu marrëdhëniet tregtare me mushrikët e Mekkes, ndërkohë që Kurejshit çdo lloj ushqimi dhe përfitimi i merrnin nga Jemame. Banorët e Mekkes që kishin rënë në uri dhe varfëri, iu drejtuan të shastisur Pejgamberit (s.a.s.). Ai, duke i shkruar letër Sumames, e urdhëroi të

Kushtet e faljes janë: pendimi, t'u bindesh urdhrave të Allahut dhe t'u largohesh harameve. Shembulli më i mirë i faljes gjendet në jetën e Pejgamberit (s.a.s.). Ai e fali Hindin, që nga tërbimi kishte kafshuar mushkëritë e xhaxhait të Tij hazretit Hamza në luftën e Uhudit, e fali atë për nder të madhështisë së fjalës së njësimit e çlirimit të Mekkes.

vazhdonte tregtinë. (Ibn Abdilberr, el-istiab, 1, 214-215; Ibn Esir, Usdu'l-gabe, 1, 295)

Ndërsa mushrikët i patën ndëshkuar muslimanët përgjatë tre vjetëve duke i lënë të vuajnë në uri. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i fali.

Një herë tjetër i Dërguari i Allahut (s.a.s.) në vitin e shtatë pas çlirimit të Hajberit e ndihmoi popullin e Mekkes i cili ishte i mposhtur nga thatësira dhe varfëria duke u dërguar flori, elb dhe bërthama hurmash. Ebu Sufjani, pasi i mori të gjitha këto, ua shpërndau të varfërve të Kurejshëve dhe tregoi kënaqësinë që ndiente duke thënë: "Allahu e shpërbleftë me të mira birin e vëllait tim, sepse ai e mbrojti të drejtën e farefisnisë!" (Ja' kubi, 2, 56)

Pas kësaj të gjithë u bënë muslimanë për shkak të kësaj mirësie aq të madhe.

Në Hudejbije kishte ardhur një grup që donte të vriste të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) duke bërë presion. Grupi u zbulua dhe të gjithë pjesëmarrësit u kapën. Por i Dërguari i Allahut (s.a.s.) i fali ata. (Muslim, Xhihad, 132, 133)

Pas çlirimit të Hajberit një grua kishte futur helm në gjellën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e futi ushqimin në gojë, e kuptoi. Gruaja Jahudie pohoi se i kishte hedhur helm ushqimit, por Pejgamberi (s.a.s.) e fali atë. (Buhari, Tibb, 55; Muslim, Selam, 43)

E gjitha kjo ka një kuptim, në Kur'anin fisnik thuhet:

"(O i Dërguari im!) Trego mëshirë, fal, urdhëro në të mirë dhe largohu prej të paditurve!" (el-A'raf, 199)

Fatmir Sulaj

Ta kemi Kur'anin ushqim të përditshmërisë sonë

Mesut Kaja

Duhet që kësaj thirrje t'i përgjigjemi, ta lexojmë, të mendojmë për të dhe ta lodhim kokën për Kur'anin. Ta bëjmë Kur'anin mik dhe me të të krijojmë shoqëri. Duhet që personalitetin dhe karakterin tonë, ta ndërtojmë me të. Gjithmonë duhet ta kemi Kur'anin më prioritar në përditshmërinë tonë dhe të lutemi: "O Zot, bëje Kur'anin pranverë të zemrës, dritë e shpirtit, shkëlqim të mërzisë dhe pikëllimit tim e ilaç për nevojat e mia!"

Kjo lutje i përket zemrës e cila gjithmonë jeton nën klimën e frymëzimit gjatë stinës së pranverës. I përket një njeriu i cili jeton më së shumti me Kur'an, ku e gjithë jeta dhe morali i tij janë vetëm Kur'an. Ai njeri i bukur vazhdimisht lut Allahun që zemrën e tij ta rregullojë me Kur'an, në mënyrë që ta shijojë freskinë dhe aromën e pranverës, vetëm me Kur'an. Ai është bërë shembulli më i bukur që si një stuhi shiu dhe si një jetë mëshire ka rënë dhe është ndalur, për shkak të asaj freskie dhe jete të gjallë.

Pejgamberi (s.a.s.) na ka treguar se si besimtari duhet që me anë të kësaj lutjeje të krijojë një lidhje shpirtërore me Kur'anin. Në realitet kjo lutje është për neve. Sikur Pejgamberi(s.a.s.) na thotë neve të kërkojmë nga Allahu që lidhjet tona me Kur'anin gjithmonë të jenë të gjalla. Kështu që një besimtar i përpiktë ec nga kjo në mënyrë, që të bëhet shembull i mirë për njerëzit. "***Zemrat stabilizohen me të përmendurit e Allahut dhe me Kur'an***"[1] Kur'ani ia ndryshon njeriut shikimin dhe rrjedhat e jetës. Ashtu si natyra sillet dhe arrin të gjejë jetë në pranverë, po në atë mënyrë ngjallet edhe zemra e njeriut, kur në të depërton Kur'ani.

Allahu i Madhëruar urdhëron: "***O ju që besuat, përgjigjuni All-llahut dhe të dërguarit kur ju ftojnë për atë që ju jep jetë***"[2] Sigurisht se Kur'ani të cilin Pejgamberi gjatë jetës së tij e predikoi, u jep jetë dhe gjallëri besimtarëve. Të gjithë ata të cilët i janë përgjigjur kësaj thirrjeje, kanë hapur sytë për një jetë të re dhe kanë filluar që përsëri ta ndërtojnë jetën e tyre. Shembullin më të mirë të kësaj e shohim në gjeneratën e parë te Sahabëve. Kur ata ishin në injorancën më të errët, iu përgjigjen thirrjes së këtij thirrësi, fituan dhe arritën në një nivel që e gjithë njerëzia ua kishin lakmi.

Në një verset tjetër theksohet se Kur'ani është shërues. Allahu (xh. sh.) thotë: "***Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët.***"[3] Kur'ani shëron besimtarët, qelizë për qelizë përsëri u dhuron jetë organeve te paralizuara, gurë për gurë ua rregullon mënyrat e të menduarit, parashikimet e jetës, marrëdhëniet sociale dhe botën e brendshme. Atyre u tregon krijimin e ekzistencës dhe nevojën njerëzore. Kur'ani thotë: "Eja dhe lexoje veten, lexoje të kaluarën dhe të ardhmen." Ai është një mëshire për njerëzit, e besimtari atij i ka besuar dhe atë e ka bërë busull orientuese të rrugës së tij. Kjo rrugë atij i tregon çdo lloj virtyti dhe sjellje të mirë. Në këtë botë i sjell lumturi, kurse në ahiret e dërgon për në xhennet.

Thotë Pejgamberi(s.a.s.) : " *Në librin e Allahut gjenden tregime për ata që ishin para jush, por ka edhe norma për jetën tuaj dhe atyre që do vijnë pas jush. Ai është ndarës i të vërtetës nga gënjeshtra, nuk është thashethem kotë. Ai i cili e braktis atë nga dhuna e ndonjë zullumqari, Allahu e dënon. Ai i cili kërkon udhëzim jashtë tij, Allahu atë do ta lerë kokë për kokë me sjelljen e tij të shëmtuar. Ai është libri i shendoshë i*

Allahut, këshillë që e ndan diturinë e vërtetë nga e gabuara. Ai është rrugë e drejtë. Zemrat të cilat janë të lidhura me të nuk devijojnë, nuk rrëshqet gjuha që të infektohet me të humburën, nuk ngopen dijetarët me të, nuk vjetrohet ai me lexim, nuk mërzitet dhe nuk kanë fund mrekullitë e tij. Kur e dëgjuan atë xhinët nuk patën mundësi që të ruhen nga thënia: "***Ne kemi dëgjuar një Kur'an që mahnit, që udhëzon në të vërtetën, andaj ne i besuam atij***."[4] *Kush flet sipas tij, e ka thënë të vërtetën, kush e jeton jetën me të e gjen shpërblimin në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Kush gjykon me të, ka gjykuar me të drejtë. Ai i cili fton në të, ka bëtë thirrje në një rrugë shumë të vërtetë.*"[5] Me anë të kësaj thënie Pejgamberi(s.a.s.) ka treguar rrethin e marrëdhënieve të besimtarit me Kur'anin. Besimtari nuk do të kërkojë mënyrë apo rrugë tjetër, por do t'i përmbahet atij. Ai do të jetë elementi dallues i të vërtetës nga gënjeshtra. Menjëherë do t'i dorëzohet atij sikurse vepruan xhinnet, gjuha e tij do të flasë me të. Atë do ta marrë si peshore në të gjitha punët dhe marrëdhëniet, si sociale ashtu dhe ekonomike.

Allahu, Pejgamberi, po edhe vetë Kur'ani thërrasin në të (Kur'anin). Kjo thirrje nuk është bërë një apo dhjetë herë, kjo është bërë me qindra e mijë herë. Allahu (xh.sh.) dhjetë herë në një sure thotë: "Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësim?"[6]

Duhet që kësaj thirrje t'i përgjigjemi, ta lexojmë, të mendojmë për të dhe ta lodhim kokën për Kur'anin. Ta bëjmë Kur'anin mik dhe me të të krijojmë shoqëri. Duhet që përsonalitetin dhe karakterin tonë, ta ndërtojmë me të. Gjithmonë duhet ta kemi Kur'anin më prioritar në përditshmërinë tonë dhe të lutemi: "O Zot bëje Kur'anin pranverë të zemrës, dritë e shpirtit, shkëlqim të mërzisë dhe pikëllimit tim e ilaç për nevojat e mia!"[7]

"Një popull që mendon…"

Allahu (xh.sh.) gjithmonë këmbëngul që ne të mendojmë për Kur'anin Fisnik, me qëllim që atë ta kuptojmë sa më mirë, sepse nuk është e mundur qe të kuptohet pa studiuar mbi të. Ky kuptim sigurisht që njeriun e drejton dhe e orienton në një qëllim të drejtë, që ta udhëzojë dhe distancojë në jetë. Allahu thotë: "Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij, ata që kanë mend."[8] Një nga dijetarët dhe mistikët e mëdhenj të Islamit Hasan Basriu (r.a.) ka thënë: " Falënderimi i takon Allahut! Kur filluan të lexojnë Kur'anin ata që ishin para jush, leximi i tyre vazhdonte gjer në mëngjes e kur vinte mëngjesi, gjendja e tyre dallohej nga fytyrat e tyre. Edhe sot,

Kush nuk e lexon Kur'anin, e ka braktisur atë, kush e lexon Kur'-anin mirëpo nuk mendon në do-methënien e tij atë e ka braktisur, kush e lexon atë dhe mendon në domethënien e tij por nuk vepron sipas urdhrave të tij, edhe ai e ka braktisur Kur'anin.

nëse dikush nga ju lexon Kur'an, ai nuk shkon më tej fjalës që e lexon (nuk mendon kuptimin)."[9] Ja në këtë mënyrë një njeri i cili e ka parë gjeneratën e Sahabeve, i kritikon sjelljet e bashkëkohësve të vet. Vallë ç'do të thoshte po të tregonte për pasardhësit e tyre?

Me të vërtetë në ketë pikë, gjeneratat e sahabeve janë shembulli me i çmuar në çdo gjë; si në aspektin e leximit Kur'anor, po ashtu edhe ne praktikimin e tij. Nga Tabiinet, Ebu Abdurrahman es-Sulemiu ka thënë: "Uthman b. Affan, Abdullah ibni Mes'ud (r.a.) ishin prej sahabeve që na mësonin neve Kur'anin. Kur ata i mësonin 10 ajete nga Pejgamberi (s.a.s.), nuk kalonin në ajetet tjera pa i praktikuar ato në jetë. Ata thonin se: " Ne Kur'anin e mësonim edhe për dituri, edhe për të punuar e jetuar me të." Ky është shkaku që ata qëndronin për një kohë të gjatë tek një sure."[10]

Sa e mrekullueshme është afërsia e Osmanit (r.a.) ndaj Kur'anit! Sa tërheqës është momenti i tij, kur të gjithë armiqtë e patën rrethuar, ndërsa ai edhe në atë moment u mbështet dhe gjeti prehje tek Kur'ani, dhe se ai edhe në këtë gjendje theksoi shehadetin (dëshminë). Apo Abdullah ibni Mes'udi (r.a.) a nuk

ishte ai qe doli haptas për herë të parë para mushrikeve në Qabe për të lexuar Kur'an?

Transmeton imam Maliku nga Enesi (r.a.) se Abdullah ibni Omeri suren El- Bekaretu e kishte mësuar për tetë vite. Sigurisht se këtë sure nuk e ka mësuar vetëm përmendesh, kjo jep të kuptojmë se ky sahab i madh është orvatur që së bashku me këtë (mësimin përmendesh) ta kuptojë dhe praktikoje atë. Po! Ata shumë gjatë mendonin rreth Kur'anit, i mësonin të gjitha të dhënat dhe normat e ajeteve te cilat i kishin me vete, ato i treten në të gjitha qelizat dhe se në brendësinë e tyre (shpirtërore) ndienin praninë e Kur'anit. Zemrat e tyre kishin fituar ato afërsi, sa që i shpëtuan thënies së këtij ajeti: "A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin, apo në zemrat a tyre ka kyçe?"[11] Zemra është një faktor me shumë rëndësi në studimin dhe kuptimin e Kur'anit, pozita e saj ka një rol të madh. Kur'ani duhet të lexohet me sytë e zemrës e jo me një zemër, e cila është nxirë me mëkate, e cila është mykur me pluhur harami, të cilën është vështirë të hapësh dhe asaj zemre, të cilës i është vendosur kyçi. Ai duhet të lexohet me një zemër, e cila ka frikë gjatë respektit dhe adhurimit, e cila është zbutur dhe ka arritur gjendjen e një riprodhimi. Kur'ani duhet të lexohet ashtu siç e kanë lexuar sahabet dhe të parët e ndershëm. Të lexohet dhe të kuptohet, sepse në të kundërtën Pejgamberi do të bëhet dëshmues dhe në ditën e kijamet. Ai do të ankohet kundër nesh tek Allahu. "E i dërguari tha: "O Zoti im! Vërtet populli im e konsideroi këtë Kur'an si (diç) të hedhur!"[12] Dijetaret në lidhje me komentin e këtij ajeti kanë thënë: " Kush nuk e lexon Kur'anin, e ka braktisur atë, kush e lexon Kur'anin mirëpo nuk mendon në domethënien e tij atë e ka braktisur, kush e lexon atë dhe mendon në domethënien e tij por nuk vepron sipas urdhrave të tij, edhe ai e ka braktisur Kur'anin."[13] Ajo për të cilën duhet të brengosemi dhe të shqetësohemi, është ankesa e Pejgamberit (s.a.s.) ndaj nesh, mirëpo gjëja më e rëndësishme e kësaj është se kjo ndodhi është mjaft prekëse që ne ta sjellim të dërguarin, gjerë te kjo pikë.

Fjalën e fundit përsëri ia lëmë Hasan Basriut: "Allahu i mëshiroftë këta robër, të cilët në çfarëdo gjendje që të jenë, për bazë e marrin udhëzuesin Hyjnor, Kur'anin, nëse veprat e tyre janë sipas Kur'anit, ta falënderojnë atë dhe nga Allahu kërkojnë që t'ua rrisë këtë mirësi, mirëpo në qoftë se punët e tyre nuk janë sipas normave Kur'anore, ata menjëherë e braktisin."

Përktheu: **Zymer M. RAMADANI**

1) Ra'd 13/28.
2) Enfâl 8/ 24.
3) İsrâ 17/ 82.
4) Xhin 72/ 1,2.
5) Tirmidhi, Fedailü'l Kur'an 14.
6) Kamer 54/ 17, 22, 32, 40.
7) Musned, II/391,452.
8) Sâd 38/ 29.
9) İbnu'l Xhevzî, Hasan Basrî, përkth. Mustafa KAJA, s. 79.
10) İbn Tejmije, Mukaddime Fî Usulu't Tefsîr, s. 6.
11) Muhammed 47/ 24.
12) Furkân 25/ 30.
13) Sâbûnî, et-Tibyân Fî Ulûmu'l Kur'ân, s.10.
14) İbnü'l Xhevzî, Hasan Basri, përkth. Mustafa KAJA, s. 52.

FJALA E DËSHMISË

La ilahe il-lall-llah
Muhammedur-resul-ullah.

Fjala e dëshmisë
Shenjë e dashurisë.

Rreze e jetës
Thelb'i së Vërtetës.

Gur'i besës
Shkëndijë e shpresës.

Dritë e amshuar
Zjarr i pashuar

Gjurmë ndër shtigje
Urë ndër brigje.

Dy emra në fjali
Më e shtrenjta stoli.

La ilahe il-lall-llah
Muhammedur-resul-ull-llah.

Një fëmijë që rritet

Zehra Kapllan

Fëmijët tanë, pika jonë e dobët, gëzimi ynë, me një fjalë e gjithë jeta jonë. Burimi i lumturisë në shtëpitë tona, shpresa jonë, ëndrrat tona, lulet pranverore. Fëmijët tanë, me ato buzëqeshjet fëminore si ëngjëj pa mëkate.

Çdo fëmijë lind në fenë islame. Prindërit janë ata që më vonë e bëjnë atë musliman, të krishterë ose zjarradhurues. Fëmija është si betoni i sapo zënë në të cilin lë gjurmë çdo gjë që bie. Pastaj me kohë, me besim, edukatën dhe kulturën që i japin prindërit ia përngjasojnë atë vetvetes.

Arsimimi i parë fillon në familje. Eshtë shumë e thjeshtë t'i japësh drejtim fëmijës. Të parët tanë e kanë përdorur drejt shprehjen "pema përthyhet sa është e njomë". Fëmija në atë moshë është tamam si një imitues. Një djalë 1.5-2 vjecar instinktivisht shtron një shtrojë pranë të ëmës që fal namaz, kurse vajza nuk përton të mbulojë flokët dhe të qëndrojë në namaz. Dhe kur jep selam ngre drejt qiellit duart e saj topolake duke thënë "amin". Pjestarët e familjes kënaqen. U tregojnë të afërmve, miqve. E si të mos gëzohen… Fëmija i vogël ka zbatuar një nga kushtet e Islamit. D.m.th. themelin e fesë që është namazi…

Fëmija rritet, dhe i është afruar 1 vjetori. Nuk ka kohë për të humbur. Në mësimin e parë fëmijës i mësohet se "Allahu (xh.sh.) është Një". Sa shpejt që e mëson ai këtë. Më pas kur i thuhet "shpirt ku është Allahu(xh.sh.)?" nëna ia vendos dorën mbi zemër. Fëmija i vogël edhe këtë arrin ta imitojë me sukses. Më pas vijnë brohorimat, të qeshurat. Ditët ecin. Fëmija i vogël tashmë fillon të shqiptojë fjali të përgjysmuara. Çdo ditë në fjalorin e tij shtohen fjalë të reja. Tamam si një papagall përsërit cfarë t'i thuhet.

Eshtë në moshën 2-2.5 vjecare. Mësimi i parë është *Subhaneke*. Nëna me durim, pa u lodhur e pa përtuar ja përsërit këtë shpeshherë çdo ditë. Dhe fundi është i gëzueshëm. Në një kohë të shkurtër dhe pse me disa gabime të vogla fëmija i gëzuar dhe këtë e mëson. Truri i tij është krejt bosh. Njësoj si një kasetë e gatshme për regjistrim… kështu që pa u mbjellë në të gjëra të tjera duhet të regjistrojmë gjëra të bukura në faqe të bardha. Prindërit e zgjuar dhe në

Çdo fëmijë lind në fenë islame. Prindërit janë ata që më vonë e bëjnë atë musliman, të krishterë ose zjarradhurues. Fëmija është si betoni i sapo zënë në të cilin lë gjurmë çdo gjë që bie. Pastaj me kohë, me besim, edukatën dhe kulturën që i japin prindërit ia përngjasojnë atë vetvetes.

veccanti nënat e vlerësojnë mirë këtë kohë. Pas subhanekes i mësojnë përmendësh sure të shkurtra si *Ihlas* dhe *Fatiha*. Nëna me një ton prej mësuesi pyet:

- Krijesë e kujt je bir?

- E Allahut.

- Ymeti kujt je?

- I pejgamberit

- Si e ka emrin pejgamberi ynë?

- Muhammed Mustafa (s.a.s.).

- Si e ka emrin nëna e tij?

- Amine.

- Si e ka emrin babai i tij?

- Abdullah.

- Si e ka emrin gjyshi i tij?

- Abdulmuttalib. E vazhdojnë kështu me pyetje e përgjigje.

Fëmija i vogël këto që mëson ia përsërit çdo mysafiri që vjen. Dhe sigurisht që me të drejtë shpërblehet me ëmbëlsira dhe çokollata. Gjyshërit dhe gjyshet mburren me nipërit e tyre dhe ndihen krenarë me to. Në heshtje këndojnë lutje për syrin e keq duke iu mbështëtur Zotit dhe falënderojnë Allahun që i ka dhënë nipër kaq të mençur e të zgjuar. Muajt kalojnë, mësimi fillon të thellohet pak më shumë. Me një ton zëri të ëmbël dhe të butë fëmijës i mësohet se si ta mbajë lugën me dorën e djathtë, rrobat dhe kepucët t'i vesh nga e djathta dhe t'i heq nga e majta. Para se të flejë, kur të shkojë në shtrat i mësohen të thotë lutje të shkurtra të këndshme:

Fjeta Allah, më mbro mua nëse jam prej mohuesve, më sill në besim. Fjeta Allah, t'u mbështeta. Engjëjt janë dëshmitarë të fesë time, besimit tim.

Pas këtyre lutjeve fëmijët e vegjël bien në një gjumë të qetë.

Në këto vite, fëmijët bëjnë pyetje të tilla që në disa raste i vënë në siklet prindërit.

- Nënë, a na sheh Allahu ne?

- Mami, në xhami jeton Allahu?"

- Babi, më i madh se ty është Allahu? Babai dhe nëna përballë këtyre pyetjeve mbesin si të habitur.

Si dje e kujtoj kur e pyeta nënën se ku gjendej Allahu. Ajo mu përgjigj:

- Allahu nuk është as në tokë, as në qiell, as djathtas, as majtas, as para, as prapa. Allahu është i pranishëm në çdo vend. Ai shikon dhe vrojton çdo gjë të fshehtë dhe të hapur. Ai është Zoti i hënës, i diellit, i yjeve, tokës dhe i qiellit. Ai është që e bën të bie borën, shiun, bën të fryjë erën, bën të çelin në siperfaqen e tokës lulet ngjyra-ngjyra, bën të prodhohen fruta dhe perime të ndryshme me aromë dhe shije të mrekullueshme, dhe sërish është Ai që ka krijuar nga lloje të ndryshme njerëzit dhe kafshët.

përpiqesha t'i kuptoja këto gjëra të mëdha. Serioziteti në fytyrën e nënës dhe vendosmëria në zërin e saj nuk më linte shkak për të bërë pyetje të tjera.

Netëve ndërsa shikonim hënën, nëna na thoshte:

- Ejani dhe thoni "Allah pashë hënën, Amentubilah, mëkatet i kam të shumta më fal mua Allah"

Kështu na vinte në gjumë, na mësonte të përkujtonim Allahun ne çdo send që shikonim. Kur uleshim në tryezë në fillim duhet të lanim duart, dhe pa filluar kafshatën e parë duhet të thonim "Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim" kur të ngriheshim prej saj të thonim "Zoti im, Ti që na ushqeve, ushqe dhe krijesat e tjera të uritura" dhe ta falënderonim. Na mësonte të mos kishte asnjë mangësi në ushqim.

Kur pinim ujë na mësonte të thonim lutjen "Vesekahum Rabbuhum sheraben tahura", kur teshtinim thonim "Elhamdulilah-Jerhamukallah", kur hipnim në ndonjë mjet thonim "Bismilahi mexhraha ve mursaha inne Rabbi le gafurru-rrahim", kur ngriheshim në mëngjes na mësonin të thoshim "Rabbi jesir vela tuassir Rabbi temmim bil hajr".

Në moshën 5-6 vjeçare sëbashku me abetaren ne thelloheshim edhe në mesimin e sureve të gjata të namazit. Nëse nuk bie shi, nëse është perhapur thatësira do të thotë që ka nevojë për lutje. E kush mund ta bënte këtë më mirë se femijët e pafajshëm.

Nëna menjëherë na urdhëronte të ngrinim duart drejt qiellit dhe kështu bashkë me lutjet trokisnim në derën e mëshirës. Ashtu si uji që derdhet në gotë shiu rridhte me furi dhe vetëtimat që binin na ngrinin zemrën. Por frika nuk është shpëtim, sërish me lutje duhet t'i mbështeteshim Zotit. E kështu ndërsa vetëtimat dhe bubullimat që binin ndriçonin vendin, së bashku me nënën me lutjet plot frikë dhe shpresë i mbështeteshim mëshirës së Zotit. Në netët e verës, kur uleshim në verandën e shtëpisë më pëlqente shumë ndërsa shikoja yjet që binin. Nëna sërish më kështillonte të thosha ndërsa shikoja qiellin: "Rabbena ma halekte hadha batila. Subhaneke vekina adhabennar".

Arsimim, arsimim, sërish arsimim! çdo gjë e kishte zanafillën nga ajo. Islami e përmbledh jetën e muslimanit nga lindja deri në vdekje, nuk e lë atë vetëm dhe pa përkrahje. Nëse merrnim një lajm vdekjeje menjëherë na mësonin të thoshim "Inna lillahi ve inna ilejhi raxhiun" d.m.th. "O Zot nga Ty erdhëm dhe sërish tek Ti do të kthehemi"

Na nxitnin të lexonim lutje të shkurtra dhe të tërhiqnim tespijet e vogla që i mbanim në xhepin e pantallonave. Nëse thoni "Subhanallahi ve bi hamdihi Subhanallahil adhim" në xhennet për ju do të mbillen pemë thoshte gjyshja. Dhe ne e thonim menjëherë me një dëshirë të madhe. Pastaj kërkonim të na mësonte të tjera lutje. Thoni "La havle ve la kuvvete illa bilah" na thoshte. E nëse nuk jeni lodhur thoni 100 herë "Hasbunallahi ve nimel vekil". As që bëhej fjalë për lodhje, duke dëgjuar për xhennetin dhe të mirat e tij ne donim të bënim akoma më tepër.

Vitet ecnin, kur përballeshim me vështirësitë e jetës dhe nuk dinim se si të dilnim prej tyre sërish na vinte në ndihmë nëna e cila me një lutje na mësonte "Allahu im, Ti je Një i Vetmi. Ty të mbështetem për vështirësitë e mia, Ti je shpëtimtari im". Pas kësaj lutjeje që dilte nga thellësia e shpirtit, Zoti sikur na i lehtësonte zemrat.

E gjithë gjithësia me shpirt e pa shpirt e adhurojnë Allahun, po pse njeriu mbetet pas gjithë këtyreve! Mendo për të sotmen, të nesërmen, dhe ditët që do të vijnë pas saj. A nuk e din se dita e vërtetë është e sotmja. Sepse e djeshmja ka kaluar tashmë dhe të nesërmen nuk i dihet nëse mund ta mbërrish. Por ajo që duhet të vlerësosh në të vërtetë është e sotmja.

Një dite vdes një burrë dhe e varrosin. Çdo ditë vijnë ëngjëjt e ndëshkimit për ta ndëshkuar për shkak të veprave të këqia që ka bërë. Muajt, vitet kalojnë. Djali i personit në fjalë ishte bërë 6 vjeç. Kishte mësuar të lexonte Bismilahin dhe abetaren. Atë ditë ëngjëjt e ndëshkimit i japin këtë lajm të mirë burrit: "Urime, ndëshkimi yt u lehtësua. Djali që ke lënë pas ka bërë një punë të mirë. Ka mësuar emrin e Zotit dhe shkronja nga libri i tij". Kjo histori tregon se sa i rëndësishëm është arsimimi i femijës. Për këtë arsye edukimi i brezave ëe rinj duhet të jetë një prej qëllimeve tona në mënyrë që të na e zbardhin faqen si në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Prandaj mos t'i lëmë këto buqeta lulesh në dorë të erërave të dëmshme, sepse ata janë më të shtrenjtët tanë, janë të nesërmet tona. T'i edukojmë ata në rrugën e Allahut që në botën tjetër të mos bëhen paditës kundra nesh.

Përktheu: **Aida Sijani**

Për këtë arsye edukimi i brezave të reja duhet të jetë një prej qëllimeve tona në mënyrë që të na e zbardhin faqen si në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Prandaj mos t'i lëmë këto buqeta lulesh në dorë të erërave të dëmshme, sepse ata janë më të shtrenjtët tanë, janë të nesërmet tona. T'i edukojmë ata në rrugën e Allahut që në botën tjetër të mos bëhen paditës kundër nesh.

Të gjesh jetë në Kur'an

Osman Ersan

Kur'ani Famëlartë është fjalë hyjnore që i është zbritur Muhammedit (Sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem) nga Allahu(xh.sh.) për t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë. Ai duhet lexuar me madhështi, respekt dhe me bindjen se është fjala e Zotit të Madhëruar që të bën të meditosh rreth kuptimit të pasur të tij. Kështu, shpërblimi, virtyti dhe mirësia që vjen pas leximit të Kur'anit është shumë e madhe. Në shkëmbim të çdo germe jepen dhjetë sevape, prandaj këshilla profetike na pororsit kështu:

"Për secilin që lexon një germë nga Kur'ani Famëlartë ka një mirësi. Dhe për çdo mirësi ka dhjetë sevape. Unë nuk po them se "elif lam mim" është një germë; elifi është një germë, lami është një tjetër dhe mimi është një tjetër germë." (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 16)

Kudo që përmenden virtytet në librat fetarë, njëri prej tyre patjetër është leximi i Kur'anit. Për shembull:

"Dhjetë gjëra zgjasin jetën"-thuhet. Njëra prej tyre përmendet se është "leximi i Kur'anit"

"Pesë gjëra shtojnë fuqinë e trupit" -është thënë. Njëra prej tyre thuhet se është "leximi i Kur'anit".

Është thënë se **"Pesë gjëra shtojnë dritën e syrit".** Njëra prej tyre është "leximi i Kur'anit".

"Zemra ka pesë ilaçe" thuhet. Njëra prej tyre është "leximi i Kur'anit".

"Katër gjëra janë që të dukshmet janë virtyt dhe të brendshmet janë obligim." Njëra nga këto "leximi i Kur'anit Famëlartë është nderim dhe të veprosh sipas tij është obligim."

Thuhet se **"katër gjëra forcojnë kujtesen."** Njëra prej tyre është thënë se është "leximi i Kur'anit".

"Gjashtë gjëra janë ndriçim" -thuhet. Njëra nga këto është "leximi i Kur'anit".

Në një porosi të tij, Profeti i dashur na thotë:

"Tre zëra i do Allahu i Madhëruar". Njëri prej tyre është "zëri i besimtarit që lexon Kur'anin Famëlartë".

Thuhet se **"katër gjëra ndriçojnë varrin e besimtarit"**. Njëra prej tyre është "leximi i Kur'anit Famëlartë".

Në një hadith thuhet: **"Parajsën e ka marrë malli për katër njerëz nga pasuesit e mi"** Njëri nga ata është "ai që lexon Kur'anin Famëlartë".

Hz. Evzai thotë: **"Katër gjëra janë ato që Pejgamberi** -Sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem-**, sahabët dhe ndjekësit e tyre nuk u janë shmangur kurrë"**. Njëra prej tyre përsëri është "leximi i Kur'anit Famëlartë".

"Mburojët e besimtarit janë tre" -thuhet. Njëra prej tyre tregohet se është "leximi i Kur'anit".

"Ai që dëshiron t'i shpëtojë vuajtjeve të varrit t'i shtrëngojë katër gjëra" -thuhet. Përsëri njëra prej tyre përmendet se është "leximi i Kur'anit".

"Dhjetë veçori janë që e bëjnë njeriun të arrijë gradën më të lartë" thuhet. Njëra nga këto tregohet se është "leximi i Kur'anit".

Leximi i Kur'anit Famëlartë ndriçon zemrën dhe largon gjynahet. Një herë, duke biseduar me miqtë e tij, Profeti ka thënë:

-*"Edhe zemrat ndryshken si hekuri!."* Sahabët e nderuar e pyetën:

"O i Dërguar i Zotit! Me se pastrohet ndryshku i zemrave?"

Pejgamberi i dashur u tha:

"Pastrohet duke lexuar Kur'anin Famëlartë dhe duke kujtuar vdekjen" (Tirmidhi)

Si duhet lexuar?

Kur'ani Famëlartë duhet lexuar duke e menduar kuptimin, ngadalë dhe një nga një. Andaj, në versetin kur'anor thuhet kështu:

"Lexoje Kur'anin ngadalë dhe me vëmendje" (Muzemmil, 4)

Në një hadith thuhet:

"Atij që lexon përherë Kur'an do t'i thuhet kështu: Lexo dhe ngritu! Sikur e ke lexuar me ngadalë dhe me vëmendje (tertil) në botë, ashtu lexoje edhe këtu. Padyshim që grada jote është sipas leximit që i ke bërë versetit." (Ebu Davud, Vitr, 20)

Leximi i Kur'anit Famëlartë ndriçon zemrën dhe largon gjynahet (mëkatet). Një herë, duke biseduar me miqtë e tij, Profeti ka thënë:

-"Edhe zemrat ndryshken si hekuri!."

Sahabët e nderuar e pyetën:

"O i Dërguar i Zotit! Me se pastrohet ndryshku i zemrave?"

Pejgamberi i dashur u tha:

"Pastrohet duke lexuar Kur'anin Famëlartë dhe duke kujtuar vdekjen"

Muslimani që do lexojë Kur'anin Famëlartë duhet të marrë abdest dhe duke u drejtuar nga kibla duhet ulur në gjunjë, të mbajë Kur'anin Famëlartë në lartësinë e kraharorit dhe ta lexojë me edukatë. Në një hadith thuhet:

"Sa lexues të Kur'anit ka që Kur'ani ata i mallkon."

Kur lexohet Kur'ani Famëlartë duhet heshtur dhe duhet dëgjuar me përkushtim të veçantë. Prandaj dhe në Kur'anin Famëlartë thuhet:

"Kur lexohet Kur'ani dëgjojeni (me vëmendje) **dhe heshtni,** (mos flisni), **në mënyrë që të fitoni mëshirë!"** (A'raf, 204)

Shtëpia që lexon kur'an

Në shtëpinë ku lexohet Kur'ani Famëlartë shtohet pasuria dhe begatia. Ebu Hurejre- radijallahu anh- thotë:

"Në atë shtëpi që lexohet Kur'ani Famëlartë shtohet pasuria dhe begatia. Largohen djajtë dhe engjëjt zbresin pikërisht aty. Në shtëpinë që nuk lexohet Kur'ani Famëlartë paraqiten skamja, shqetësime dhe probleme. Engjëjt e mëshirës largohen prej aty dhe e pushtojnë djajtë atë vend."

Në një hadith, në lidhje me një shtëpi që nuk lexohet Kur'an brenda thuhet:

"Shtëpia më e pavlerë është ajo shtëpi që nuk e ka librin e Allahut."

Në një hadith tjetër thuhet kështu:

"Engjëjt shkojnë menjëherë në një shtëpi ku lexohet Kur'an." (Ramuzu'l-Ehadith)

Ata që lexojnë Kur'anin Famëlartë me sinqeritet dhe me zë të bukur i dëgjojnë edhe engjëjt. Bera bin Adhib (radijallahu anh) tha kështu:

"Njëri po lexonte suren Kehf. Pranë kishte një kalë të lidhur me dy litarë të gjatë. Sipër tij erdhi një re që edhe më shumë po i afrohej. Edhe kali u frikësua nga reja. Në të gdhirë, shkoi te Profeti (Sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem) dhe ia tregoi ngjarjen. Profeti(s.a.s.) i tha:

"Ajo është prehje. Ngase e ke lexuar ka zbritur." (Muslim, Musafirin, 240)

Të njëjtën ngjarje e shpjegon më detajisht Ebu Said el-Hudri, në fund të rrëfimit shton këto:

"Këta janë engjëjt, ty po të dëgjonin. Nëse do vazhdoje të lexoje do të dëgjonin gjer në mëngjes. (Madje,) do i shikonte ata dhe populli dhe ata nuk do fshiheshin prej popullit." (Muslim, Musafirin, 243)

Në një hadith tjetër thuhet kështu:

"Më i miri ndër ju është ai që mëson Kur'an dhe që u mëson të tjerëve."(Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21)

Pejgamberi (Sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem) thotë:

"Dy njerëz ia vlen të kihen zili. Njëri është ai që e përvetëson Kur'anin dhe që lexon Kur'anin ditë natë. Kurse tjetri është ai që Allahu i ka dhënë plot pasuri dhe që e jep atë ditë natë." (Buhari, Ilm, 15)

Kur'anin Famëlartë duhet lexuar shumë. Sepse në ditën e gjykimit ai do u bëhet ndërmjetësues lexuesve të tij. Pejgamberi (Sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem) thotë:

"Lexoni Kur'an! Sepse Kur'ani, në ditën e gjykimit do ndërmjetsojë ata që e kanë lexuar atë."(Muslim,

Musafirin, 252)

Në një hadith, bëhet një krahasim i tillë për muslimanët që lexojnë Kur'an:

"Besimtari që lexon Kur'an është si portokalli: Aromën e ka të këndshme dhe shijen të mirë. Besimtari që nuk lexon Kur'an është si hurmë(arabe): Nuk ka aromë, ndërsa shijen e ka të mirë. Hipokriti që lexon Kur'anin Famëlartë është si borzilok (fasligen): Aromën e ka të këndshme, mirëpo shijen e ka të hidhur. Hipokriti që nuk lexon Kur'anin Famëlartë është si shalqi Ebu Xhehil: Nuk ka aromë dhe shijen e ka të hidhur." (Buhari, Et'ime, 30)

Kur'anin Famëlartë duhet lexuar duke e zbukuruar zërin. Sepse edhe në hadith thuhet:

"Zbukurojeni Kur'anin Famëlartë me zë të bukur." (Ebu Davud)

Ata që kanë mësuar përmendësh Kur'anin përgëzohen me ndërmjetësim dhe xhennet. Perjgamberi- sal'lall'llahu alejhi ue sel'lem- thotë kështu:

"Kush e lexon Kur'anin Famëlartë, e mëson përmendësh atë, të lejuarën e pranon të lejuar dhe të ndaluarën të ndaluar, Allahu në sajë të kësaj e fut atë në xhennet. Ai person ndërmjetëson për dhjetë vetë nga familja e tij, të cilët e kanë merituar xhehennemin." (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 13)

Kur'ani Famëlartë duhet lexuar duke menduar se është fjalë e Zotit të Madhëruar dhe duke u mpleksur me kuptimin dhe përmbajtjen e tij. Kur'ani Famëlartë që lexohet në këtë mënyrë, ndikon në zemër, ia shton devotshmërinë dhe vizionin fetar (irfan) muslimanëve. Një nga miqtë e Allahut, Vuhejb bin Verdi thotë:

"Nuk ka asgjë tjetër që të nxit për një ndjenjë të veçantë emocionale sa leximi i Kur'anit Famëlartë duke e kuptuar dhe menduar." (Evliyalar Ansiklopedisi, v. 12, f. 157)

Allahu i Madhëruar e lartëson dhe e nderon

Besimtari që lexon Kur'an është si portokalli: Aromën e ka të këndshme dhe shijen të mirë. Besimtari që nuk lexon Kur'an është si hurmë(arabe): Nuk ka aromë, ndërsa shijen e ka të mirë. Hipokriti që lexon Kur'anin Famëlartë është si borzilok: Aromën e ka të këndshme, mirëpo shijen e ka të hidhur. Hipokriti që nuk lexon Kur'anin Famëlartë është si shalqi Ebu Xhehil: Nuk ka aromë dhe shijen e ka të hidhur.

popullin që e respekton Kur'anin Famëlartë dhe ligjin e tij. Kurse ata popuj që nuk e vlerësojnë Kur'anin i degradon dhe i shkatërron. Prandaj dhe sulltanët osmanë që nga formimi perandorisë së tyre Kur'anin Famëlartë e kanë respektuar dhe dashur shumë. Moszgjatja e këmbëve e Osman Gazit ndërkohë që flinte në një dhomë ku ishte Kur'ani Famëlartë; fillimi i traditës shekullore të këndimit të Kur'anit pranë amaneteve të shenjta nga Javuz Sulltan Selim Hani janë pjesë që tregojnë konsideratën që kanë pasë ndaj Kur'anit. Duke e parë nga ky këndvështrim, Osmanët janë përballur me një ndihmë të veçantë hyjnore. Kjo veçori që i lartëson Osmanët në një hadith përmendet kështu:

"Padyshim që Allahu i Madhëruar, për shkak të këtij Libri (Kur'anit) disa popuj i lartëson dhe popujt e tjerë (që nuk e vlerësojnë si duhet) i degradon. (Muslim, Musafirin, 269)

Jahja Kemal Bejatllë shkakun dhe urtësinë e jetëgjatësisë së Perandorisë Osmane e lidh me urdhrin dhe testamentin e Javuz Sulltan Selim Hanit për të lexuar Kur'anin Famëlartë pa ndërprerje që nga viti 1520 deri në vitin 1924 në vendin e Amaneteve të Shenjta të Topkapi Sarajit.

Përveçse na duhet të lexojmë Kur'an që të gjejmë jetë në të, duhet ta zbatojmë atë, duhet t'i sistemojmë të gjithë fragmentet e jetës sonë me përkujdesje ndaj urdhëresave dhe ndalesave të Tij, sepse Kur'ani Famëlartë nuk ka zbritur vetëm të lexohet, por edhe të zbatohet nga çdo individ dhe çdo shoqëri.

Përktheu: **Artur Tagani**

Shejma Sulltan

TË JESH FËMIJË NË XHAMI

Po zemrën e nanës kush do ta qetësoje? Kush e merr përgjegjësinë e namazit të humbun? Kush e merr mëkatin e dinamitit të vendosun në themelet e jetës fetare të fëmijës? Ma e randsishmja; si një gur i hedhun në ujë, në jetën e fëmijës fobia ndaj xhamisë përhapet në formë rrathësh, e kjo si do të ndikonte në përjetimet fetare të tij në të ardhmen?

Sa gja e bukur asht fminija… Kur na kujtohet ajo në fytyrat tona shihet buzëqeshja... Si shiriti i ndonjë filmi kalon para syve tonë… dhe… si nga një andërr e bukur kthehemi në "tash".

Apo jo? Të pastër e të pahile aq sa të çiltër e të padjallëzuem. Të ngrohtë në përqafim, e të thellë në bukurinë që buron nga brenda… Fjalët nuk ndyhen me mbiemna nga ma të ndryshmit. Sytë si xham kurse faqet të kuqta e të ndezuna…Në buzë ka një buzëqeshje të ambël. Këto janë sekretet që na bajnë të qeshim kur shohim ndonjë fëmijë.

Jemi tue hy në tre muejt e madhnueshëm që shoqnohen me rrëke mëshire. Kemi fillue ta ndiejm freskun e muajit të Ramazanit.

Jemi në fazën e përgatitjes materiale e shpirtnore. Po përgatitemi për agjërimet e mbajtuna me ndërpremje. Gjallnojmë dialogun ndërmjet nesh me xhamitë e netët e mëdhaja. Jemi të përmalluem për ajrin që bart erën e mëshirës e vlerave shpirtnore gjithashtu për avujt e ngrohtë të teravive.

Me familjen dalim jashtë nga shtëpia me u ba pjesmarrës të rreshtave të xhamisë. Nganjëherë i premtojmë fëmijëve se "Kur të kthehemi do t'i marrim diçka si dhuratë". E kajherë ato me shprehjet "Nanë, të jap fjalën se nuk do të baj ndonjë sherr" a nuk bahen shkak për me shkue në xhami?

Dëshirojmë që ato të përfitojnë nga ai ambient i kandshëm e të hedhin themele të shëndoshta të xhamisë në jetën e tyne.

Por nganjëherë me at zanin e hollë sikur kputet shiriti i një filmi kputet edhe përfundimi i gjanave "Ulu këtu! Kjo asht xhami!" Kësaj i shtohen edhe fjali të tjera. "Nëse nuk ulesh do dalësh jashtë" ose "Ky asht vend ku falet namaz apo vend lojnash?" Mbas ktyne fjalëve nana e merr fëminë e del jashtë pa mendue mirë për pasojat. Pa fal as namazin! Tamam në këtë kohë diçka shkëputet prej zemrave.

Po në qoftë se pas daljes nuk pason rihymja? Kush do ta mbyll plagën e hapun në zemrën e fmijës?

Po zemrën e nanës kush do ta qetësoje?

Kush e merr përgjegjësinë e namazit të humbun?

Kush e merr mëkatin e dinamitit të vendosun në themelet e jetës fetare të fmijës?

Ma e randsishmja; si një gur i hedhun në ujë, në jetën e fmijës fobia ndaj xhamisë përhapet në formë rrathësh, e kjo si do të ndikonte në përjetimet fetare të tij në të ardhmen?

Krejt ndryshe prej ktyne veprimeve të serta, nëse i themi "Të lumtë, unë ndihem krenar me ty" apo

Sa i mirë paske dalë sot sigurisht si përdit" edhe kur ai përpiqet me vue kapelen apo edhe shallin në mënyrë të shkujdesun, apo kur krehet me duert e tij të vockla. Nji përkëdhelje dhe dhurimi i një të puthune të ngrohtë prindi sa mirë do t'i bante apo jo?

Nga xhepi nëse nxjerrim ndonjë çokollat apo sheqer dhe e qerasim duke i thanë "Urdhno" A i keni pa sa gëzohet?

Përdit sikur të vinë në xhami fmijët përpiqen të zbulojnë diçka të re. Llampadarët e ri të tavanit, mikrofonat, tapetat, dyert, shkrimet e tabelat e ndryshme, çokanet e dyerve e deri tek muret, i shohin e ato të mbërritshmet i prekin apo ledhatojnë me dorë. Pastaj shetisin aty përreth. Kur nuk shohin diçka të re atëherë sorollaten rreth xhematit me nje turp fminor. Mundohen t'i japin përgjigje pyetjeve si "Mos asht ndokush i njoftun në mesin e tyne? A thue ka ardhun ndonjë fytyrë e re sot?"

Në ka ardhun baba i tij atëherë kërkon me e lajmërue sa ma shpejt për ardhjen e tij në xhami.

Krahas njerëzve që i kuptojnë kështu këta fmijë do të ket' sigurisht edhe prej atyne që i kuptojnë ndryshe. Ato frikësohen , ulin shikimet e kthehen tek nanat e tyne kur disa prej xhematit pasi i shikojnë në një mënyrë të ashpër i thojnë "Shiko, mos m'kalo edhe një herë përpara! Mos ma shkel ma saxhaden teme! E nëse këtʼ pasi e ka vue re edhe nana e tij e kap për krahi duke e shtërngue për me i dhanë edhe mësimin në mënyrën ma të ngutshme. Sa keq ndihet njeriu kur pastërtia e bukuria e të qenunit fmij shdërrohet deri në turp e bezdi.

Një ditë Profetin (s.a.s.) tek po mbante në shpinë nipin e tij Hz.Hasanin (r.a.) e sheh një sahab.I çuditun ai i thotë Hz. Hasanit (r.a.):

O fatlum! Paske hypyn në një vend të mirë e të bekuem!

Profeti(s.a.s.) atij i thotë:

Po aq i mirë e i bekuem asht edhe hypsi.

Historia islame asht e mbushun me shembuj të tillë.

Njëri nga komandantët e fisit Temim mbet i habitun kur Profeti(s.a.s.) e puthi nipin e tij me dashuni e mëshirë. Ai i thotë profetit(s.a.s.) :

"Unë kam dhjetë fëmijë dhe deri sot s'kam puthun asnjenin prej tyne."

Profeti(s.a.s.) i kthen përgjigje atij duke vendosun edhe një parametër universal:

"Ato që nuk mëshirojnë, nuk do të mëshirohen"

Për edukimin shpirtnor e fizik të fmijëve duhet dashuni, njohuni, përvojë dhe moral. Këto duhet t'i jepen pa i thye shpirtnisht e pa i mërzit ata.

Ma e randsishmja asht të mos harrojmë se ata janë fmij.

Tue realizue obligimet e fesë sonë sipas së cilës edhe buzëqeshja e gojambëlsia asht lëmoshë (sadaka), duhet t'i hapim rrugë jo largimeve e shkatërrimeve por shkrimeve të cilat gdhenden në zemrën e tyne përjetësisht.

Si përfundim, le të jetë e lehtë, e kollajtë me ken fëmij në xhami…Jo e vështirë

Përktheu: **Alban KALI**

Osman Nuri TOPBASH

Ndjenjat e dashurisë dhe shërbimit ndaj Kur'anit Fisnik.

Kur'ani Fisnik është shëronjësi i zemrave tona, ushqimi i shpirtrave tanë dhe burimi ynë i shërimit. Aq sa të jetë dashuria dhe besnikëria jonë ndaj këtij libri, aq do të jetë edhe shërimi i plagëve tona nëpërmjet tij, sepse Zoti ynë na e ka dhuruar atë si "shërim dhe mëshirë".

"Gjuha e Kur'anit është mëse e thjeshtë dhe e ëmbël. Asnjë libër në botë nuk ka merituar dhe nuk meriton atë respekt që ka pasur Kur'ani. Madje muslimanët nuk mund ta prekin atë në qoftë se nuk janë tërësisht të pastruar".

Kur'ani është epiqendra shpirtërore e respektit dhe dashurisë për të gjithë besimtarët, sepse ai duke qenë fjala e Zotit tonë dhe në të njëjtën kohë edhe udhërrëfyes drejt udhëzimit, na e kujton përherë Allahun. Prandaj edhe Kur'ani është burim dashurie në çdo zemër që e njeh Zotin dhe i drejtohet Atij me përgjërime. Edhe një nga karakteristikat e ummetit të Muhammedit është ndjenja e nderimit ndaj Kur'anit. Allahu në lidhje me këtë të vërtetë thotë:

"Me të vërtetë u kemi shpallur një libër që është krenari për ju. A nuk e kuptoni?" (el-Enbija, 10)

Pa qenë bashkëbisedues i dritës rrezatuese të Kur'anit, nuk mund të konceptojmë të vërtetat rreth Krijuesit dhe nuk mund ta mësojmë sekretin e pyetjeve nga vjen dhe ku shkon njeriu. Për këtë arsye Kur'ani është drita e gëzimi i zemrës tonë dhe burimi më i begatë i përudhjes. Jeta e fiseve, që para Islamit ishin shndërruar në ujqër për njëri-tjetrin u mbulua nga prehja e ëmbël. Kur'ani është ylli drejtues, prandaj popujt që e kanë pasuar atë në çdo kohë dhe çdo vend janë lartësuar në kulmin e prehjes dhe lumturisë.

I dërguari i Allahut ka thënë:

"Kur'ani është thesari që nuk ka pasuri tjetër pas tij, as jashtë tij" (Hejthemi, Mexhmeu'z-Zevaid, VII, 158)

Në një hadith kudsi thuhet :

"Nëse leximi i Kur'anit dhe përmendja që më bënë mua e privon ndokënd nga mundësia që të më kërkojë ndonjë gjë prej Meje, atëherë Unë atij do t'i dhuroj më shumë prej saj sesa u dhuroj atyre njerëzve që më luten për të". (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 25)

Dashuria dhe madhërimi i Kur'anit

Sikurse ngjan edhe me llojet e tjera të respektit, edhe në respektin që duhet treguar ndaj Kur'anit shembujt që na kanë arritur nga sahabët ekspozojnë mënyrën më të bukur. Kur'ani qe udhërrëfyesi i tyre gjatë gjithë jetës. Ky ndryshim vjen se ata ishin edukuar sipas klimës së moralit të profetit. Kështu Umeri dhe Uthmani (r.a.) e kishin bërë zakon që çdo mëngjes kur ngriheshin ta puthnin Kur'anin. Edhe Abdullah bin Umeri çdo mëngjes e merrte Kur'anin ndër duar e puthte dhe thoshte: "Ky është premtimi dhe urdhëri i Zotit tim" (Kettani, Teratib, II, 196-197) Ikrimeja (r.a.) e merrte Kur'anin në dorë dhe mes lotësh thoshte : "Fjala e Zotit tim! Libri i Zotit tim" duke shprehur kështu respektin dhe dashurinë që kishte ndaj tij. (Hakim, el-Mustedrek, III, 272)

Përballë këtyre shembujve, në ditët tona kur kemi aq shumë nevojë për t'u stolisur me mësimet e Kur'anit, për fat të keq dëgjojmë fetvat e disa njerëzve të pamatur që pohojnë se Kur'ani mund të lexohet edhe nëse nuk kemi abdes.

Në Kur'an thuhet hapur dhe prerë se:

"Atë nuk e prek kush përveçse të pastruarit". (el-Vakia, 79)

Në këtë ajet përfshihen nevojat fiziologjike, ejakulimi, të përmuajshmet dhe lehonia e grave. Sipas katër medh'hebeve të sakta Mus'hafi nuk mund të preket po nuk patëm abdest[1] (el-Mevsuatu el-Fikhijje, XVIII, 322) Edhe tradita 1400 vjeçare që nga Profeti ka qenë e tillë. Edhe në hadith thuhet:

"As gruaja me të përmuajshme, as personi xhunup nuk mund të lexojë gjë nga Kur'ani". (Tirmizi, Taharet, 98/131)

Po kështu ndërsa i Dërguari i Allahut po e niste Amr b. Hazmin për në Jemen i dha të shkruar edhe një shkresë në të cilën i shpjegonte se cilat janë farzet, synetet dhe situatat e tjera ligjore. Në atë shkrim pasi i shpallet Amrit se ai do t'u mësonte Kur'anin dhe do t'u shpallte dituritë dhe urtësitë që buronin prej tij njerëzve në vendin ku po shkonte, i njoftohej edhe se do t'u mësonte atyre se është e ndaluar që ta preknin Kur'anin në rast se ishin të papastër. (Kettani, I, 216)

Edhe këto fjalë të shprehura nga një orientalist janë

një tjetër dëshmi se në çfarë grade të respektit dhe përpikmërisë tregonin muslimanët gjatë shekujve ndaj Kur'anit:

"Gjuha e Kur'anit është mëse e thjeshtë dhe e ëmbël. Asnjë libër në botë nuk ka merituar dhe nuk meriton atë respekt që ka pasur Kur'ani. Madje muslimanët nuk mund ta prekin atë në qoftë se nuk janë tërësisht të pastruar". (Eshref Edip, Madhështia e Kur'anit, fq. 58)

Kur'ani Fisnik është i pari nga "dispozitat Islame" më të rëndësishme.

"Kush i respekton dispozitat e Allahut nuk ka dyshim se kjo buron nga devocioni i zemrave" (el-Haxh, 32)

Sahabet e Profetit përveç se e respektonin dhe madhëronin Kur'anin kalonin një kohë të mirë të kohës duke e lexuar atë, nuk dëshironin të shkonte asnjë ditë në të cilën të mos kishin lexuar prej tij apo të mos e kishin shfletuar atë. Ditët e tyre nisnin me Kur'an, madje edhe atyre që ankoheshin për shikimin e dobët u këshillonin që ta shfletonin Mus'hafin. Madje Osmani (r.a.) i pat vjetëruar dy Mus'hafë që kishte nga përdorimi i shpeshtë. (Kettani, II, 197) Sa e sa njerëz ju përmisua shikimi i dobët që kishin kur mjekimin përkatës e shoqëruan edhe me lutjet e tyre drejtuar Allahut të Madhëruar. Kjo nuk ishte gjë tjetër përveçse rezultat i përpjekjeve dhe qëllimit të sinqertë të një djaloshi i cili megjithëse e kishte shikimin e dobët përpiqej që të bëhej hafiz.

Kur Ebu Dherri i pat thënë Profetit:

- O i Dërguar i Allahut! Më jep një këshillë.

Zotëria i Botëve iu pat përgjigjur:

Kur'ani është epiqendra shpirtërore e respektit dhe dashurisë për të gjithë besimtarët, sepse ai duke qenë fjala e Zotit tonë dhe në të njëjtën kohë edhe udhërrëfyes drejt udhëzimit, na e kujton përherë Allahun. Prandaj edhe Kur'ani është burim dashurie në çdo zemër që e njeh Zotin dhe i drejtohet Atij me përgjërime. Edhe një nga karakteristikat e ummetit të Muhammedit është ndjenja e nderimit ndaj Kur'anit.

- Shiko të gjesh kohë për të lexuar Kur'an dhe për ta përmendur Allahun, sepse Kur'ani është dritë për ty në këtë botë dhe furnizim për ty në qiej. (Ibn Hibban, Sahih, II, 78)

Kur'ani Fisnik është shëronjësi i zemrave tona, ushqimi i shpirtrave tanë dhe burimi ynë i shërimit. Aq sa të jetë dashuria dhe besnikëria jonë ndaj këtij libri, aq do të jetë edhe shërimi i plagëve tona nëpërmjet tij, sepse Zoti ynë na e ka dhuruar atë si "shërim dhe mëshirë".

Në ajetin fisnik thuhet:

"Ne shpallim nga Kur'ani atë që është mëshirë dhe shërim për besimtarët" (el-Isra, 82)

T'ua mësojmë fëmive tanë Kur'anin

Nuk ka ndonjë lajthitje që e nxin jetën tonë shpirtërore se sa shpërfillja që mund të tregohet ndaj Kur'anit. Për këtë arsye secili prej nesh, edhe fëmijët tanë, edhe shoqëria jonë duhet të vishet me kulturën e Kur'anit, sepse Kur'ani Fisnik është udhërrëfyesi ynë hyjnor në çdo moment të jetës.

Allahu i Madhëruar thotë :

"Me të vërtetë Ne në këtë Kur'an u kemi sjellë shembuj nga më të ndryshmet njerëzve në mënyrë që ata të mendojnë dhe t'i vënë gishtin kokës" (ez-Zumer, 27)

Më shumë se 1/3 e Kur'anit përbëhet nga rrëfimet rreth profetëve dhe momenteve jetësore të spikatura të tyre. Zemra e çdo besimtari përherë duhet të unifikohet me Kur'anin dhe zgjidhjet e problemeve të tij duhet t'i gjejë në Kur'an, sepse Kur'ani është shërim për çdo plagë tonën.

I Dërguari i Allahut u jep këtë sihariq prindërve që kaliten me diturinë dhe urtësitë e Kur'anit, që vishen me moralin e tij dhe që ua mësojnë me përpikmëri Kur'anin fëmijëve të tyre:

"Edukojini fëmijët tuaj në këto tre pika: dashurinë ndaj Allahut, dashurinë ndaj familjes së Profetit dhe leximin e Kur'anit… sepse hafizët e Kur'anit ditën e kijametit, kur nuk do të ketë hije për të hyrë nën të do të jenë nën hijen e Arshit së bashku me profetët dhe njerëzit e devotshëm". (Munavi, Fejdu'l-Kadir, I, 226)

Edukimi me Kur'an është një detyrim që kërkon të kryhet me kujdes që nga moshat e vogla, sepse veshët e fëmijës duhet të familjarizohen më melodinë e Kur'anit dhe zemra e tij me botën e Kur'anit. I dërguari i Allahut ka thënë:

"Kush e mëson Kur'anin që në moshë të vogël, Kur'ani lëshon rrënjë në trupin e tij" (Ali el-Muttaki, Kenz, I, 532) Edhe vetë i dërguari i Allahut kur ndonjë nga foshnjat e fisit Abdulmuttalib niste të fliste rrjedhshëm ia mësonte ajetin 111 të sures Isra duke i vënë që ta thonin me zë nga shtatë herë. (Abdurrezak, IV, 334; Ibn Ebi Shejbe, I, 348)

Fëmijët tanë janë stolitë e kësaj bote që çojnë më tej ekzistencën tonë. Ato duke u krijuar në vegjëli sipas thelbit Islam (fitrat) u dhurohen më pas si amanet prindërve të tyre. Për këtë arsye zhvillimi dhe kalitja e botës shpirtërore të fëmijëve tanë së bashku me sigurimin e bazës materiale për ta janë dy detyrat më të rëndësishme të prindërve për të cilat janë përgjegjës përpara Zotit.

Trashëgimia më e vlefshme dhe më e vërtetë që do të mund t'i lërë një besimtar fëmijës së tij është pasuri e përjetshme. Fëmijëve tanë duhet t'u mësojmë jo rrugën e kënaqësive të përkohshme,



Sa dëshpërues është panorama tek shohim se ndërsa bëhen krahasime midis kolegjeve dhe bëhet gjithë ajo punë e madhe vetëm për të mësuar një gjuhë të huaj apo për të shtënë në dorë një përfitim nga kjo botë, nga ana tjetër i lëmë të vegjlit tanë të zhveshur nga mësimet e Fjalës Hyjnore. Në të vërtetë suksesi më i madh është nëse do të arrijmë të lëmë pas kur të vdesim një brez të dobishëm që do të lutet për ne.

por udhën e lumturisë së përjetshme që nuk vyshket, nuk vjetërohet asnjëherë. Kushti i parë i saj është të realizojmë një mpleksje të tyre me Kur'anin si nga ana mendore edhe ajo praktike. Për të vënë në pah këtë të vërtetë Profeti ynë ka thënë: "Më i miri nga ju është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve"(Buhari, Fedailu'l-Kur'an, 21)

Kështu që një besimtar është i ngarkuar gjatë jetës me detyrën që çdo moment të jetë nxënësi i Kur'anit, por njëkohësisht edhe mësuesi i atyre që ai di.

Historia është dëshmitare që individët, familjet dhe kombet arritën piedestalet e tyre atëherë kur e përvetësuan dhe e pasuan Kur'anin, i cili është amaneti hyjnor më madhështor. Për këtë arsye edhe i dërguari i Allahut në Hutben e Lamtumirës iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: "Unë po ju lë amanet dy gjëra, që për sa kohë të kapeni pas tyre nuk do të dilni nga rruga e drejtë. Ato janë Libri i Allahut dhe praktika ime (Sunnet)…" (Hakim, I, 171/318).

Madje edhe shpëtimi në emër të Zotit nga çdo periudhë e tranzicionit (fetret) pat ardhur si rezultat i përpjekjeve të mëdha në shërbim të Kur'anit, sepse begatia e vërtetë buron prej tij. Koha jonë është koha kur përpjekje dhe mundimet e tilla në këtë rrugë paraqesin një rëndësi jetike. Në këto kohë, shërbimi i vërtetë që do të siguronte ripërtëritjen dhe kthimin në identitet është shtimi i lidhjes tonë pas Kur'anit.

Në kohën tonë kur për faktin se edukata morale dhe shpirtërore nuk është duke u dhënë aq sa duhet, janë shtuar imoraliteti, narkotizmi, grabitja dhe krimet e ndryshme si dhe janë dobësuar ndjenjat e atdhedashurisë, shërbimet Kur'anore dhe sakrificat paraqesin një rëndësi të madhe për ne. Të tregohesh mospërfillës në këto përpjekje është një përgjegjsi e madhe dhe e rëndë, sepse atëherë do të lejonim që të rrezikonim vetveten, brezin që po vjen dhe të gjithë bashkësinë islame (ummet).

Sado që nuk është e njëjtë me armiqësinë ndaj Kur'anit, edhe lëshimet e qëllimshme gjatë shërbimit ndaj tij mbajnë një llogari të afërt me të. Duke pasur parasysh shembullin e trungjeve që tërhiqen zvarrë gjatë përmbytjes, krahasuar me njerëzit tanë që janë dhënë këto ditë pas modave negative, atëherë duhet që të përpiqemi që tua mësojmë Kur'anin të afërmëve tanë, rrethit tonë si edhe ta përhapim dritën dhe begatinë hyjnore që buron prej tij në mënyrë që të mund të qëndrojmë të palëkundur dhe që të mos ndotemi qoftë edhe një pikë nga vërshimi i ujit të mosbesimit. Nuk duhet ta harrojmë kurrë se ne do të kemi nevojë për Kur'anin në të dy botët. Duhet të jemi të unifikuar me mësimet e Kur'anit. Ai është ura që ne të mund të kalitemi sipas urdhëresave të tij, të qëndrojmë larg nga ato që ka ndaluar dhe të hijeshohemi me moralin që na mëson. Nëse veprojmë në të kundërt me këtë atëherë jemi të dënuar me poshtërim. Kjo do të ishte të humbasësh të ardhmen e përjetshme për shkak të kënaqësive të përkohshme.

Epoka që jetojmë është periudha, kur mospërfillja i ka robëruar familjet. Kështu që breza të tërë rrëshqasin në humnerën e humbjes. E të kujtojmë se humbja më e madhe është ajo që ndodh mbi njerëzit.

Sa dëshpërues është panorama tek shohim se ndërsa bëhen krahasime midis kolegjeve dhe bëhet gjithë ajo punë e madhe vetëm për të mësuar një gjuhë të huaj apo për të shtënë në dorë një përfitim nga kjo botë, nga ana tjetër i lëmë të vegjlit tanë të zhveshur nga mësimet e Fjalës Hyjnore duke

lënë pas dore (mbase ngandonjëherë edhe duke i nënçmuar) insitucionet edukative fetare. Në të vërtetë suksesi më i madh është nëse do të arrijmë të lëmë pas kur të vdesim një brez të dobishëm që do të lutet për ne, i cili do të jetë llogaria rrjedhëse e veprave tona të mira edhe për jetën tjetër.

Me pak fjalë, ruajtja e fesë, nderit, pasurisë dhe brezave është e domosdoshme. Këto arrihen nëse e ruajmë atdheun tonë. Për këtë arsye, jemi të detyruar që ta ndërgjegjsojmë brezin që vjen që në moshë të vogël me dashurinë ndaj Allahut, dashurinë ndaj Kur'anit dhe dashurinë për atdhe.

Përderisa dashuria ndaj Kur'anit nuk zbret në shpirtrat tanë të lënë djerrë ashtu si shirat frytdhënëse të prillit, atëherë ne nuk mund të përfitojmë nga thesari i stinës së jetës së Muhammedit. Kopshtet e shpirtrave, ashtu si toka që përmallohet për shirat, presin rreshjet që vinë nga thellësitë shpirtërore që të fal Kur'ani dhe nga veprat e mira. Me këto rreshje mëshire në emër të Krijuesit gjelbërojnë filizat e mëshirës, dhimbjes, shërbimit dhe dashurisë për krijesat. Kështu njeriu shndërrohet në bërthamën e librit të gjithësisë dhe në kopjen madhështore të krijimit. Zoti i tij pas kësaj është syri me të cilin sheh, veshi me të cilin dëgjon, dora që prek, këmba që ec dhe zemra që logjikon. Të gjithë krijesat nuk shohin ndonjë të keqe nga dora, gjuha dhe shpirti i tij.

Ja kështu edhe ne duhet ta stolisim shpirtin tonë duke e transmetuar emocionin që të jep besimi dhe edukatën shpirtërore të Kur'anit në jetën tonë dhe fëmijët tanë në mënyrë që kur të lëshojmë frymën e fundit të mos gjejmë një varr të zbrazët dhe të pandriçuar si dhe të mund të shkruhet edhe në regjistrin e veprave tona të mira nga burimi i sadakasë rrjedhëse. Nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të jenë pa të meta, duhet të përpiqemi të jemi nëna dhe baballarë pa të meta.

Nuk duhet harruar se një ndër veprat e pranuara tek Allahu është "urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja". Kjo mund të realizohet vetëm nëse e kuptojmë saktë Kur'anin dhe ua mësojmë atë edhe të tjerëve. Sepse Kur'ani është burimi i moralit, mirësisë, prehjes dhe lumturisë për të cilat ka aq shumë nevojë njerëzimi.

Zoti ynë! Na stolis me dituritë e Kur'anit! Ngjalli shpirtërat tanë duke na dhuruar nga klima e pafund e meditimit, që buron nga Kur'ani dhe nga kopshtet e dashurisë së profetit tonë Muhammed. E në këtë mënyrë të mund të vimë tek Ti me ndërmjetësinë e Kur'anit.

Të lumtur qofshin ata që arrijnë të marrin fermanin e pafajësisë nga barra e përgjegjësisë ndaj Kur'anit përpara gjizit hyjnor duke plotësuar detyrën e tyre të edukimit të brezave që do të vijnë me fjalën hyjnore… O Zot! Bëj të jemi dhe ne prej tyre!

O Zoti Ynë! Ruaje atdheun tonë dhe popullin tonë nga vala e largimit nga Kur'ani, mosbesimi dhe imoraliteti! Na mundëso të jetojmë jetën e xhenetit duke u veshur me madhështinë e Kur'anit në këtë jetë të përkohshme dhe vazhdimin e brezit të begatë të Kur'anit!

Amin!..

Përkëtheu: **Ermal Nurja**

---

1. Sipas opinionit juridik të një juristi maliki thuhet se, në rast se të përmuajshmet e grave zgjasin më shumë se zakonisht, meqë mund të bëhet fjalë për harresë, gruaja me të përmuajshme që mëson përmendësh Kur'anin e ka të lejuar ta lexojë Kur'anin "përmendësh". (Ibn Kuddame, el-Mugni, I, 193)

   Verën e kaluar gjatë vizitës në Turqi të njërit prej muhadithëve maliki të shquar të Afrikës Veriore, Hasan bin Sıddık el-Gimari e pyetëm rreth fetvasë së malikive në lidhje "me gruan me të përmuajshme nëse mund të lexojë nga Kur'ani". Ai tha se një opinion i tillë te Malikitë nuk është themelor, me të nuk punohet tek ta dhe se për gruan është e ndaluar të lexojë Kur'an në situatat e përcaktuara. Kur është pyetur edhe dijetari i fikhut nga Mekka, Kubejsi në lidhje me këtë çështje, ai ka thënë : "Është farz të kryesh urdhërin e Allahut, është haram të punosh atë që ai e ka ndaluar. Për ata që janë pa abdes është haram ta prekin Kur'anin dhe kjo është caktuar me ajete dhe hadithe".

Prim. Dr. Med. Sc. Ali F. Iljazi

Etika mjekësore në Islam

Në janar të vitit 1981 Organizata ndërkombëtare e mjekësisë islame ka mbajtur konferencën e parë të saj. Mjekët muslimanë nga të gjitha vendet e botës kanë shprehur pakënaqësinë e tyre me dy versionet e betimit të Hipokratit. Është me rendësi që ne të kuptojmë përse ata kanë marrë këtë qëndrim.

Mësimi në fondamental në islam është doktrina e Njësimit (ar. teuhid), e cila është e shprehur në shehadet, apo në vërtetimin e të qënit në fenë islame. Islami pohon që nuk ka Zot përveç Allahut xh.sh." Kjo implikon që Allahu i plotfuqishëm është i përhershëm, Krijuesi i parë, transcendental (i pakufizuar). Asgjë nuk i përgjigjet. Ai gjithmonë mbetët absolutisht i pa shembull, dhe pa rival ose partner. Për këtë mjekët muslimanë nuk kanë mundur t'a pranojnë klauzolën e betimit të Hipokratit, ku betimi u drejtohet shumë zotave duke u thirrur në ata gjatë përmbajtjes se këtyre parim. Ngjashëm më ketë, ata nuk kanë mundur ta pranojnë edhe versionin e Gjenevës (1984 dhe 1968) nga fakti se këtu emri i Zotit nuk përmendet fare. Duhet pasur parasysh se emri i Allahut (xh.sh.) përfshin pozitë qendrore në çdo rreth musliman dhe në çdo mendim musliman. Muslimani nuk merr asnjë veprimtari pa përmendjen e Allahut(xh.sh.)

Prezenca e Allahut të madhërishëm mbush vetëdijen e muslimanit në çdo kohe. Ai frikësohet nga përgjegjësia para Tij. Për ketë, duke u përgjigjur në këtë, konferenca islame ka pranuar "betimin e mjekut musliman", ku betimi bëhet në emër të Allahut dhe që mjeku duhet t'i përmbahet principeve të saj.

Dr. Abdul Hamidi ka thënë: "Kur hulumtojmë literaturën arabe e cila përshkruan etikën mjekësore, do të ballafaqohemi më një fakt jo të natyrshëm që vepra e njohur e Ibn Sinasë, "Kanun fi tibbi", i shkruar në pesë vëllime i cili përmban mbi 2000 faqe dhe një milion fjalë, është e heshtur plotësisht kur është fjala për etikën mjekësore."[1]

Por duhet pasur parasysh që mjekët klasik musliman sikurse Ibn Sina nuk kanë folur për etiken mjekësore, si të tillë vetëm për arsye se për ata etika mjekësore në asnjë mënyrë nuk ka qenë e ndarë nga mësimet e gjera etike të Kur'anit dhe sunnetit. Në paraqitjen e fundit i Dërguari i Allahut, (s.a.s.) ka shprehur rëndësinë e këtyre dy burimeve në këtë mënyrë:

"Po lë pas vehtes dy gjëra të cilat nëse u përmbaheni, asnjëherë nuk do të humbisni: Librin e Allahut dhe sunnetin tim.[2]

Prandaj këto dy burime të etikës Islame shërbejnë si udhëzim i mjaftuar për pacientin në sëmundjen e tij, dhe për mjekun në punën e tij. Nizam Arudi nga Samarkandi përshkruan cilësitë e mjekut musliman në këtë mënyrë: "Mjeku duhet të jetë i ndjeshëm dhe më natyrë të urtë, i cilësuar si mendjemprehtë në dhënien, përcaktimin saktë të diagnozave. Por asnjë mjek nuk mund të jetë i ndjeshëm nëse nuk arrin të njohe fisnikërinë e shpirtit njerëzor, as natyrën e urtë përveç; nëse nuk është i njohur më logjikën, as nuk mund të cilësohet në mendjemprehtësi, përveç; nëse nuk është i ndihmuar nga Allahu i madhërishëm.

Me fjalë të tjera, ajo që pritët nga mjeku musliman është që në vetë të kombinojë erudicionin shkencor dhe standardet e larta morale. Erudicioni mund dhe të arrihet vetëm nëse individi është i aftësuar që pandërprere të marrë pjesë në

kërkimin e diturisë dhe që të dëshirojë të hulumtojë në fushën e lëmisë përkatëse. Edhe Kurani dhe sunneti kurajon muslimanët të vazhdojnë në kërkimin diturisë. P.sh.: Kur'ani fisnik kështillon muslimanët të lutën për sa vijon:

"Zoti im, më shto dituri!"[3]

I Dërguari i All-llahut, (s.a.s.) i ka kështilluar pasuesit e tij në kërkim të diturisë: 'Kërkimi i diturisë është obligim i çdo muslimani qoftë mashkull ose femër."[4]

Karakteristikat e mjekut musliman

Të gjithë mjekët, kryesisht, kanë gati nivel të njëjtë të aftësisë, por mjeku musliman dallon nga mjeku jomusliman për nga qëndrimi i tij për vdekjen, për marrëdhënien e tij më pacientin dhe nga roli i tij si person i cili shëron, në marrëdhënie në faktin që ai përcakton marrëdhënien në përputhshmëri më Kur'anin dhe sunnetin. Duhet theksuar që njerëzit e urtë (hukama) të cilet kanë studiuar edhe filozofinë dhe mjekësinë asnjëherë nuk janë kufizuar në diagnostifikimin patologjik bukfal të sëmundjes së pacientit, por, gjithashtu në shumicën e rasteve kanë treguar interesime dhe brengë për gjendjen e tyre shpirtërore, sociale dhe psikologjike .

Do ti cekim disa karakteristika të cilat në esencë dallojmë mjekun musliman nga jomusliman.

l. Besimi në pashmangshmërinë e vdekjes.

Kur'ani fisnik mëson që All-llahu i madhërishëm Ai, i cili jep jetë dhe vdekje. Ai thotë:

"Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë..."[5]

Më tutje në Kur'anin famëmadh qëndron se vdekja është shkak i pashmangshëm mbi të cilin askush nuk ka kontroll:

"Ata nuk kanë në dorë as vdekje, as jetë e as ringjallje"[6]

Duke folur për pashmangshmërinë e vdekjes Ibn Sina deklaron: "Duhet pasur ndërmend që dituria për ruajtjen e shëndetit nuk ndihmon as në largimin nga vdekja as nga të shmangurit e fatkeqësive të jashtme. Ajo gjithashtu nuk ofron mjetë për vazhdimin e jetës në pakufi."[7]

Mjerisht, ekziston një lloj përpjekje në vendet e zhvilluara teknologjikisht që të mohohet pashmangshmëria e vdekjes. Po bëhen përpjekje në nivelin e geneve që të mënjanohet kodi genetik i plakjes më enzimën tëlomerazë. Sepse sipas tyre pranimi i vdekjes si pashmangshmëri do të thotë pranimi i disfatës se njeriut nga ana e natyrës. Për, këtë në këto vende e sidomos në SHBA, njerëzit marrin pjesë në disa projekte më qëllime që të ngadhënjejnë mbi vdekjen.

Problemi kryesor i njerëzve në këto vende është që ata janë pjesë e kulturës e cila mohon vdekjen. Për këtë, pa marrë parasysh çfarë janë të arriturat në fushën e biomjekësisë si shkencë, janë arritur kryesisht më qëllim të ngadhënjimit të vdekjes. P.sh.: Kur Benney Clark, 61 vjeçar, stomatolog i pensionuar, i cili në vitin 1982 ishte marrësi i parë i zemrës artificiale, vdiq, televizori e tregoi vdekjen e tij, por duke shtuar se zemra artificiale (zbulim i njeriut) ende rreh.

Kjo në asnjë mënyrë nuk tregon që mjeku musliman është kundër teknologjisë biomjekësore kur kjo mund ta mbajë jetën duke vënë pacientin në aparatin për frymëmarrje artificiale apo në aparate të ngjashme.

Vërtet, përpjekja që të shpëtohet jeta është qëllim fisnik, siç qëndron në Kur'an: **"...E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur të gjithë njerëzit..."** [8]

Mendoni për përpjekjet e bëra që të ruhet jeta e Berney Clarkut me zemrën artificiale, apo Davidit, fëmiës, i cili përjetoi jetën e tij të shkurtër i mbyllur në hapësirën plastike sterile në spitalin e Hjustonit, ngaqë lindi me pamundësinë e prodhimit të antikorpeve. Shembulli i fundit, beba Fae i lindur me defekt në zemër pranoi zemrën e babunit në California Lamë Linda University Medical Centre.

Shembujt e përmendur janë të arsyeshëm më qëllim të ruanin jetët e këtyre njerëzve. Për më tepër, sikur mos të ndërmerrej asgjë që tu ndihmohej. Kjo do të ishte në kundërshtim më Kur'anin, i cili ka të bëjë me rëndësinë e jetës njerëzore.

Por, Islami mëson, që vdekja është e pashmangshme dhe paraqitet vetëm në kohën e përcaktuar për të nga All-llahu i Plotfuqishëm dhe Kur'ani thotë:

"...Çdo popull ka afatin (e caktuar) e kur të vijë afati i tyre, ata nuk mund ta vonojnë as për një moment e as ta ngutin."[9]

2. Respektimi i pacientit

Respektimi i pacientëve nga mjekët përfshin përgjegjësi të ndryshme. Komunikimi me këta

pacientë duhet të jetë me fjalë mjaft të zgjedhura. Kur'ani fisnik, përshkruan mjekun e suksesshëm si dhe profesionalistët e tjerë si njerëz të cilet kanë qenë të frymëzuar që të flasin fjalë të bukura.

"Dhe ata janë që u udhëzuan më fjalët më të mira dhe u udhëzuan në rrugën e lavdishme."[10]

Më tej mjeku nuk duhet të bëjë të ditur fshehtësitë dhe ndjenjat e pacientit të tij, për shkak të faktit që Kur'ani fisnik i përshkruan besimtarët si:

"Dhe ata të cilët më kujdes i ruajnë ato që u janë besuar (sende ose fjalë), e ruajnë edhe premtimin e dhënë."[11]

Por nëse mjeku zbulon që pacientët e tij vuajnë nga sëmundjet venerike që kanë si pasojë abuzimin seksual, obligimi i tij nuk është vetëm thjeshtë shërimi i tyre, por është i obliguar ta udhëheqë nga pastërtia, vetëpërmbajtja si dhe edukata shëndetësore. Më tej, mjeku asnjëherë nuk duhet të keqtrajtojë seksualisht pacientët e tij. Dr. EI Kadi propozon që është e preferueshme që mjeku t'i shikojë pacientët e gjinisë së kundërt në praninë e personit të tretë, kurdo që kjo është e mundur, ngase kjo mund të parandalojë kontaktin i cili do të udhëhiqte nga keqpërdorimi seksual i pacientit.

Përveç kësaj, mjeku nuk duhet që pacientëve t'u paguajë për së tepërmi shërbimet e ofruara. Ai duhet të jetë i arsyeshëm ndaj atyre që nuk janë në pozitë të paguajnë shërbimet e tij. Verseti vijues i Kur'anit fisnik mjafton si udhërrëfyes në lidhje me këtë çështje:

"Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër.

Në po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim."[12]

3. Mbështetja tek All-llahu si shërues suprem

Mjeku, padyshim, mund të luajë rol të rëndësishëm në shërimin e pacientëve të tij duke ju përshkruar ilaçin ose operimin, por vërtetë, rolin e tij real në shërim mund ta vërejë vetëm nëse beson që Allahu i Madhërishëm është shërues suprem, do t'i ndihmojë në shërimin e tij dhe do t'ia lehtësojë punën mjekut.

Por, duhet pasur ndërmend që besimi në All-llahun e Madhërishëm, si shërues suprem nuk e liron nga fajësia asnjë mjek nëse eventualisht ka bërë gabim në diagnozën apo trajtimin i cili ka pasuar me vdekjen e pacientit. Ibn Ruzhdi thekson që juristët islam njëzëri pohojnë përgjegjësinë e mjekut për çdo gabim eventual që mund ta bëjë.

Andaj, etika mjekësore, edhe pse sot për të flitet shumë, është e vjetër sa edhe vetë mjekësia. Vërtet që betimi i Hipokratit ka shërbyer si udhërrëfyes themelor për mjekët, por duhet theksuar fakti që mjekët muslimanë**, nxjerrin udhëzimin e mjaftueshëm nga mësimet e Kur'anit dhe sunnetit, të cilët, në esencë përcaktojnë qëndrimet e tyre edhe ndaj profesionit edhe ndaj pacientëve.**

Duhet përmendur që konferenca e parë e mjekësisë islame është mbajtur në Kuvajt në vitin 1981, dhe ka publikuar "Rregulloren islame të etikës mjekësore", të bazuar në Kur'an dhe Hadith, i cili sot është i botuar në formë të broshurës në gjuhën arabe dhe angleze,[13] çfarë dëshmon qartë faktin se këto dy burime esenciale të etikes islamë shërbejnë si udhërrëfyes, mjekëve muslimanë në lëminë e etikës mjekësore.

Në vijim po ju sjellim tre llojet e betimeve mjekësore:

Betimi i Hipokratit

Betohem në mjekun Apolon dhe Asclepius dhe Hygieian dhe Panaceianin dhe në të gjithë perënditë dhe perëndeshat, duke i marrë si dëshmitar të mi, që do t'ju përmbahem me mundësitë e mia dhe gjykimin tim këtij betimi dhe këtë premtim:

Personin i cili më mësoi këtë mjeshtëri do të jetë si prindërit e mi dhe do të jetojë jetën time në partneritet me të, dhe nëse i nevojiten të hollat, do t'ia jap pjesën time, dhe pasardhësit e tij do t'i mbajë të njëjtë më vëllezërit e mi sipas gjenealogjisë mashkullore dhe do t'i mësoj këtë mjeshtëri - nëse ata dëshirojnë ta mësojnë - pa kurrfarë pagese dhe marrëveshje; dhe që do të jap këshilla, udhëzime dhe mësime të tjera fëmijëve të mi dhe fëmijëve të atij që më ka mësuar dhe nxënësve që kanë nënshkruar marrëveshje dhe kanë marrë betimin në përputhshmëri më ligjin mjekësor dhe askujt tjetër (përveç këtyre).

Do t'i aplikoj masat dietetike në shërbim të të sëmurit në pajtim më mundësitë dhe gjykimin tim; do t'i ruaj nga demi dhe padrejtësia.

Nuk do t'i jap askujt ilaç vdekjeprurës nëse e kërkon dhe as që do të plotësoj porosinë nga ky

veprim. Ngjashëm më këtë nuk do t'i jap gruas mjet për abortim. Në pastërti dhe lartësi do ta ruaj jetën time dhe profesionin tim.

Nuk do të shërbehem me thikë, bile edhe tek të sëmurit nga gurët, por do të tërhiqem më respekt ndaj këtyre njerëzve sikur të kishin marrë pjesë në këtë vepër.

Secilën shtëpi do ta vizitoj, do të vijë për shkak të dobisë së pacientit, duke mbetur i lirë nga ç'do padrejtësi e qëllimshme, nga të gjitha dyshimet e sidomos nga marrëdhëniet seksuale si me personat meshkuj apo femra qofshin ata, të lirë apo robër.

Atë që do ta dëgjoj gjatë shërimit ose bile edhe jashtë rrjedhës së shërimit, e që ka të bëjë me jetën e njeriut, e që më asnjë çmim nuk duhet hapur, do ta ruaj për vete duke i mbajtur këto gjëra si dituri për të cilat është turp të flitet.

Nëse e plotësoj këtë betim dhe nuk e gjej, le të më dhurohet të kënaqem më jetën dhe thirrjen, duke qenë i nderuar më lavdi në mes tërë njerëzve dhe për të gjitha kohët e ardhshme; por nëse e thyej dhe betohem jondershmërisht, të gjitha të kundërtat nga këto le të më gjykojnë.

Deklarata e Asociacionit të Mjekësisë Botërore nga Gjeneva

Betimi mjekësor

Nga momenti që pranohem si anëtar i stafit mjekësor:

• Solemnisht obligohem që jetën time do t'ia përkushtoj në shërbim të njerëzimit;

• që mësuesve të mi do t'u ofroj nderim dhe falënderimin që u takon;

• që do ta ushtroj profesionin tim me ndërgjegje dhe krenari: shëndeti i pacientit tim do të jetë prioriteti im i parë:

• do ta mbajë me të gjitha mjetet që janë në fuqinë time, nderin dhe traditën e profesionit mjekësor: kolegët e mi do të jenë vëllezërit e mi; që nuk do të lejoj qëndrimeve religjioze, nacionale, racore, partisë politike ose statusit social që të përzihen në mes obligimit tim dhe pacientit tim;

• që do ta mbaj me të gjitha mjetet që janë në fuqinë time, nderin dhe traditën e profesionit mjekësor koleget e mi do të jenë vëllezërit e mi; që nuk do të lejoj qëndrimet religjioze, nacionale, racore, partisë politike apo statusit social që të përzihen në mes obligimit tim dhe pacientit tim;

• që do të mbaj respektin më të madh ndaj jetës njerëzore nga momenti i krijimit të tij, madje edhe nën kërcënim dhe nuk do të përdor diturinë time mjekësore kundër ligjeve humane (njerëzore);

• e bëjë këtë premtim me krenari; i lirë dhe më nder.

Betimi i mjekut musliman

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Gjithëmëshirshmit, Betohem në Allahun e Lartëmadhrishëm:

• që do të kem vëmendje ndaj Allahut në kryerjen e profesionit tim;

• që do të mbroj jetën e njeriut në të gjitha moshat e tij dhe në të gjitha rrethanat, duke dhënë çdo gjë nga vetja që ta shpëtoj nga vdekja, sëmundja, dhembja dhe fatkeqësitë;

•që do ta ruaj krenarinë njerëzore, të fsheh gjërat private të tij dhe t'i

• mbylli fshehtësitë e tyre;

• që gjithmonë të jem instrument i mëshirës së Allahut, duke përhapur brengën time mjekësore afër dhe larg, ndaj të pastërtit dhe mëkatarit, mikut dhe armikut;

• që do të garoj në kërkimin e diturisë duke e shfrytëzuar në qëllime të dobishme, e jo në qëllime të dëmit njerëzor;

• që do ta nderoj mësuesin tim, do ta mësoj nxënësin tim dhe do të jem vëlla me nataret e praktikës mjekësore i bashkuar në adhurim dhe mirësi;

• që do ta jetësoj fenë time privatisht dhe publikisht, duke u larguar nga të gjithë at ë që më njollosin në sytë e Allahut, të Dërguarit të Tij dhe miqve të mi besimtarë;

• dhe Allahu le të jetë dëshmitar i këtij betimi.

---

1. Abdul Hamid, "Medicinska etika u islamu",vell. 5, nr. 2, fq. 135
2. Sunen Ebu Davud,"Kitab el-Menasik" pjesa e 2, faqe 185
3. Ta Ha, 114
4. Sunen Ibn-maxhxheh, EI Mukaddima, pjesa e 1, hadithi nr.224, faqe 81
5. EI Mulk, 2
6. EI Furkan, 3
7. Ibn Sina, vellimi1, faqe 149
8. EI Maide, 32
9. Junus, 49
10. EI Haxhxh, 24
11. EI Mu'minunë, 8
12. El-Insan, 8-9
13. Buletini i mjekësisë islame, vell. I, botim i dytë, janar, 1981; Kuvajt, Ministria e Shëndetësisë, faqe, 731

Të punojmë në rini

Zoti të krijoi ty o njeri
të la të veprosh i lirë
çfarë të duash ti.
E pse bëhesh mos falënderues
ndaj Allahut
pse bëhesh mos falënderues
ndaj tij.
Ai ta dha shëndetin para sëmundjes
jetën para vdekjes
rinin para pleqërisë
e këtë duhet ta shfrytëzosh
dhe gjithmonë Allahun ta adhurosh.
Ai të udhëzoi ty
por ti devijove
sa më shpejt pendohu
që mos dënohesh.
Po nuk u pendove
atëherë do të pësosh
n'ditën e gjykimit
askush nuk do t'ndihmoj
do të shpëtoj vetëm puna jote e mirë.
Se atë ditë nuk bënë punë
babai e nëna
por do të ndërmjetësoj
vetëm veprat tona.
Pra këtë duhet ta dish
qysh tash kur je i ri
që të pendohesh sa me parë
o njeri!
Mëso mirë çka të ka urdhëruar Allahu
dëgjo mirë çka ka thënë profeti
mëso ato që ta fitosh xhennetin.
Atje do të gjesh prehje
e veç do të rrish
e n'dhuntint e Allahut
do të gjesh befasi.
Allahu na ka treguar
edhe profeti na ka këshilluar
xhenneti është vend
që as mendja s'ta ka logjikuar
syri se ka pa
e as veshi për të kurrë
nuk ka ndëgju
e këtë vetëm Allahu e di.
Pra ne të punojmë
jetën tonë ta ndriçojmë
me punë t'mira n'ahiret të shkojmë
që xhennetita fitojmë.

Gjulije vehapi
Gjakovë

Këshilla të dobishme gjatë mësimit përmendsh të Kur'anit Fisnik

Nazif Jëllmaz

Gjatë mësimit përmendësh të Kur'anit, para së gjithash, duhet të kemi qëllim të pastër, të sinqertë dhe të çiltër.

❖ Së pari, duhet të shqiptohen drejt shkronjat. Duhet të lexojmë rrjedhshëm, sepse mësimi përmendësh me gabime krijon vështirësi gjatë përmirësimit të tij.

❖ Për ta lexuar në rregull pjesën që do të mësojmë përmendësh, duhet të marrim mësim nga një mësues që lexon rrjedhshëm.

❖ Nëse nuk kemi mundësi të gjejmë mësues ose s'mund të punojmë shumë, atëherë duhet të dëgjojmë vazhdimisht kasetat dhe CD-të e Kur'anit nga një mësues i autorizuar. Duhet të përpiqemi t'i ndreqim gabimet e bëra gjatë shqiptimit të shkronjave.

❖ Mësimi që bëhet me mësues, qoftë në klasë apo në ndonjë vend të ngjashëm me të, është mënyra më e mirë për të mësuar leximin e Kur'anit. Së pari duhet t'i lexojmë fjalët një nga një, pastaj më ndihmën e një mësuesi, duhet të përpiqemi të këndojmë së bashku me korin.

❖ Të mos harrojmë! Mësimi përmendësh që kryhet ngadalë, por pa gabime është më i frytshëm se mësimi shpejt e me gabime, sepse, kur e mësojmë gabim një gjë është vështirë ta përmirësojmë.

❖ Para se të fillojmë mësimin përmendësh të faqes së Kur'anit duhet të kemi parasysh rregullat e texhvidit (rregullat e leximit të Kuranit), nxjerrjen mirë dhe shqiptimin drejt të shkronjave si dhe duhet ta lexojmë së paku dhjetë herë atë. Nëse kemi mundësi, duhet ta dëgjojmë tre apo katër herë, në mënyrë që të krijojmë lehtësi për ta mësuar mirë.

❖ Pjesën që do të mësohet përmendësh fillimisht duhet ta lexojmë të përkthyer ose nëse kemi njohuri rreth gjuhës arabe, të mundohemi ta kuptojmë ashtu siç është teksti origjinal. Në këtë mënyrë krijohet lehtësi për të kuptuar pjesët e mësuara përmendsh.

❖ Të përpiqemi të zbukurojmë zërin gjatë këndimit të citateve Kur'anore. Të mos i lexojmë ngadalë por normal, sepse leximi i ngadaltë krijon vështirësi për të mësuar përmendësh citatet e Kur'anit.

❖ Për të mësuar përmendësh dhe më lehtë një sure, duhet filluar nga ajeti i parë. Pasi të mësojmë ajetin e parë, e përsërisim së paku tre herë.

❖ Pastaj mësojmë ajetin e dytë dhe veprojmë si në rastin e parë. Në fund të ajetit të dytë i përsërisim nga tre herë të dy ajetet në fjalë.

❖ Pastaj mësojmë ajetin vijues dhe e përsërisim tre herë atë. Këtë radhë mundohemi t'i përsërisim nga tre herë ajetet që kemi mësuar. Kjo metodë duhet praktikuar deri sa të mësojmë gjithë faqen apo suren. Duke vepruar në këtë mënyrë mësimi përmendësh i pjesës apo sures mbetet i ngulitur në mendjet tona.

❖ Pasi të mësohet përmendësh e gjithë faqja apo surja, duhet përsëritur së paku dhjetë herë. Tani besoj se kemi bërë një mësim të frytshëm dhe nëse do Zoti, nuk harrohet lehtë.

❖ Të mos i lëmë pas dore edhe dhjetë herët e fundit të leximit: të mos e humbasim rastin në prag të përfundimit. Të kuptojmë fjalën e urtë popullore që thotë: "Hekuri rrihet sa është i nxehtë."

❖ Pjesët e mësuara përmendësh, kur i lexojmë gjatë faljeve të namazeve, rifreskohen dhe mbesin më lehtë në mendjet tona.

❖ Gjatë një kohë të shkurtër pas mësimit përmendësh, veprimi në këtë mënyrë është më i dobishëm. Më kalimin e kohës mund të krijojmë edhe metoda të tjera, sipas mundësive që kemi.

❖ Nëse në mbrëmje e mësojmë përmendsh suren, me t'u zgjuar nga gjumi në mëngjes, do të vërejmë që është fiksuar në mendjet tona gjatë gjumit.

❖ Tani është gati mësimi që kemi mësuar. Mund t'ia lexojmë mësuesit që tani. Por para se t'ia lexojmë atij, është mirë që pjesën e mësuar, t'ia lexojmë edhe ndonjërit që ka aftësi kontrolluese, sepse na ndihmon t'i ndreqim gabimet që kemi.

❖ Gjithashtu, duhet të jetë i njëjtë edhe lloji i shkrimit të sures, sepse syri ynë është i mësuar më këtë lloj shkrimi. Shkrimi i njëjtë që përdoret gjatë mësimit përmendësh krijon lehtësi kujtese.

❖ Mjedisi për mësim duhet të jetë sa më i qetë dhe i thjeshtë. Nëse është e mundur që mësimet e bëra përmendësh të zhvillohen në të njëjtin vend, sepse pamja e gjërave të ndryshme largon vëmendjen. Mësimi në mjedis të thjeshtë bën që të kemi vëmendje të përqendruar, si dhe ndihmon për të mësuar më shpejt.

❖ Duke mësuar Kur'an duhet të lexojmë më zë të ultë. Leximi më zë të ultë bën që të mësojmë më shpejt një sure. Sepse dëgjimi i zërit gjatë leximit ndihmon që të mbesë në mendjet tona më lehtë.

❖ Para se të fillojmë mësimin përmendsh, është mirë të marrim abdes. Sapo të marrim Kur'anin në dorë është e preferuar që të këndohet kjo lutje: " O Zoti ynë! Unë kam ardhur për të mësuar ajetet e librit Tënd. Ma lehtëso mësimin e librit Tënd."

❖ Në qoftë se nuk mund të përqendrohemi gjatë mësimit është mirë të falim dy rakate namaz dhe të kërkojmë falje. Pasi të veprojmë në këtë mënyrë do të vërejmë se zemrat qetësohen, mendjet çlodhen dhe aftësia e të menduarit është e gatshme.

❖ Të mos harrojmë se kur të fillojmë leximin e Kur'anit, djalli me gjithë fuqinë e tij dëshiron të ngjallë dyshim në mendjet tona dhe të na largojë nga Kur'ani. Për këtë arsye duhet të këndojmë "Eudhu-Besmelenë".

Alija BARLOVIC

Naim Drijaj

Detyrimet që kemi ndaj Kur'anit

Ai që dëshiron të jetë i dashur te Allahu dhe i Dërguari i Tij, le të shikojë nëse e do Kur'anin, atëherë e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kështu, edhe ai duhet nga Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Allahu i Madhëruar urdhëron të Dërguarin të Tij, Muhamedin (s.a.s.) duke thënë: "Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur, më shpresën se do ta studiojnë (Kur'anin).[1] Për të realizuar këtë qëllim, Zoti (xh.sh.) e këshillon të Dërguarin e Tij: "Shpalle atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën).[2] Kur'ani është fjala e Zotit që i është shpallur Muhamedit (s.a.s.) nëpërmjet engjëllit të shenjtë, Xhebrailit (s.a.s.) Autenticiteti i Kur'anit nuk lë dyshim për sa i përket origjinalitetit dhe tërësisë së tekstit të tij. Kur'ani është mrekullia e amshueshme e Pejgamberit (s.a.s.) dhe është e pamundur të sillet një i ngjashëm me të. Vet Allahu i Madhëruar urdhëron në Kur'an: "Sikur të bashkohen njerëzit dhe xhindët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që ta ndihmonin njëri-tjetrin"[3]

Pa dyshim, ne kemi shumë detyrime që duhet t'i kryejmë ndaj Kur'anit. Ndër këto detyrime mund t'i rendisim këto:

1. Ta nderojmë dhe ta respektojmë
2. Ta ruajmë
3. Ta kuptojmë
4. Ta mësojmë përmendsh
5. Ta jetojmë dhe ta vëmë në jetë.

Profeti i nderuar ka thënë: "Ai që dëshiron të jetë i dashur te Allahu dhe i Dërguari i Tij, le të shikojë nëse e do Kur'anin, atëherë e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Kështu, edhe ai duhet nga Allahu dhe i Dërguari i Tij."[4] Në rast të kundërt, ai që nuk do Kur'anin nuk do as Allahun as të Dërguarin e Tij. Kur'ani Fisnik është mëshirë, udhëzim dhe burim drite që Allahu na i ka dhënë ne muslimanëve. Ne, si muslimanë, e kemi të domosdoshme ta mësojmë leximin e Kur'anit të Madhëruar. Allahu (xh.sh.) në Kur'anin Famëlartë urdhëron e thotë: "Ne Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësim?"[5] Dhe Profeti (s.a.s.) në një hadith të tij thotë: "Më i miri prej jush është kush mëson Kur'an dhe kush ia mëson atë dikujt."[6]

Mësimi Kur'anit të Shenjtë është ndër

veprat më të nderuara, që e afrojnë muslimanin tek Zoti (xh.sh.). Ai ka vlerë më të madhe se veprat e tjera tek Ai. Leximi dhe mësimi, tregon vlerën që i kushton Kur'ani dijes dhe diturisë. Ajeti i parë që i është zbritur Profetit (s.a.s.) është: "Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)." "Atyre, që u dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejtë ashtu si është, ata e besojnë atë (Kur'anin). Ata që e mohojnë atë, janë ata që dështuan (në dynja e në ahiret)." "Ata që e lexojnë librin e Allahut, falin namazin dhe nga begatitë që ne u kemi dhënë, japin fshehtazi dhe haptazi, ata

Shembulli i besimtarit, që lexon Kur'anin, është sikurse shembulli i qitrës, aroma e së cilës është e mirë dhe shijen e ka të mirë. Shembulli i besimtarit, që nuk e lexon Kur'anin është sikurse hurma që nuk ka erë, por shijen e ka të ëmbël, ndërsa shembulli i hipokritit, i cili e lexon Kur'anin, është sikur shembulli i krizantemës (lule vjeshtës), aroma e së cilës është e mirë, ndërsa shija e ithët.

shpresojnë një fitim që kurrë nuk u humbet."[7]

Profeti (s.a.s.) në shumë hadithe të tij tregon rëndësinë e leximit të Kur'anit dhe mësimit të tij. Një ndër këto hadithe është ky: "Shembulli i besimtarit, që lexon Kur'anin, është sikurse shembulli i qitrës, aroma e së cilës është e mirë dhe shijen e ka të mirë. Shembulli i besimtarit, që nuk e lexon Kur'anin është sikurse hurma që nuk ka erë, por shijen e ka të ëmbël, ndërsa shembulli i hipokritit, i cili e lexon Kur'anin, është sikur shembulli i krizantemës (lule vjeshtës), aroma e së cilës është e mirë, ndërsa shija e ithët. Ndërsa shembulli i hipokritit, i cili nuk e lexon Kur'anin, është sikur shembulli i kungullit të egër, që nuk ka aromë, kurse shijen e ka të ithët.[8] Për çdo shkronjë të lexuar nga Kur'ani fitohen dhjetë sevape. "Elif Lam Mim"[9] nuk është një shkronjë, por "Elif" është një shkronjë "Lam" është një shkronjë dhe "Mim" është një shkronjë. Pra, nga këto ajete dhe hadithe të cilat i citova më sipër, kuptojmë rëndësinë dhe vlerën e Kur'anit Fisnik. I lutem Allahut të Madhëruar të na bëjë nga ata që lexojnë dhe veprojnë sipas këshillave që na këshillon Ai.

Zoti ynë! Na i zbukuro zëmrat me diturinë, urtësinë, dritën dhe gëzimin e Kur'anit dhe na bëj të dashur, të pasionuar të profetëve të cilët e jetuan Islamin si Kur'an i gjallë! Amin...

---

1. Suretu en-Nahl, ajeti 44.
2. Suretu el-Maide, ajeti 67.
3. Suretu el-Isra, ajeti, 88.
4. Mexhma'u'z-Zevaid v. 7, f. 165.
5. Suretu el-Kamer, ajeti, 17.
6. Buhari, Fadlu'l-Kuran 21
7. Suretu el-Alak, ajeti 1; Suretu el-Bekare, ajeti 121; Suretu el-Fatir, ajeti 29.
8. Buhari, Fedailu'l-Kuran, 17; Muslim, Musafirin, 243.
9. Suretu e-Bekare, ajeti 1.

Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Nata e Beraetit

Allahu Teala në këtë natë hap dyert e faljes; besimtarët në këtë natë falen, dhe nëse pendohen nga mëkatet, pastrohen. Në këtë natë të gjitha punët që do të bëhen brenda një viti, pasi të vendosen, u jepen melekëve nga Allahu për t'u kryer. Këtë natë është mirë ta kalosh me adhurim dhe lutje, kurse ditën me agjërim.

Nata e Beraetit është nata e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban. Origjinali i fjalës është "Berâet". Berat në gjuhën e përditshme do të thotë të shpëtoshë nga një vështirësi dhe të jesh i lirë.

Kjo natë përkujtohet edhe me emra të ndryshëm.

Kjo natë, duke qenë një natë me bereqet dhe begati, është quajtur "Mubarek". Në këtë natë falen mëkatet dhe pastrohen robërit. Është quajtur "Berâet", për shkak se, robërit fitojnë mirësinë. Është quajtur "Rahmet", për shkakun e marrjes së robërve që e vlerësojnë këtë natë, duke u zgjedhur ndër robërit e devotshëm, është quajtur "Berâe ose Sakk".

Allahu Teala në këtë natë hap dyert e faljes; besimtarët në këtë natë falen, dhe nëse pendohen nga mëkatet, pastrohen. Në këtë natë të gjitha punët që do të bëhen brenda një viti, pasi të vendosen, u jepen melekëve nga Allahu për t'u kryer. Këtë natë është mirë ta kalosh me adhurim dhe lutje, kurse ditën me agjërim.

Nata e Beraetit ka pesë veçori:

1) Çdo punë e rëndësishme ndahet në këtë natë.

2) Mirësia e adhurimit në këtë natë është e madhe.

3) Shpërndahet mëshira hyjnore.

4) Është nata e faljes.

5) Atë natë, të dërguarit të Allahut salallahu alejhi ue selem i është dhënë e drejta e plotë e ndërmjetësimit, sepse Muhammedi (salallahu alejhi ue selem), natën e trembëdhjetë të muajit Shaban ka kërkuar ndërmjetësim për popullin, dhe i është dhënë një e treta e ndërmjetësimit. Përsëri ka kërkuar natën e katërmbëdhjetë dhe i është dhënë një e treta. Përsëri natën e pesëmbëdhjetë ka kërkuar dhe, në këtë natë i është dhënë komplet ndërmjetësimi. Ata që janë të privuar nga ky ndërmjetësim janë ata të cilët ikin nga Allahu siç ikën deveja duke u trembur. (shih: tefsiret e er-Râzî dhe Ebussuud Efendi, tefsirin e ajeteve tre dhe katër të sures ed-Duhan, Hasan Basri Çantaj, Kur'an-ı Hakim ve Meal-i Kerim, Stamboll 1959, III, 904, 905).

I dërguari i Allahut për natën e Beraetit ka thënë:

" Kur të bëhet nata e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban, atë natë ngrihuni për adhurim, dhe agjëroni në ditën e kësaj nate, sepse atë natë kur të perëndojë dielli, Allahu Teala (në një mënyrë që ne nuk e dimë), duke zbritur në qiellin më të afërt, derisa të bëhet mëngjes thotë: " A nuk ka ndonjë që kërkon falje prej meje dhe unë ta fal? A nuk ka ndonjë që kërkon furnizim (risk) prej meje dhe une t'i jap? A nuk ka ndonjë

Nata e Beraetit ka pesë veçori: çdo punë e rëndësishme ndahet në këtë natë, mirësia e adhurimit në këtë natë është e madhe, shpërndahet mëshira hyjnore, është nata e faljes, atë natë, të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue sellem) i është dhënë e drejta e plotë e ndërmjetësimit.

që nuk ka ndonjë fatkeqësi dhe unë ta shpëtoj? A nuk ka ndonjë që është kështu apo ashtu?" (Ibn Maxhe, H. no.1388)

Edhe në një hadith tjetër thuhet kështu:

"Kjo natë është nata e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban. Në këtë natë Allahu Teala i shpëton njerëzit nga xhehennemi sa numri i qimeve të deleve të fisit Beni Kelb, por nuk shikon fytyrat e atyre të cilëve i bëjnë shirk, të atyre që ushqejnë urrejtje dhe armiqësi ndaj muslimanëve, të atyre që shkëpusin marrëdhëniet me të afërmit, të atyre që mburren dhe që janë mendjemëdhenj, të atyre që nuk u binden nënës dhe babait, dhe të atyre që vazhdojnë pirjen e alkoolit." (Buhari, et-Tergib ve't-Terhib, II, 118)

Regjistohen ngjarjet që do të ndodhin:

Ngjarjet që do të ndodhin gjatë një viti deri në natën e Beraetit të vitit të ardhshëm, shkruhen një nga një nga melekët në defter. Tërmetet, ndodhitë, luftërat që do të ndodhin gjatë një viti... Defteri i këtyre i jepet Xhebrailit (alejhisselam). Defterët (regjistrat) në lidhje me rriskun i jepen Mikailit alejhisselam dhe defteri i atyre që do të vdesin i jepet Azrailit alejhisselam.

Si duhet ta ngjallim natën e Beraetit

Pas namazit të akshamit në natën e Beraetit të Shabanit fisnik lexohet tri herë sureja Jasin, dhe në fund të çdo rradhe bëhet lutja e Beraetit. Pas Jasinit të parë fisnik, kur të thuhet kjo lutje, duhet të bëhet me nijetin që të bëhesh prej robërve të gëzuar të Allahut. Kur të lexohet për së dyti, të lexohet me nijetin

A nuk ka ndonjë që kërkon falje prej meje dhe unë ta fal? A nuk ka ndonjë që kërkon risk prej meje dhe une t'i jap? A nuk ka ndonjë që nuk ka ndonjë fatkeqësi dhe unë ta shpëtoj? A nuk ka ndonjë që është kështu apo ashtu?

për një jetëgjatësi të hijëshme. Kur të lexohet për herë të tretë, të lexohet për t'u siguruar nga aksidentet dhe fatkeqësitë dhe për rrisk të mirë.

Veçanërisht në natën e Beraetit në dy pas jacisë, falen njëqind rekate namaz në dhënie selam e sipër. Në çdo rekat pas Fatihasë lëxohet dhjetë herë Ihlasë Sherif. Ai që nuk ka mundësi ta lexojë dhjetë herë Ihlasin Sherif, e lexon pesë herë. Pasi të plotësohet ky namaz, duke u penduar dhe kërkuar falje me thënien e selavateve fisnike sa të ketë mundësi dhe me qetësi shpirtërore, kërkon prej Allahut Teala nevojat e tij të kësaj bote, dhe të botës tjetër. Zoti ynë i madhëruar na e bëftë rrisk të gjithëve përfitimin nga kjo natë. Amin!

Kuptimi i lutjes së natës së Beraetit

O Zoti im, që je i butë dhe falës ndaj robërve të tu, dhe që nuk ke nevojë për shpagim! O Zoti im që posedon madhështi dhe mirësi! Ti je ai që u fal robërve të tu të pafuqishëm mirësi të pafundme! Nuk ka Zot tjetër perveç Teje! Ti i ndihmon ata të cilët, duke u strehuar te

Ti, të përgjërohen! Përsëri Ti je i vetmi strehim ku të frikësuarit strehohen duke u siguruar!

O Zot, nëse në librin e pranisë Tënde, në Levhi Mahfudh, më ke shkruajtur si i keq, si i lënë, si i larguar nga mëshira hyjnore, si një i varfër, fshije me mirësinë Tënde shkrimin tim të të qënit mëkatar, i lënë, i larguar nga mëshira hyjnore, një njeri i varfër i gjykuar për të kaluar një jetë me vështirësi. Më shkruaj mua në librin e pranisë Tënde nga të mirët, nga robërit e tu të devotshëm, plot risk, të pasur, garues në punë të mira, dhe nga robërit e Tu të suksesshëm.

O Zoti im! Në librin e shenjtë që e ke dërguar mbi gjuhën e të dërguarit Tënd fisnik, ke thënë kështu: "Allahu e fshin atë që do, dhe përforcon çfarë Ai do. Tek ai është nëna e librit." (Sureja Ra'd, 39)

O Zoti im! "Këtë natë vendoset çdo çështje e vullnetit dhe urdhëresave (për vitin tjetër)" me shfaqjen më të madhe të natës së katërmbëdhjetë të muajit të nderuar Shaban. Atë që e dimë dhe atë që nuk e dimë, të lusim t'i largosh prej nesh belatë dhe fatkeqësitë që Ti i di. Sigurisht që Ti ke forcë të pafundme, dhe je i aftë! Ti je Zoti ynë, që ke shumë butësi dhe mirësi!

O Zoti im! Dërgoju salat dhe selam të nderuarit tonë Muhammedit alejhisselam, familjes së tij, shokëve të tij, fëmijëve të tij dhe grave të pastërta të tij. O Zot na i prano lutjet tona!

O Zoti im që je i butë dhe falës ndaj robërve të tu, dhe që nuk ke nevojë për shpagim! O Zoti im që posedon madhështi dhe mirësi! Ti je Ai që u fal robërve të tu të pafuqishëm mirësi të pafundme! Nuk ka Zot tjetër perveç Teje! Ti i ndihmon ata të cilët, duke u strehuar te Ti, të përgjërohen! Përsëri Ti je i vetmi strehim ku të frikësuarit strehohen duke u siguruar!

Përktheu: **Fatmir Sulaj**



ZHURMË

Ndihen gjithkund
Tingujt e burisë
Së shkatrrimit,
Lamshit pervers landor

S'jam ktu
Jam n'prehnin e përmasave tjera,
Ku pikturoj
Melodi hyjnore
Me gishtin e fjalës

Larg
Vajet
E nji bote
T'harrueme...

Nji lot ma tepër
N'oqeanin e pakuptimit.
Kurrgja s'ndryshon me stinët,
Veç lëkurës së vuetjeve...

Alban Kali

ISRA DHE MIRAXHI

Lutfi Nexhipi

Isra dhe Miraxhi janë dy mrekullitë më të mëdha të cilët i kanë ndodhur Muhamedit (s.a.s.) gjatë jetës së tij. Muhamedi (s.a.s.) gjatë jetës së vetë ka pasur periudha jashtëzakonisht te vështira, duke predikuar Islamin. Gjatë historisë së të gjithë Pejgamberëve të Allahut u janë ekspozuar vuajtjeve të ndryshme. Kur është fjala për pejgamberin e fundit të Allahut (xh.sh.) edhe ai kaloi vuajtje të mëdha, siç janë: tre vite ftoi në Islam fshehtas, pastaj e publikoi (së pari familjen e afërt, e pastaj të tjerët), dëbimi i muslimanëve në Abisini, tre vite bllokadë totale, pas saj vjen "Amu-l-huzn" ("Viti i pikëllimit") ku dy personat më të dashur që kishte mbështetjen më të madhe ndërruan jetë: gruaja e tij e ndershme dhe besnike Hatixhja r.anha dhe xhaxhai Ebu Talibi. Në këtë gjendje dëshpërimi, Pejgamberi (s.a.s.) u nis për në Taif (qytet jo larg Mekkës) duke shpresuar se atje do të gjejë përkrahje dhe vend të përshtatshëm për të predikuar Islamin. Mirëpo, meqë shpirtrat e paganëve taifas akoma nuk ishin të gatshëm ta pranojnë Porosinë hyjnore, rinia, të nxitur nga prindërit e sulmuan ashpër me gurë dhe për herë të parë u derdh gjaku i Muhammedit (s.a.s.) Në këtë krizë të thellë dhe në këtë gjendje të rëndë dëshpërimi, Pejgamberi (s.a.s.) gjeti strehim të një kopsht, i ngriti duart lartë kah qielli duke iu lutur All-llahut thellë nga shpirti për ndihmë e përkrahje:

"O Zoti im, Ty të ankohem për dobësinë e paaftësinë time dhe për njerëzit, që nuk më kuptojnë. Ma shpejto ngadhënjimin e së vërtetës ose ma merr shpirtin dhe më thirr te Vetja jote në botën tjetër më të mirë."

Në ato çaste të rënda të jetës së tij, me të kthyer në Mekke, All-llahu xh.sh ia pranoi lutjen Pejgamberit (s.a.s.) duke e përgëzuar dhe duke ia plotësuar atë me një ngjarje të jashtëzakonshme me Isranë dhe Miraxhin.

Isra dhe Miraxhi vijnë si lajm i gëzueshëm për ummetin, por njëherit me vete bartin edhe obligime të reja.

Allahu xh.sh në ajetin e parë të sures el-Isra', duke treguar për Isranë thotë:

"Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona.Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), pamësi (i punëve të Muhammedit)."(El-Isra' 1)

Israja shënon udhëtimin prej Mesxhidu-l-Haramit

Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa, rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona.Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhammedit), pamësi (i punëve të Muhammedit).

nga Meka, deri në Mesxhidu-l-Aksa në Kuds (e cila paraqet një largësi prej dyzetë ditë e net ecje), përderisa Miraxhi paraqet udhëtimin prej Mesxhidu-l-Aksasë deri në qiellin më të lartë, respektivisht "Sidretu-l-Munteha".

Mesxhidu-l-Aksa është kibla e parë muslimane dhe njëherit është vend ku Pejgamberi s.a. është falur si imam i pejgamberëve të tjerë të Allahut (xh.sh.) përderisa Buraku ishte i lidhur për hallkë në Mesxhidu-l-Aksa. Kur Pejgamberi s.a.v.s. doli prej Mesxhidu-l-Aksasë, Xhebraili ia afroi një gotë me verë dhe tjetrën me qumësht. E zgjodhi qumështin, pastaj Xhebraili i tha: "E zgjodhe "fitrën" (ajo që është e natyrshme), po ta kishe zgjedhur verën, ummeti yt do të shkonte në humbje." Miraxhi i Pejgamberit s.a.v.s. është Miraxhi më i madh i të gjithë Pejgamberëve.

Transmeton Enesi (r.a.) se Pejgamberi s.a. ka thënë: "Kur jam ngritur (në Miraxh) me Xhebrailin (s.a.s.) mbërritëm deri te qielli i dynjasë. Lypi leje për t'u hapur dera. I thanë (engjëjt mbrojtës të qiellit): Kush është? U tha: Xhebraili. I thanë: Kush është me ty? U tha: Muhammedi (s.a.s.) I thanë: A i qenka dërguar ftesa për miraxh?! U tha: Po. Thanë: Mirë se vjen! Na gëzon ardhja e tij! U hap dera dhe sapo hyra brenda e pashë Ademin (s.a.s.) Xhebraili më tha: Ky është babai yt, Ademi. Përshëndetje! Unë e përshëndeta. Ma ktheu përshëndetjen (selamin) dhe më tha: Mirë se vjen, o bir dhe pejgamber i mirë! Pastaj Xhebraili (s.a.s.) më ngjiti më lartë derisa mbërritëm te qielli i dytë. U hap dera dhe sapo hymë brenda e pashë Jahjanë dhe Isain (s.a.s.), të cilët ishin djem tezeje. U përshëndetëm... Pastaj Xhebraili më ngjiti deri te qielli i tretë. Na u hap dera dhe sapo hymë brenda, kur ja e pashë Jusufin (s.a.s.) U përshëndetëm... Pastaj Xhebraili (s.a.s.) më ngjiti më lartë derisa mbërritëm te qielli i katërt. U hap dera dhe sapo hymë brenda e pashë Idrisin (s.a.s.) U përshëndetëm...Pastaj Xhebraili (s.a.s.) më ngjiti më lartë derisa mbërritëm te qielli i pestë. U hap dera dhe

sapo hymë brenda e pashë Harunin (s.a.s.) U përshëndetëm... Pastaj Xhebraili (s.a.s.) më ngjiti më lartë te qielli i gjashtë. U hap dera dhe sapo hymë brenda e pashë Musain (s.a.s.) U përshëndetëm...Kur e kalova atë, ai filloi të qajë. E pyetën: Përse qanë? U tha: Qaj, ngase pas meje do të vijë një pejgamber i ri, ummeti i të cilit më tepër do të hyjnë në Xhennet sesa ummeti im. Pastaj Xhebraili (s.a.s.) më ngjiti deri te qielli i shtatë. U hap dera dhe sapo hymë brenda e pashë Ibrahimin (s.a.s.) i mbështetur për Qabe , në të cilën hynin çdo ditë shtatëdhjetë mijë engjëj,dhe nuk ktheheshin më. Me atë rast Ibrahimi (s.a.s.) e përshëndeti, i shprehu mirëseardhje Pejgamberit (s.a.s.) dhe i tha: "O Muhammed dërgoi selam prej meje Ummetit tënd dhe urdhëroi ata të përgatisin e të mbjellin sa të munden farë parajse, sepse trualli i Parajsës është pjellor kurse toka është shumë e gjerë. Por cila është fara e Parajsës, e pyeti Pejgamberi (s.a.s.), tha: "La havle ve la kuvvete il-la bil-lahi -l- alijji-l-adhim"- "S'ka transformim as forcë përveç me ndihmën e All-llahut të Lartëmadhërishëm", iu përgjigj Ibrahimi (s.a.s.) "Pas kësaj Pejgamberi s.a.v.s. është ngritur deri në Sidretu-l-Munteha", e pastaj plotësisht i është afruar Allahut(xh.sh.)Ku Allahu e obligon me namaz. Pastaj Muhamedi (s.a.s.) niset të kthehet. Kur kalon pranë Musait, ky e pyet: "Çka t'është urdhëruar?" Përgjigjet: "Pesëdhjetë namaze në ditë" Musai i thotë: "Ummeti yt nuk mund ta zbatoj këtë. Kthehu të Zoti yt dhe lute që t'ia lehtësojë ummetit tënd" Kthehet tek Allahu (xh.sh.) dhe All-llahu xh.sh ia zvogëlon dhjetë namaze. Pejgamberi (alejhis-selam) lëshohet gjer te Musai dhe e njofton për këtë. Musai i thotë: "Kthehu te Zoti yt dhe lute t'ia lehtësoj ummetit tënd." Kështu, i Dërguari i All-llahut shkon lartë, poshtë te Musai dhe te Zoti i vet i Lartësuar, gjersa All-llahu e kufizon numrin e namazeve gjer në pesë sevapet e të cilëve do të jetë sa 50 namaze.

Për këtë ngjarje, Allahu (xh.sh.) flet në suren En Nexhm:

"Atë (Xhebrailin) e ka parë edhe herën tjetër." "(E ka parë) tek Sidretul Munteha." "Që pranë saj është xhennetul Me'va (kopsht strehimi i...)" "Atëherë kur Sidrën e mbuloi çka e mbuloi." "Shikimi (i Muhammedit) as nuk lakoi e as nuk tejkaloi." "Ai (Muhammedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet." (En-Nexhm13-18)

Të nesërmen, porsa agon mëngjesi, Muhamedi (s.a.s.) e njoftoi popullin e vet se All-llahu i lartësuar atë natë ia ka treguar disa nga fshehtësitë e Veta. Disa çka ishin me iman te dobët tejkaluan në mosbesim, e edhe më tepër bënin shpifje e rrena kundër tij. U vërsulën kundër tij edhe më ashpër. Kërkuan nga ai ta përshkruante Kuddusi Sherifin, e All-llahu i lartësuar ia lejoi këtë, dhe ai e përshkroi në detaje, me argumente

Nëse duam edhe më tej ta ndjekim Pejgamberin e Zotit në Miraxhin e tij, mos ta ndahemi nga falja e namazit. I kemi dhënë besën Zotit se namazin do ta falim dhe Pejgamberin (s.a.s.) në Miraxhin e tij do ta ndjekim.

Kush e kupton dhe e përjeton këtë ngjarje, mund të themi se ai ka bërë Miraxh me Pejgamberin (s.a.s.)

të qarta. Nuk ishin në gjendje ta kundërshtojnë për kurrgjë, nuk kishin më çka t'i thoshin. Gjithashtu u lajmëroi për karvanët e tyre të cilat shkonin dhe të cilat ktheheshin, dhe u tregoi se kur do të arrijnë në Mekë. Pastaj u tregoi për devenë e humbur nga kreu i karvanit, por të gjitha edhe më tepër nxisnin hidhërimin e tyre, sepse jobesimtarët gjithnjë mohojnë. Një grup shkuan te Ebu Bekri (r.a.) dhe i thane: A ke dëgjuar për shokun tënd (Muhammedin)? Ai është duke deklaruar se ai ka vizituar Jerusalemin dhe pushtetin e Lartë në qiej mbrëmë, dhe ka folur me Allahun e madhëruar. A e beson këtë?" Hazreti Ebu Bekri (r.a.) menjëherë përgjigjet; "Në qoftë se ai ka thënë kështu, është plotësisht e vërtetë." Ata përsëri i thanë: "A e beson se ai i ka vizituar të gjitha këto vende dhe është kthyer në një kohë të shkurtër të natës!" Ai përsëri u përgjigj: "Sigurisht që e besoj këtë dhe unë besoj në gjërat që janë më të çuditshme se kjo siç është Xheneti dhe Xhehenemi." Për këtë Muhamedi (s.a.s.) e titulloi atë "Es-Siddik" që do të thotë person i drejtë dhe i sinqertë në besim pa pasur asnjë dyshim të vogël. Sigurisht besimi i Ebu Bekrit ishte më i fortë se çdo gjë. Këto ishin disa nga argumentet e israse dhe miraxhit.

Nëse duam edhe më tej ta ndjekim Pejgamberin e Zotit në Miraxhin e tij, mos ta ndahemi nga falja e namazit. I kemi dhënë besën Zotit se namazin do ta falim dhe Pejgamberin (s.a.s.) në Miraxhin e tij do ta ndjekim. Miraxhi është treguesi më i mirë se si besimtari musliman duhet marrë si model Muhamm,edin (s.a.s.), duhet të ballafaqohet në mënyrë heroike me jetën dhe problemet e saj, me vështirësitë dhe krizat eventuale dhe në fund të dalë fitimtar. Miraxhi ishte dhe mbeti pishtar dhe dritë e përjetshme për shpirtin e muslimaneve. Veçanërisht me imitacionin e tij prej 5 namazeve brenda ditës që u bënë farz në Miraxh, qe namazi mund te quhet per besimtarin miraxhi i vogël. Të nderuar besimtarë, të përkujtojmë këtë natë të madhe, këtë udhëtim nate, sepse ai edhe sot e gjithherë do të jetë forcë e lëvizje e gjallë në Islam. Vetëm se duhet të jemi të aftë e të fuqishëm shpirtërisht që të kuptojmë vërtetësish rëndësinë e vlerën e Miraxhit dhe t'i shfrytëzojmë në mënyrë të drejtë e konstruktive frytet e tij. Kush e kupton dhe e përjeton këtë ngjarje, mund të themi se ai ka bërë Miraxh me Pejgamberin (s.a.s.)

Shoqëria dhe paraja

Duhet të nxirret mësim pozitiv nga kritikat.

Për çdo periudhë të jetës është e rëndësishme t'i marrim në konsideratë kritikat që na vijnë nga mjedisi që na rrethon, sepse ata që na rrethojnë, çfarëdo qoftë afërsia e tyre me ne, na ndihmojnë të njohim më mirë dhe të shohim veten tonë me sytë e të tjerëve. Në rini mjedisi dhe shoqëria ndikojnë më shumë. Zgjedhja e mjedisit është pjesërisht në dorën tonë. Në formimin e personalitetit janë të rëndësishme njohja e vetvetes dhe fitimi i aftësive për ta njohur e për ta kuptuar realitetin, në bazë të përvojës e të dijeve të grumbulluara që më parë. Ai merr vlerësime për sjelljet e tij nga ambienti që e rrethon. Personi, në rast se do t'i kushtojë rëndësi kritikave, njihet me pikëpamje të ndryshme dhe arrin të gjykojë, nëse veprimet e mendimet e tija janë të drejta apo jo. Megjithëkëtë, përmirësimi i veprimeve në jetën tonë sipas kritikave që na bëhen dhe ngurrimi për të kryer ato gjëra të nevojshme, dëmtojnë personalitetin tonë.

Shumë anë të jetës suaj fetare, të vlerave tuaja, marrëdhënieve me shokë dhe rrobat e veshjet tuaja mund të jenë objektiv i kritikave. Disa të rinj që u japin shumë rëndësi shokëve, që duan të jenë të pranueshëm në një grup shoqëror ose që kanë frikë të dalin nga ky grup shoqëror, nën ndikimin e shokëve, sillen në mënyrë të pahijshme. Pirja e cigares, e alkoolit madje edhe argëtimi etj...

Ju mund të kritikoheni për shkak të shkallës së sinqeritetit me shokët e tjerë dhe pse u keni dhënë sekrete. Shumica e kritikave të këtilla ndihmojnë në parandalimin e teprimit në disa çështje që iu përkasin dhe të lidheni shumë pas një shoku e t'i lini të tjerët. Megjithëkëtë, është i rëndësishëm dallimi i atyre që bëjnë kritika. Disa mund të dëshirojnë që ju të krijoni shoqëri vetëm me ta; është e pamundur t'i bëni të kënaqur të gjithë njerëzit. I riu që i bënë autokritikë vetes vazhdimisht, sipas fjalëve të shokëve dhe

Disa mund të dëshirojnë që ju të krijoni shoqëri vetëm me ta; është e pamundur t'i bëni të kënaqur të gjithë njerëzit. I riu që i bënë autokritikë vetes vazhdimisht, sipas fjalëve të shokëve dhe përpiqet të sillet në mënyrë që t'i bëjë të kënaqur ata, e ndien veten nën stres më tepër dhe ka vështirësi në formimin e personalitetit të tij: është e natyrshme takimi më shpesh dhe qenia më afër me disa shokë.

përpiqet të sillet në mënyrë që t'i bëjë të kënaqur ata, e ndien veten nën stres më tepër dhe ka vështirësi në formimin e personalitetit të tij: është e natyrshme takimi më shpesh dhe qenia më afër me disa shokë, ndërsa me disa të tjerë qëndrimi më me distancë.

Disiplina është për të gjithë të rinj e pleq. Jeta pa disiplinë vështirëson vetëkontrollin e të rinjve, prish rregullin e gjumit dhe në përgatitjet, mësimet dhe punën e tij, për të ardhmen bëhet shkak për shthurje. Megjithëkëtë, shokët, tek fjalët e të cilëve keni besim, ju ndihmojnë në zhvillim të shëndoshë, duke ju

paralajmëruar në rast se nëna juaj ju bën shumë presione. Nëse dalloni se nuk jeni të aftë të bëni gjykime objektive se kush është më i drejtë në këtë çështje, shoku juaj apo nëna juaj, atëherë është e dobishme të konsultoheni me më të mëdhenjtë tuaj si: mësuesi konsulent i shkollës, fjalët e të cilëve i besoni.

Fëmija

Dhënia e parave të tepërta fëmijës, e shtyn atë në kërkime të gabuara. Shuma e të hollave që do t'i jepet fëmijës, pa dyshim është një vendim individual që do ta japë çdo familje, në bazë të gjendjes së saj ekonomike. Por, ka disa pika që prindërit duhet të kenë parasysh në këtë çështje.

Shuma e të hollave është një përgjegjësi që ndihmon rritjen e fëmijës dhe të qenët i pavarur. Por, gabimet që bëhen, kur japim të holla, ndërpret detyrat e rritjes së fëmijës si: përgjegjësia dhe autonomia të cilat duhet t'i fitojë në këtë periudhë. T'i japësh fëmijës në mënyrë të pakontrolluar, të holla më tepër se nevoja që ka, ose si rezultat i kontrollit të tepërt të parasë që i jepet, dikush nga fëmijët bëhet shpërdorues i madh, ndërsa i kundërti me të bëhet koprraci i koprrac ëve. Fëmija që tregon interes në rritje gjatë përdorimit të të hollave, do të ketë edhe iluzione në lidhje me jetën e tij për kohët në vijim.

Fëmijët, kur janë në periudhën parashkollore, nuk kanë njohuri të sakta rreth parasë. Paraja, për fëmijët 3-4 vjeç është një mjet për të blerë një lodër ose karamele. Ata fillojnë të njohin vlerën e parasë në moshën 5-7 vjeç. Ndërsa në moshën 8-11 vjeç, arrijnë të kuptojnë vlerat e ndërlikuara të saj. Kështu që fëmijës në moshën 8-9 vjeç të hollat i jepen për nevoja ditore, ndërsa rreth moshës 10-11 vjeç, i jepen javore. Në të hollat që u jepen javore, fëmija mëson të menaxhojë paranë e vet duke bërë plane me llogari të ndryshme.

Fëmijët, kur janë në periudhën parashkollore, nuk kanë njohuri të sakta rreth parasë. Paraja, për fëmijët 3-4 vjeç është një mjet për të blerë një lodër ose karamele. Ata fillojnë të njohin vlerën e parasë në moshën 5-7 vjeç. Ndërsa në moshën 8-11 vjeç, arrijnë të kuptojnë vlerat e ndërlikuara të saj. Kështu që fëmijës në moshën 8-9 vjeç të hollat i jepen për nevoja ditore, ndërsa rreth moshës 10-11 vjeç, i jepen javore. Në të hollat që u jepen javore, fëmija mëson të menaxhojë paranë e vet duke bërë plane me llogari të ndryshme dhe gjen mundësinë e zhvillimit të përshtatshëm për të marrë vendime.

Të hollat nuk janë metodë ndëshkimi.

Prindërit nuk duhet ta përdorin shumën e të hollave si mjet ndëshkimi për shkak të dështimit dhe prapësive të fëmijës.

Mund t'i vendosni kusht mbledhjes së të hollave për një kohë të shkurtër. Lëreni të marrë atë që dëshiron me të hollat që ka mbledhur nën kontrollin tuaj.

Mos u jepni të gjithë fëmijëve shumë të njëjtë të hollash. Bëni kujdes në shtimin e saj sipas moshës.

Shuma e të hollave duhet të mbulojë nevojat javore. Fëmijës suaj mund t'i jepni të holla shtesë; pak për të shpenzuar dhe pak për të mbledhur. Por mbajtja e shumës së të hollave më të lartë se nevojat e fëmijës, shton rrezikun e shkuarjes në mjedise të dëmshme.

Marrja e të hollave nga babai, i cili është simbol i fuqisë dhe i sigurisë në familje, te fëmija do të kontribuojë në formimin e sigurisë. Për këtë shkak, nëse është e mundur, në familje duhet të sigurohet që fëmija të marrë një shumë të hollash edhe nga babai.

Përgatiti: **Arjan Ymeraj**

Zejnep binti Muavije bashkëshortja e Abdullah ibni Mesudit

Mustafa ERISH



Zejnepja ishte një grua që studionte dhe që përpiqej t'i mësonte gjërat që i nevojiteshin në lidhje me fenë. Ajo nuk ndihmonte vetëm fëmijën dhe bashkëshortin e vet, por në të njëjtën kohë, ajo kujdesej edhe për fëmijët e vëllezërve që kishin mbetur jetimë. Zejnep binti Muavije transmetoi tetë hadithe nga Resulullahu (s.a.s.). Ajo ishte shumë e ndershme dhe e dhënë pas kryerjes së veprave bamirëse.

Zejnep binti Muavije ishte një grua e zellshme në të mësuarit e Islamit. Ishte ajo që pyeti të Dërguarin e Allahut rreth zekatit dhe sadakasë. Megjithëse paratë i fitonte me punë dore ishte bujare dhe e dhënë pas infakut. Ajo ishte një bashkëshorte e devotshme dhe e nderonte sahabiun e nderuar Abdullah ibni Mesud.

Ajo i përkiste fisit Sakif. Emri i babait te saj mendohet të ketë qenë Muavije ose Abdullah. Megjithëse nuk kemi të dhëna të detajuara në lidhje me këtë gjë, ajo ishte martuar me sahabiun e nderuar Abdullah ibni Mesud. Ata patën një djalë me emrin Ebu Ubejde. Bashkëshorti i saj Abdullah ibni Mesudi qe personi që e dinte fik'hun më mirë pas katër kalifëve dhe njeriu i parë që lexoi Kur'an haptas përpara mushrikëve (politeistëve) në Mekke (pranë Qabes). Ai ishte një nga sahabet e rinj trima dhe guximtarë.

Zejnepja ishte një grua e hijshme, elegante dhe me talent. Ajo gjithmonë mundohej të punonte diçka të re. Ishte punëtore dhe e përpiktë. Punimet që i bënte me dorë i shiste dhe kishte një fitim të begatë. Duke shitur pajën që e kishte përgatitur dhe ruajtur si drita e syrit ishte bërë e pasur. Nga fitimi që i dha Allahu në këtë tregti, u tregua shumë e përpiktë në dhënien e zekatit. Bashkëshorti i saj, Abdullah ibni Mesudi ishte një njeri që veten ia kishte dedikuar diturisë dhe ishte vënë plotësisht në shërbim të Islamit. I shërbente diellit të dy botërave dhe nuk ndahej kurrë nga ai. Gjithmonë ndodhej pranë të Dërguarit të Allahut dhe i shërbente si në sjelljen e ujit të abdesit, po ashtu edhe në interesimin e gjërave të tjera. Kishte fituar aq shumë kënaqësinë e të Dërguarit (s.a.s.) saqë futej tek Ai pa marrë leje. Ishte rritur dhe edukuar pranë diellit të dy botërave.

Abdullah ibni Mesudi ishte sahabiu që e lexonte Kur'anin më mirë nga të gjithë. Ai u bë model dhe pishtar për dijetarët që erdhën pas tij në të gjithë fushat, si: hadith, tefsir, fikh dhe në kiraet (mënyrat e të lexuarit të Kur'anit).

Zejnepja (r.anh.) ishte e dhënë shumë pas diturisë dhe për të mësuar flijonte çdo gjë. Gjërat që nuk i dinte mundohej t'i mësonte duke pyetur. Ligjëratat që i jepte i Dërguari (s.a.s.) për femrat, nuk i humbiste asnjëherë, gjithmonë ishte e pranishme. Ajo edhe obligimet fetare dhe jetësore mundohej t'i kryente së bashku. Një ditë kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.) u shpreh: "Jepni sadaka, qoftë edhe nga stolitë tuaja" Zejnepja ishte e pranishme. Ajo pasurinë më shumë e harxhonte në ndihmë të bashkëshortit dhe djalit të saj. Në të vërtete bashkëshorti i saj nuk kishte asnjë të ardhur, kështu që shpenzimet familjare i përballonte Zejnepja. Duke u sjellë në këtë mënyrë jo vetëm që ndihmonte bashkëshortin, por edhe ia mundësonte atij të merrte dituri dhe t'i shërbente Islamit.

Në kohën kur dielli i dy botërave (s.a.s.) po këshillonte një grup nga sahabët në zemrën e Zejnepes lindi një pyetje. A thua këto që kam dhënë, mund të quhen zekate? Këtë pyetje në radhë të parë ia bëri bashkëshortit, pastaj kërkoi nga ai që të shkonte të pyeste të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), por bashkëshorti e këshilloi që të shkonte ta pyeste vetë të Dërguarin (s.a.s.) dhe të merrte përgjigjen e duhur. Zejnepja ishte një grua kureshtare dhe pas rekomandimit që i bëri bashkëshorti, shkoi direkt tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Kështu, në librat burimorë të hadithit (si Buhari dhe Muslim) merr pjesë edhe transmetimi i Zejnepes. Hadithi është kështu:

Nga bashkëshortja e Abdullah ibni Mesudit, Zejnepe Sakafiji transmetohet se Resulullahu (s.a.s.) ka thënë:

"Ej ju gra! Jepni sadaka (lëmoshë) qoftë edhe nga stolitë tuaja".

Zejnepja vazhdoi duke thënë: "Pasi dëgjova këtë, u ktheva tek bashkëshorti dhe i thashë: "Ti je një njeri i varfër. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) na ka urdhëruar të japim sadaka, kështu që shko e pyete ti të Dërguarin (s.a.s.) nëse pranohet si zekat sadakaja që të jap unë ty! Sa mirë do të ishte, po të pranohej. Nëse jo, duhet t'ia jap dikujt tjetër. Abdullahu më tha: "Shko e pyete vetë të Dërguarin (s.a.s.)". Kështu që unë vajta vetë ta pyes. Kur arrita tek shtëpia e Resulullahut pashë një grua nga ensarët që po priste para derës. Edhe ajo kishte të njëjtin problem që kisha unë. Druheshim të hynim tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Në kohën kur doli Bilali, ne i thamë atij: Shko tek Resulullahu (s.a.s.) dhe thuaji se po presin dy gra tek porta dhe pyete nëse pranohet sadakaja e tyre që ua japin bashkëshorteve dhe jetimëve të tyre, por mos i trego se kush jemi!

Bilali vajti direkt tek i Dërguari dhe i bëri pyetjen.

Resulullahu (s.a.s.) tha:

-Pyeti kush janë ato?

Bilali u përgjigj:

-Zejnepja dhe nje grua nga ensarët.

Zotëria ynë përsëri:

-Cila Zejnepe?

Bilali u përgjigj:

-Bashkëshortja e Abdullahut.

Resulullahu u përgjigj në këtë mënyrë:

"Ata, duke vepruar kështu, fitojnë dy shpërblime në të njëjtën kohë. Njëri i vjen për arsye se kujdesen për të afërmit, i dyti është shpërblimi i sadakasë"

(Rijadus'Salihin terceme ve sherhi vëll. 2, fq. 449-452. Buhari, Zekat 48; Muslim, Zekat 45)

Zejnepja ishte një grua që studionte dhe që përpiqej t'i mësonte gjërat që i nevojiteshin në lidhje me fenë. Ajo nuk ndihmonte vetëm fëmijën dhe bashkëshortin e vet, por në të njëjtën kohë, ajo kujdesej edhe për fëmijët e vëllezërve që kishin mbetur jetimë.

Dy gra nga ensarët, pa dijeni të njëra tjetrës, erdhën tek shtëpia e të Dërguarit, por druheshin që të futeshin brenda. Në të vërtetë Allahu i lartësuar e kishte ndaluar që t'i bëheshin shumë pyetje të Dërguarit të Allahut. Prandaj të gjithë sahabet, për shkak të respektit të madh që ushqenin për Resulullahun (s.a.s.) kishin drojë se mos e shqetësonin. Kur hynin pranë tij, silleshin aq mirë, sikurse të kishin mbi kokë një zog që nuk donin ta dëbonin prej aty.

Dielli i dy botëve, duke iu dhënë përgjigje dy sahabëve nëpërmjet Bilalit, në të njëjtën kohë tregoi se sadakaja që u jepet të afërmve është shumë e pranueshme dhe për të ka dy shpërblime në të njëjtën kohë.

Ashtu siç na urdhëron të ndihmojmë dhe të kujdesemi për të varfrit, në të njëjtën kohë, feja Islame na urdhëron që të ruajmë dhe të kujdesemi edhe për të afërmit. Duke vepruar në këtë mënyrë, personi që ia jep sadakanë farefisit, fiton dy sevape në të njëjtën kohë. Pra, goditen dy zogj me një gur.

Zejnepja e mori përgjigjen bindëse që i kishte mbetur peng në zemër. Në të vërtetë gruaja nuk është e detyruar të jetë përgjegjëse për shpenzimet familjare, por shpenzimi që bën për ta, kalon në vend të sadakasë, kështu që duke ua dhënë atyre është edhe më mirë, ka shpërblim më të madh.

Zejnep binti Muavije transmetoi tetë hadithe nga Resulullahu (s.a.s.). Ajo ishte shumë e ndershme dhe e dhënë pas kryerjes së veprave bamirëse. Hadithi më i njohur që transmetoi ajo është ai i lartpërmenduri.

Ajo i mësonte me shumë kureshtje dhe zell bukuritë e Islamit dhe ato që lexonte mundohej t'i praktikonte në jetë. Zejnepja, kur dëgjonte ndonjë urdhër apo ndalim nga Resulullahu (s.a.s.), menjëherë vepronte sipas këshillës së të Dërguarit. I Dërguari, ngaqë e dinte përpikmërinë e Zejnepes, mundohej që ta edukonte si një ushtare fisnike duke i dhënë gjithmonë mesazhe te reja.

Një ditë i Dërguari i Allahut (s.a.s.) e pa në mesxhid dhe i dha këtë këshillë, duke iu drejtuar të gjitha femrave muslimane:

"Cilado prej jush, kur të shkojë në xhami për namazin e jacisë, mos të parfumoset".

Sa përpikmëri!..Sa kujdes!...Sa jetë e bukur!...Sa lumturi për ata që jetojnë jetën në këtë mënyrë!...Sa lumturi për ata që mundohen të formojnë një jetë, një familje , një shoqëri të tillë.

O Zot, na mundëso edhe ne të jemi të përpiktë, ashtu sikurse ishin të parët tanë. O Zot na jep dituri dhe zgjuarsi që ti transmetojmë bukuritë e mahnitshme të asaj gjenerate në ditët tona. O Zot na bëj edhe ne pjesëtar të karvanit të asaj gjenerate...

Allahu qoftë i kënaqur nga ajo. Allahu na mundë-softë ndërmjetësimin e saj.

Amin!

Përktheu: **Tasim Darsi**

Arti i Tezhibit

Arti i Tezhibit, si një nga artet tona të librarive të vjetra të traditës, ka një të kaluar të gjatë dhe me rrënjë të thella. Veprat e shkrimit me dorë quhen Arti i zbukurimit i bërë me bojë dhe stoli imitacioni të artë vulave të padishahëve me husn-i hat, pra me fletë shkrimi të bukura dhe albume.

Materiali kryesor që përdoret në Tezhip është floriri ose boja. Ari ose floriri përdoret si varak i kthyer në formën e një tabaku të hollë të rrahur. Varaku i artë pasi shkrihet në ujë, vihet në një formë të caktuar duke u përzier me xhelatinë ndërsa boja, zakonisht zgjidhej nga bojërat e tokës. Më vonë janë përdorur edhe bojerat sintetike. Mjeshtri pikësëpari e vendos motivin e vizatuar në një letër mbi një bush ose zinkë dhe, me anë të gjilpërës, hap një vijë të pikëzuar. Më pas, duke vendosur letrën e shpuar mbi sipërfaqen në të cilën do të bëhet forma i mbush vrimat e hapura me një pluhur të zi ngjitës. Sapo letra të hiqet del në dukje sipërfaqja në të cilën do të bëhet motivi. Ky motiv theksohet në mënyrë të mirëfilltë dhe, duke u mbushur me ngjyrë floriri apo me bojë, del ne pah tezhipi.

Pjesa më e madhe e shkrimeve të posaçme për bibliotekat, dhëne padishahut dhe autoriteteve të tjera të rëndësishme marrë nga librat e shkrimit me dorë; pjesa më e madhe e përmbledhjeve të veprave, divaneve dhe librave të tjerë janë punuar me artin e Tezhibit. Në mënyrë të veçantë në Kur'ane vihet re një zbukurim shumë i pasur tezhibi. Pjesët e sipërme, dy faqet e para, ngandonjëherë edhe katër faqet e para janë të zbukuruara me tezhip, Duaja e hatmes dhe faqja e fundit ku ndodhet firma e hattatit janë me tezhip, titulli i shkrimit i bërë deri në vendin ku fillon pjesa e tekstit të librit, pikerisht aty ku ndodhen titujt dhe ajo që quhet mihrabije, në çdo fillim të sureve dhe kapitujve gjithashtu edhe në krye të sureve Fatiha dhe Bakare vihet në dukje me zbukurime të pasura tezhibi. Në veprat me Tezhip tërheqës nga fillimi deri në

Mjeshtri pikësëpari e vendos motivin e vizatuar në një letër mbi një bush ose zinkë dhe, me anë të gjilpërës, hap një vijë të pikëzuar. Më pas, duke vendosur letrën e shpuar mbi sipërfaqen në të cilën do të bëhet forma i mbush vrimat e hapura me një pluhur të zi ngjitës. Sapo letra të hiqet del në dukje sipërfaqja në të cilën do të bëhet motivi. Ky motiv theksohet në mënyrë të mirëfilltë dhe, duke u mbushur me ngjyrë floriri apo me bojë, del ne pah tezhipi.

fund, mes rreshtave, anësoret e faqeve, gjithashtu edhe në veprat poetike tezhibi është përdorur në hapësirat boshe mes dy vargjeve. Pjesa më e madhe e titujve të faqeve të librave të shkrimit janë në formën e një kurore kupolë, ndërsa pjesa e sipërme e tyre mbaron me maja të mprehta të quajtura "Tig". Përveç këtyre formave të tezhibit të vogël të bëra për të ndarë ajetet dhe fjalitë quhen "Nokta / Pikë" Këta ashtu sikurse mund të jenë në formën e yllit apo të lules ashtu marrin edhe emra të ndryshëm sipas formës.

Ata që janë në formën gjeometrike quhen "Pika me vlerë", ata që janë me gjashtë qoshe "Sheshhane nokta", ata që janë me pesë fletë "Pençberk nokta", ndërsa ata që janë me tre fletë "Seberk nokta", zbukurimet që ndodhen në anësoret e faqes së Kur'anit të cilat brenda janë bosh dhe në formë rrethore që rrethojnë anët e shkrimeve të shkruara për të treguar se kujt i përket shkrimi në atë faqe, quhen "Trëndafil" Ato marrin emra të ndryshëm sipas vendit ku ndodhen. Trëndafili i vakfit, i sexhdes dhe i klikës vendosen një për çdo pesë faqe, trëndafili i xhyzit në çdo njëzet faqe ndërsa trëndafili i sures vendoset në krye të çdo sureje. Ata që janë edhe më të mëdha dhe më të zbukuruara se sa motivet e trëndafilave quhen "Shemse" Zakonisht shemse është një lloj zbukurimi i bërë në mes të kapakëve xhilt, një dalje e motiveve "diell" pasi "shems" do të thotë "diell" Faqet e librave me shkrim dore, përfshijnë në vetvete një kornizë me yje e përbërë nga dy vijëzime një i trashë dhe një i hollë. Këto vijëzime të arta quhen "Xhedvel" Ndonjëherë në anësoret e xhedveleve bëhen vijëzime në ngjyra të ndryshme të quajtura shkrim. Ashtu sikurse ka mjeshtër që shkruajnë këto, ka edhe artistë të posaçëm që merren me këto punë. Këta quhen "Xhedvelkesh" Në anësoret e faqeve përveç xhedveleve vihen re edhe ujëra të bëra me lule dhe zbukurime. Këta marrin emra sipas formës së tyre. Ata që janë më të gjëra quhen "Zenxhirek" pra si zinxhir. Hallkave që vijnë njëra pas tjetrës u thuhet "Ulama", ndërsa bordurat e zbukuruara me lule të brëndëshme dhe fletë quhen "me degë të kthyera" Gjithashtu bëhen edhe disa zbukurime tezhibi për zbukurimin e fjalëve dhe të gërmave në pllakat Husni hat Këta quhen "Hurda tezjinat".

Përgatiti: **Evans Drishti**

Pjesa më e madhe e titujve të faqeve të librave të shkrimit janë në formën e një kurore kupolë, ndërsa pjesa e sipërme e tyre mbaron me maja të mprehta të quajtura "Tig". Përveç këtyre formave të tezhibit të vogël të bëra për të ndarë ajetet dhe fjalitë quhen "Nokta/Pikë". Këta ashtu sikurse mund të jenë në formën e yllit apo të lules ashtu marrin edhe emra të ndryshëm sipas formës.

Gabime që njihen si të drejta

Këto bimë ndihmojnë funksionimin e zorrëve, parandalojnë kapsllëkun që haset shpesh nëpër dieta. Por, është e gabuar dija se tret dhjamërat në trup me anë të urinës.

Shtypi përmban plot sugjerime rreth të ushqyerit dhe dietës. Mirëpo, sa të vërteta dhe sa të gabuara janë këto informacione?

Ja pra, informacionet që hasen më shumë dhe gabimet që i dimë si të vërteta.

Specialistja e të ushqyerit dhe e dietës gjatë përgjigjes që u jep pyetjeve që bëhen më së shumti, rregullon gabimet që i konsiderojmë si të vërteta.

A i pakësohen kaloritë bukës po të theket?

Specialistja thotë: "Rreshkja e bukës ose thekja e saj nuk pakëson kaloritë, por shkakton pakësimin e grupit të vitaminave B që përmban. Rreshkja ose thekja e bukës shkakton edhe avullimin e ujit që përmban." Ajo nuk këshillon konsumimin shumë të tepruar të bukës së rreshkur.

A është e drejtë metoda e ndarjes së karbohidrateve nga proteina?

Nuk ka mbetur askush pa e dëgjuar dietën karbohidrat-proteinë, të cilën e gjejmë herë pas here pjesë të revistave dhe gazetave. Vallë cila është origjina e kësaj diete? Me të vërtetë, a është i mundur me këtë mënyrë një dobësim i shëndetshëm? Sipas të dhënave që jep specialistja, ushqimet, sipas përbërjes ushqyese, nuk mund t'i ndajmë vetëm në burime me karbohidrate ose në burime me proteina. P. sh. Mishi, që njihet si burimi i proteinave, përmban edhe karbohidrate dhe yndyrë. Gjithashtu edhe orizi që njihet si burim karbohidrati, përmban si karbohidrat ashtu edhe proteina dhe yndyrë.

Specialistja, e cila thotë se, gjatë mbajtjes së dietës, pika më e rëndësishme që duhet pasur kujdes gjithmonë është konsumimi i ekuilibruar (mesatar) i elementëve ushqyes si karbohidrate, yndyrë dhe proteina, që brenda një dite trupi ka nevojë t'i marrë të gjitha së bashku në çdo vakt, paralajmëron duke thënë: "Dieta për dobësim duhet të mos ju largojë nga disa ushqime, ajo duhet të jetë e fortë nga aspekti i rregullimit të zakoneve të gabuara në të ushqyer. Me dietat që janë përgatitur në këtë mënyrë nuk mund të rifitoni shëndetin që keni humbur. Mos harroni se me dietat që përgatiten në mënyrë të pandërgjegjshme shëndeti juaj është në rrezik. Veçanërisht, shëndeti i dhënë me dieta jo të ekuilibruar, merret përsëri, madje, edhe më tepër.

A të dobëson pirja e ujit të ngrohtë me limon, esëll në mëngjes?

Specialistja e të ushqyerit dhe e dietës kësaj pyetjeje i përgjigjet duke thënë Jo! Ajo më tej vazhdon kështu:

Ne si specialistë të të ushqyerit, rekomandojmë pirjen e ujit esëll në mëngjes. Por, kjo nuk ka të bëjë aspak me dobësimin. Synimi i kësaj është të përgatitim gjatë ditës trupin që ka kaluar në gjumë

një kohë prej rreth 8-9 orësh, njëlloj sikur të lajmë fytyrën në mëngjes. Limoni është një fryt i dobishëm, por lëngu i tij nuk ka ndonjë aftësi për tretjen e dhjamit.

A është e vërtetë se patatja e zier nuk të shëndosh?

Sipas specialistes edhe kjo është një dije e gabuar. Specialistja, e cila sqaron se në një patate e zier me madhësi mesatare gjenden 70 kalori, d.m.th. ka kalori të barabartë me një bukë të bardhë, thotë: "Nëse i skuqim patatet, kaloritë shtohen edhe më shumë. Por nuk është e drejtë të thuash se patatja e zier nuk të vë shëndet."

A është e drejtë zierja dhe pirja e lëngut të bimëve si trumzë (lisën) e majdanoz për të tretur dhjamërat e tepërta me urinë?

Specialistja, e cila thotë se ekziston një besim i gabuar rreth lëngut të trumzës dhe majdanozit, të cilat largojnë nga trupi dhjamërat shton:

"Këto bimë ndihmojnë funksionimin e zorrëve, parandalojnë kapsllëkun, që haset shpesh nëpër dieta. Por, është e gabuar dija se tret dhjamërat në trup me anë të urinës."

A ngordhin aq mikrobe sa më shumë të ziejë qumështi?

Sipas të dhënave që jep specialistja, zierja e tepërt e qumështit, i cili njihet si depozita e vitaminës dhe e mineraleve, shkakton pakësimin e mineraleve që përmban. Prandaj, gjithnjë gjatë zierjes së qumështit që nuk është pasterizuar ose nuk është sterilizuar, 4-5 min. pas fryrjes duhet ta trazojmë vazhdimisht dhe ta ftohim menjëherë. Ndërsa për qumështin e pasterizuar ose sterilizuar nuk është e nevojshme të zihet.

A i jep gjallëri trupit pirja e vezës në mëngjes?

Specialistja, e cila sqaron se konsumimi i vezës së pazier, kundër asaj që dihet, nuk këshillon vënien në përdorim të disa vitaminave në trup, ajo thotë: "Për këtë arsye është e dobishme skuqja e vezës për mëngjesin e fëmijëve tuaj. Prandaj, trajta më e shëndetshme e vezës, është ajo që ka të verdhën e saj të plotë sa një tule e kajsisë dhe që nuk ka përreth hallkë ngjyrë jeshile. Nëse është formuar një hallkë ngjyrë jeshile rreth të verdhës, do të thotë se vezën e keni zier shumë.

A është i dëmshëm lëngu ngjyrë jeshil i kosit?

Specialistja kësaj pyetjeje i përgjigjet kështu: "Kosi, me kalimin e kohës, rrethohet nga një lëng ngjyrë jeshil. Prandaj, dikush nga ne këtë lëng ngjyrë jeshile mendon se është e dëmshme dhe e derdh. Megjithatë, vitaminat që gjenden në kos dhe veçanërisht vitamina B12 përzihet me këtë lëng ngjyrë jeshil. Ndërsa kosi i kulluar që përgatitet duke e ndarë ujin nga kosi, përmban më pak vitamina në krahasim nga kosi i përzier me lëngun jeshil që formohet sipër kosit.

Ja dhe një rekomandim i fundit nga specialistja e të ushqyerit dhe e dietës:

"Njohuritë që keni marrë nëpër revista e gazeta ose i keni dëgjuar nga ndonjë shok i juaj, mos i zbatoni pa u konsultuar me specialisten e dietës".

Përgatiti: **Arjan Ymeraj**

Iran

Kritikë "demokratike" nga SHBA drejtuar Moskës, e cila mbron Iranin

Zëvendës-presidenti i SHBA-së Dick Cheney (Dik Çenej), i cili ka folur në mbledhjen e konferencës së vendeve Baltik-Deti i Zi që u mbajt në Lituani, shprehu mendimin se në Rusi fitoret demokratike janë marrë mbrapsht. Cheney, i cili u shpreh se të drejtat e njerëzve po cenohen në shumë fusha, akuzon Moskën, se ka përdorur si mjet shantazhi burimet energjetike. Kritika e SHBA-së ndaj Moskës, e cila më përpara shumicën e rasteve ka mbetur pa zë mbi hapat "antidemokratike" lidhet me mosdhënien e lejes nga Moska për sanksione ndaj Iranit.

Është e hapur rruga diplomatike në zgjidhjen e krizës së Iranit

Kancelarja gjermane Angela Merkel (Anxhela Merkel), e cila kohët e fundit duket se është afruar me boshtin Rusi-Kinë, ka hedhur në tryezë problemin e armëve bërthamore, bashkë me presidentin e SHBA-së George W. Bush. Të dy kryetarët bënë thirrje për zgjidhje diplomatike, duke theksuar qëndrim të pajtueshëm ndaj Iranit, i cili me asnjë mënyrë nuk duhet të zotërojë armë bërthamore. Merkel, duke sqaruar mundësinë e mbajtjes të një fronti diplomatik kundrejt Iranit, në konferencën e përbashkët për shtyp tha: "Ne mendojmë se probabiliteti i zgjidhjes diplomatike është i madh", ndërsa Bush, duke i bërë thirrje Teheranit, u shpreh me këto fjalë: "Irani, duhet të dijë se ne nuk hedhim hap mbrapa në emër të paqes botërore, ai duhet të heqë dorë nga dëshira e ethshme për armë nukleare." SHBA thekson se në rast se Këshilli i Sigurimit të OKB-së nuk arrin të marrë masa për të bindur Iranin për shkak të mbështetjes që ai gëzon nga boshti Rusi-Kinë, ndaj këtyre të fundit do të hidhet një hap tjetër nga "një koalicion që do të formohet me shtete aleate". Kancelarja gjermane Merkel, në takimin që mbajti javën e kaluar me presidentin rus Vladimir Putin, zbuti qëndrimet e mëparshme, duke rënë dakord me Moskën mbi parimin "Ndaj Iranit të zbatohet vetëm presion diplomatik".

Aktualitet

Ballkani

Premtim i Serbisë për dorëzimin e Mlladiçit

Gjykata e Hagës për krimet e luftës, bëri të qartë se Serbia dha garancinë se brenda këtij muaji do të arrestojë dhe do të dorëzojë gjeneralin serb Ratko Mlladiç i shumëkërkuar me akuzën për krime lufte.

Prokurorja e Përgjithshme e Gjykatës së Hagës për krime lufte, Clara Del Ponte (Klara Del Ponte), ka deklaruar nëpërmjet zëdhënëses së saj se "Kryeministri i Serbisë Koshtunica dha garancinë e prerë rreth arrestimit dhe dorëzimit pranë kësaj gjykate të kriminelit Ratko Mlladiç brenda këtij muaji".

Koshtunica i garantoi autoriteteve të Hagës dorëzimin e Mlladiçit, i kërkuar prej vitesh deri në fund të këtij muaji. Mosarrestimi i Ratko Mlladiçit, Serbinë e ka lënë në situatë të vështirë përpara Kombeve të Bashkuara si dhe ka ndikuar negativisht në marrëdhëniet me BE-në.

BE ka kërcënuar edhe më përpara se do të pezullojë përkohësisht negociatat që ka nisur me Serbinë në rast se kjo e fundit nuk bashkëpunon në lidhje me arrestimin e Mlladiçit. Prokurorja e përgjithshme Clara del Ponte, në raportin që sqaroi javën e kaluar, bëri të qartë se Serbia ka rritur shkallën e bashkëpunimit në lidhje me arrestimin e Mlladiçit.

Irak

Bëhet e ditur se për shkak të përplasjeve sektare dhe kërcënimeve që janë shtuar që nga muaji Shkurt, pas sulmit ndaj një tyrbe shiite në Irak, më pak se 65 mijë vetë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre. Sipas shifrave të dhëna nga Ministria e Emigrimit në Irak për BBC-në numri i irakenëve të cilët janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre, është dyfishuar në dy javët e fundit. Bëhet e ditur se irakenët, për shkak të tensionit që është shtuar midis sunive dhe shiitëve pas sulmeve, ose për shkak se tashmë nuk e ndiejnë veten të sigurt, kanë ikur nga shtëpitë e tyre duke u strehuar nëpër kampe ose pranë fiseve të tjera. Ministria sqaroi se të larguarit janë banorë që jetonin rreth Bagdadit, ku kanë ndodhur ngjarjet më të dhunshme.

Gjithashtu, sipas agjencive të lajmeve njoftohet se komandanti mjek, që i përkiste Forcave Ajrore të Mbretërisë Angleze, u dënua me burgim dhe më pas me përjashtim nga ushtria nga ana e gjykatës ushtarake pas refuzimit nga ana e tij për pjesëmarrje në operacionet luftarake në Irak.

Komandanti 37 vjeçar Malcolm-Kendall Smith, të cilit iu kërkua të shkojë në Basra në muajin qershor të vitit të kaluar dhe ai e refuzoi këtë, u gjykua nën 5 akuza ushtarake si: moszbatimi i urdhrave ushtarak dhe të ngjashme me të. Smith, gjatë mbrojtjes në gjykatën ushtarake deklaroi: "Aktivitetet ushtarake të Britanisë në Irak janë të jashtëligjshme dhe se për vendimin që ka marrë vetë ai pret të mos jetë partner në këtë, prandaj nuk ka gjetur ndonjë anë të kundërt me ligjet". Trupi gjykues u bashkua me mendimin e prokurorit ushtarak dhe dha vendosi se një ushtar s'ka të drejtën e zgjedhjes për të zbatuar apo jo urdhrat. Gjithashtu shpenzimet e gjyqit që kapën vlerën e 20 mijë sterlinave iu ngarkuan komandantit Malcolm-Kendall Smith.

Palestinë

Liga Arabe dërgoi një ndihmë urgjente me vlerë 150 mijë dollarë për qeverinë e Hamasit në Palestinë. Ndihma e dërguar do të përdoret për qëllime mjekësore dhe shëndetësore.

Sekretari i përgjithshëm i Ligës Arabe, Amir Musa deklaroi se "fondi i akorduar do të dërgohej në Palestinë si ndihmë për përmirësimin e kushteve mjekësore në mbështetje të thirrjes së Ministrit palestinez së Shëndetësisë për ndihmë".

BE-ja dhe SHBA-ja pas ardhjes të Hamasit në krye të vendit duke fituar zgjedhjet e Palestinës, ndërpreu ndihmat ndaj qeverisë palestineze, duke i kërkuar Hamasit të njohë Izraelin dhe të heqë dorë nga dhuna.

Vendimi i OKI-t, kurorëzoi Republikën Turke të Qipros së Veriut.

Kryeministri i Qipros Turke të Veriut Ferdi Sabit Soyer tha "Njohja e Qipros si "shteti Turk i Qipros" nga ana Parlamenti i Organizatës së Konferencës Islamike, vjen si rezultati i përpjekjeve diplomatike".

Sabit Soyer, në pyetjen që iu bë nga gazetarët rreth çështjes theksoi se të drejtat e Qipros Turke ishin marrë në konsideratë nga shumë shtete dhe organizata pas referendumit të 24 Prillit". Soyeri kujtoi se në këtë kuadër, në 26 Prill, BE-ja ka marrë vendimin për të hequr izolimin e saj dhe në 2004, në OKI statuti nga "Komiteti Turk Musliman i Qipros" është paraqitur në "Shteti Turk i Qipros". Soyeri theksoi se duhet lexuar drejt vendimi që thotë se "për pozicionin brenda kuadrit të bashkimit së të drejtave të Qipros Turke, OKI ka pranuar përkufizimin shtet Turk i Qipros". Tashmë kjo u kurorëzua me një vendim në këtë statut nga përfaqësimi ynë në parlamentin e OKI-së.

Kryeministri Soyer bëri të qartë se krahas kryeministres së jashtëm të Greqisë Dora Bokojanni, e cila ka thënë se "ky është plani i veçantë i Annan-it" ky vendim tregon forcën dhe vazhdueshmërinë e vullnetit të popullit turk të Qipros. Profesori në degën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin turk "Lindja e Mesme" Prof. Dr. Huseyin Bağcı tha: "Vendimi i Unionit Parlamentar i OIK (Organizatës së Konferencës Islamike) rreth Republikës Turke të Qipros së Veriut është një zhvillim i kënaqshëm, të paktën në kuptimin teorik, por zgjidhja praktike e problemit nuk është përfunduar, thjesht ka treguar se e mbështet Turqinë.

Vdekja e 350 personave gjatë kryengritjes së përgjithshme i jep fund marrëveshjes Çad-Sudan

Çadi një nga shtetet e Afrikës Qendrore paguan rëndë faturën e kryengritjes së rebelëve kundër regjimit 16 vjeçar.

Në kryengritjen që u shtyp duke përdorur helikopterë, tanke dhe mortaja vdiqën 350 persona shumica e të cilëve ishin civilë. Qeveria e Çadit ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Sudanin, të cilin e akuzoi si mbështetës të kryengritjes. Në sulmet e kryengritësve, në ditët e kaluara, në kryeqytet u arrestuan 271 vetë. Presidenti i Çadit Idris Debi në mitingun që mbajti në kryeqytetin Nashamena tha se "kishte ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Sudanin dhe kishte mbyllur kufijtë". Lideri i Çadit bëri të qartë se nëse nuk gjendet një zgjidhje ndërkombëtare mbi problemin e Darfurit deri në fund të Qershorit, nuk do të pranohen refugjatët e ardhur nga Sudani". Afro 200 mijë refugjatë nga Darfuri jetojnë nëpër kampet e refugjatëve në Çad. Kryetari i shtetit Debi pretendon se qeveria e Sudanit është implikuar në trazirat e fundit, ndërkohë që qeveria e Hartumit e përgënjeshtroi këtë gjë. Kryengritësit akuzuan Debin si "diktator" dhe shtruan kërkesën për zgjedhje të reja demokratike në vend. Gjatë muajit maj u zhvilluan zgjedhjet presidenciale: Debi pas ndryshimeve në kushtetutë ka rikandiduar për të pestën herë. Rikandidim i cili shkaktoi reagime nga opozita, ndërsa militantët e Unionit të Frontit për Ndryshim u hodhën në kryengritje.

Përgatiti: **Arjan Ymeraj**

Formula 1

Në pistat e Formula 1 nuk janë vetëm makinat dhe pilotët të cilët garojnë, por falë teknologjisë se avancuar, garojnë edhe sistemet kompjuterike. Bota e Formula 1, e cila zhvillohet vazhdimisht, ndien nevojën e një teknologjie të përparuar. Për shkak të kësaj nevoje ndërmjet firmave është rritur konkurrenca në fushën e prodhimeve teknologjike.

Kartat e reja PRETEC të gatshme për klientët

Kartat e reja të memories SD më një shpejtësi të lartë të firmës PRETEC, u hodhën në tregjet informative. Këto karta me kapacitet 4 GB janë të përshtatshme për ruajtjen e të dhënave digjitale. Ato kanë një përdorim të madh në mjetet e komunikimit dhe argëtimit si p.sh. celularët, aparatet fotografike digjitale, MP3 player, video kamerat digjitale etj.

Lajme të mira në lidhje me shtresën e ozonit



Studiuesit, duke pasur parasysh pakësimin e përdorimit të lëndëve kimike, thonë se në shtresën mbrojtëse të ozonit janë shfaqur disa shenja të përmirësimit. Por, megjithë përmirësimet nuk është e mundur që te arrijë në nivelin e para viteve 1980. Në një nje deklaratë të Besty Weetherhead nga Universiteti i Kolorados, sqaron se shkak i dobesimit të shtresës mbrojtëse të ozonit janë kloroflorokarbonet CFC të cilat përdoren tek sprajat dhe në pajisjet ftohëse.

BE do të ricikloje baterit e konsumuara

BE që nga viti 2008 do të fillojë ripërdorimin e baterive të konsumuara. Rregullorja e re BE-së ndalon prodhimin e baterive që përmbajne lëndë toksike si zhivë dhe kamidium. Parashikohet që deri në vitin 2016 brenda Bashkimit Evropian rreth 25% e baterive të konsumuara të riciklohen.

Anijet kozmike në hapësirë



Shkencëtarët pohojnë se sistemi i cili mundëson që anija kozmike të mos duket në hapësirë arrihet të vërtetohet matematikisht. Nicolae Nikorovic dhe Graema Milton tregojnë që objektet e quajtura super-lente kur u afrohen materialeve që përthyejnë dritën nuk arrijnë që të dallohen më sy. Shkencëtarët këtë efekt e quajnë Anomalous Lokalised Resonance (Rezonancë e lokalizuar anormale). Aktualisht shkencëtarët vazhdojnë të studiojnë këtë fenomen mbi bazat matematikore.

Gjendja atmosferike në hënë: Rënia e meteorëve

Rënia e meteorëve përbën rrezik për bazën hapësinore të NASA-s në hënë. Baza hapësinore e NASA-s në hënë në të ardhmen do të jetë e rrezikuar nga rënia e meteorëve. Me dërgimin e astronautëve në bazën hapësinore që parashikohet të bëhet në vitin 2018 ajo do të përballet me rreziqe të ndryshme. Ekspertët e NASA-s po studiojnë me anë të aparaturave të matjeve sizmike, të cilat gjendën në hëne që para 30 vjetësh, efektin që mund të shkaktohet me rënien e meteorëve.

Përgatiti: **Alija BARLOVİC**